



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË NË
“AKADEMINË E SIGURISË”

TIRANË, DHJETOR 2024

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.....	3
II. HYRJA.....	14
a. Objektivat dhe qëllimi.....	14
c. Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese.....	15
d. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:.....	15
e. Kriteret e vlerësimit:.....	16
f. Standardet e Auditimit.....	17
g) Metodot e auditimit.....	17
h) Dokumentimi i auditimit.....	18
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	18
1. Informacion i Përgjithshëm.....	18
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.....	19
2.1 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit.....	19
2.2. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.....	26
2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.....	35
2.4 Auditimi i llogarive vjetore.....	59
2.5 Prokurimet me fonde publike.....	72
2.6 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar.....	77
IV. REKOMANDIME.....	96

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

a. Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 646/1 prot., datë 15.05.2024, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditori Akademinë e Sigurisë (AS), për periudhën 01.01.2022 deri me datën 31.12.2023.

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit ku është e mundur të specifikohet dhe buxheti:

Akademia e Sigurisë (në vijim AS) është krijuar me Vendim nr.184, datë 20.12.1971 të Këshillit të Ministrave në vijim të Shkollës së Ministrisë së Brendshme. Akademia organizon programe studimi të arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike në të gjitha ciklet, kurse profesionale të formimit bazë dhe të kualifikimit të vazhduar për çdo gradë, kurse specializimi për çdo shërbim e profil dhe trajnim praktik për punonjësit e strukturave si:

Policia e Shtetit, Garda e Republikës, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Shërbimi i Provës, Shërbimi i çështjeve të brendshme në Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Policia Bashkiake, Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Persona fizikë e juridikë që ofrojnë shërbimin e sigurisë fizike, subjekt të së drejtës private apo publike si dhe Institucione të tjera, pavarësisht emërimit, të krijuara me akte të tjera që operojnë në fushën e rendit dhe të sigurisë publike.

AS-ja gëzon status të veçantë, dhënë me Vendimin nr. 881, datë 28.10.2020 të Këshillit të Ministrave “*Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike, si dhe organizimin dhe funksionimin e saj*”. Në përputhje me VKM-në nr. 320, datë 02.06.2021 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në VKN-në nr. 881, datë 28.10.2020, “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimin e saj*”, pika 9, përcakton se: Akademia e Sigurisë financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme. Akademia e Sigurisë është njësi shpenzuese më vete brenda programit buxhetor të Policisë së Shtetit, e cila për periudhën objekt auditimi është financuar 100% nga Buxheti i Shtetit, me kod buxhetor 1016003.

b. Rëndësia e auditimit.

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë së Akademisë së Sigurisë për periudhën e aktivitetit 2022-2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore, ku AS është subjekt i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron dhe fakti se ky institucion nuk ishte audituar nga KLSH-ja për një periudhë mbi 5 vjet, si dhe statusit të veçantë që i është dhënë AS me Vendimin nr. 881, datë 28.10.2020 të Këshillit të Ministrave “*Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike, si dhe organizimin dhe funksionimin e saj*”.

c. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi ishte dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën e auditimit nga data 01.01.2022 deri ne 31.12.2023.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t’i bëhet e njohur nivelit drejtues të Akademia së Sigurisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet

shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë gjetje e rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Akademia e Sigurisë.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit;

- Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave;

- Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare;

- Auditimi i llogarive vjetore;

- Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.

- Zbatimi i dispozitave ligjore në funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit etj.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave.

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve. Zgjedhja i transaksioneve të kryera përgjatë vitit 2022 dhe vitit 2023, është bërë bazuar në ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit” dhe ISSAI 1530 “Shënime praktike mbi ISA 530”.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 6,035 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve. Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: *Kontrolli aritmetik, Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët, Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.*

e. Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se Akademia e Sigurisë për periudhën në auditim, paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 2 masë përmirësim ligjor, 24 gjetje masa organizative dhe ka dhënë 36 rekomandime; 4 gjetje gjetje 3E dhe ka dhënë 4 rekomandim dhe 1 masë shpërblim dëmi.

f. Gjetjet kryesore sipas drejtimeve.

1. Nga auditimi i kryer është konstatuar mungesë koherence dhe harmonizimi midis kuadrit ligjor dhe atij nënligjor në fuqi. Konkretisht me ndryshimet e kryera përmes VKM-së nr.320, datë 02.6.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimin e saj” pika 15 ndryshohet si vijon: “Personeli akademik me gradë policore përzgjidhet nga radhët e punonjësve të policisë së shtetit, sipas kriterëve të përcaktuara në statutin e Akademisë së Sigurisë

dhe emërohet nga Rektori me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Gjithashtu, personeli akademik me gradë sipas statutit të strukturave përfituese emërohet nga Rektori me propozim të titullarëve të strukturave përfituese sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit midis titullarit të AS dhe titullarit të strukturave përfituese.

Në Statutin e Akademisë, miratuar me Urdhër të përbashkët nr.130, datë 10.3.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit si dhe Ministrisë të Brendshme si dhe në Rregulloren e brendshme të Akademisë, miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.77, datë 02.5.2023, respektivisht në nenin 24 të Statutit dhe nenin 70, pika 5 të Rregullores së Akademisë nuk janë reflektuar ndryshimet e parashikuara sipas VKM-së së lartpërmendur.

Nga administrimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se emërimi dhe transferimi i personelit akademik me grada policore në Akademinë e Sigurisë kryhet me Urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit bazuar në nenin 43, pika 4, të Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” ku përcaktohet se: *Transferimi i punonjësit të policisë me gradën “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë”, si dhe të gjitha transferimet e punonjësve nga një strukturë në një strukturë tjetër, pavarësisht nga grada, bëhen me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.*

Për sa më sipër dispozitat e parashikuara në VKM-në e lartpërmendur, mbi të drejtën e Rektorit për emërimin e personelit akademik me grada policore vijnë në kundërshtim me nenin 43, pika 4 të Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” si dhe nuk gjejnë zbatim në aktet e brendshme ligjore të Akademisë si dhe në praktikën e emërimeve dhe transferimeve të personelit akademik.

2. Nga auditimi i listë-pagesave ndaj pedagogëve të jashtëm u konstatua se; Pagesat ndaj tyre janë trajtuar si honorare dhe jo si paga, ku është mbajtur tatim në burim në vlerën 15% dhe nuk është trajtuar dhe bashkuar bashkë me pagën e përfituesit.

Mes pedagogëve dhe AS janë lidhur kontrata pune për çdo vit akademik, si rrjedhojë ata janë të punësuar, ku nga AS duhet të ishte bërë deklarimin e tyre si të punësua për efekt të llogaritjes dhe pagesës së sigurimeve. si dhe të tatimit mbi të ardhurave tatueshme. Mosdeklarimi i tyre nga AS si të punësua, ka ndikuar dhe në mosdeklarimin/pagimin e tatimit nga dy ose më shumë punësime nga pedagogët e jashtëm.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8438 “Për Tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nenit 8, pika 1 dhe neni 13 pika 4, Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, VKM nr. 568, datë 6.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” II, pika 4, Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 79 dhe neni 13 pika 1, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 119, Vendimin nr. 77, datë 28.1.2015 “Për Kontributet e Detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i Sigurimeve Shoqërore dhe Sigurimi i Kujdesit Shëndetësor”, Udhëzimit të përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” pika 10.

3. Nga auditimi i llogarisë 203 “Koncesione, Patenta, Licenca e te ngjashme” u konstatua se është kontabilizuar vlera bruto prej 150,000 lekë të programit “Financa 5” të instaluar në këtë institucion që nga viti 2006. Kjo vlerë ka të bëjë me aktive afatgjata, ku amortizimi në vite nga institucioni edhe pse është klasifikuar në llogarinë 203 është llogaritur me normën 25 % dhe jo 15%, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Klasa 2 ‘Aktive afatgjata’ dhe pika 36, me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit.

3.1 Nga auditimi i llogarisë 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore” u konstatua se: Nga Akademia e

Sigurisë është regjistruar vlera e “truallit/tokës” së shesheve dhe rrugëve, e cila është rivlerësuar sipas VKM-së me nr. 514, datë 30.7.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin Qark të Republikës së Shqipërisë” në vlerën 52,898,979 lekë. Keq klasifikimi i regjistrimit kontabël ka bërë të mundur mbivlerësimin e llogarisë 213 “Ruge, rrjete, vepra ujore”, si dhe nënvlerësimin e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në shumën bruto prej 52,898,979 lekë, ku në vite është llogaritur amortizimi me normën 20% mbi këtë vlerë, me ndikim negativ në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit, pasi për zërin truall/tokë nuk llogaritet amortizim.

Sa më sipër, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

3.2 Nga auditimi i Llogarisë 214 “Instalime, Teknike makineri, pajisje” u konstatua se:

Referuar Urdhrit të Ministrit të Brendshëm me nr. 1484, datë 23.10.2023 “Për menaxhimin me çmime të aktiveve të shërbimit të armatimeve dhe pajisjeve speciale nga njësia shpenzuese të policisë së shtetit dhe administrimi i dokumentacionit”, nga Akademia e Sigurisë është bërë vlerësimi “Poligoni Stazz”, sipas çmimeve të dërguar nga MB në vlerën totale 11,354,304 lekë, por nuk është pasqyruar në kontabilitet si rritje e aktiveve të institucionit.

Mospasqyrimi i tyre në kontabilitet është veprim në kundërshtim me Urdhrit të Ministrit të Brendshëm me nr. 1484, datë 23.10.2023, ku qëllimi i urdhrit është menaxhimi me çmimet të aktiveve të shërbimit të armatimeve dhe pajisjeve speciale, si dhe përfshirjes së vlerës së tyre në bilancin kontabël të Policisë së Shtetit, si dhe me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Klasa 2 ‘Aktive afatgjata’, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrave financiare, si dhe me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit.

4. Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 24/1 datë 12.12.2022 me objekt “Për blerje uniformash dhe elementesh të tjerë përbërës të tyre” në vlerën totale 1,820,100 lekë, OE fitues ka deklaruar në ofertën e paraqitur ne tender se mallrat do të jenë të prodhuara nga subjekti “P.” Ltd me vend origjinë në Irlandë me distributor për shitjen e tyre nga OE “E.” SHPK. Zbatimi i kësaj kontrate është realizuar nëpërmjet dy furnizimeve, të datës 28.12.2022 dhe datës 30.10.2023, respektivisht për furnizimin me 250 kostume dimërore dhe 250 kostume verore në vlerën prej 988,500 lekë dhe të 330 kostumeve dimërore në vlerën prej 831,600 lekë.

Nga shqyrtimi i marrjes në dorëzim të mallrave dhe ekzaminimi i mallrave gjendje në magazinë është evidentuar se nuk janë në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret e vlerësimit, ndërkohë që nga Komisioni i marrjes në dorëzim të tyre është cilësuar se: “Mallrat e dorëzuara nga OE janë konform specifikimeve të kërkuara”. Mospërputhja e specifikimeve teknike ka konsistuar në: përbërjen e materialit; dizajnin dhe mënyrën e paketimit, si dhe mallrat furnizuara nuk janë të prodhuara nga “P.” Ltd me vend origjinë në Irlandë, kjo e vërtetuar edhe nga mungesa e certifikatës së origjinës së mallit.

Veprime në kundërshtim me Kontratën nr. 24/1 datë 12.12.2022, neni 2; Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” nenin 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”; VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës” pika 7; Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1.

5. Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 04/2 datë 08.04.2022 me objekt “Për blerje këpucë, atlete sportive” në vlerë totale 1,969,408 lekë, OE fitues ka deklaruar në ofertën e paraqitur ne tender se

mallrat do të jenë të prodhuara nga subjekti “P.....” Ltd me vend origjinë në Irlandë. Zbatimi i kësaj kontrate është realizuar nëpërmjet tre furnizimeve, përkatësisht:

Me datën 15.04.2022 për furnizimin me 172 këpucë atlete në vlerën 445,824 lekë; me datën 09.12.2022 për furnizimin me 217 këpucë atlete në vlerën prej 554,176 lekë dhe me datën 24.10.2023 për furnizimin me 374 këpuce atlete në vlerën prej 831,600 lekë.

Nga shqyrtimi i marrjes në dorëzim të mallrave dhe ekzaminimi i mallrave gjendje në magazinë është evidentuar se nuk janë në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret e vlerësimit, ndërkohë që nga Komisioni i marrjes në dorëzim të tyre është cilësuar se: “Mallrat e dorëzuara nga OE janë konform specifikimeve të kërkuara”.

Nga OE për të dy furnizimet është vënë në dispozicion raporti i testimit i lëshuar me datën 27.01.2022 ku është përcaktuar se “*këpucë atlete faqet kombinuar lëkurë natyrale dhe tekstile rrytë 30%, gomë e bute tabani i atleteve poroz dhe i trashë*”. Raport testimi i realizuar nga Laboratori fiziko mekanik dhe kimik i tekstit dhe lëkurës, është realizuar mbi kampione përpara se: të realizohej procedura e prokurimit dhe të shpallej fitues OE, si dhe fletë-analiza e dorëzuar nga OE nuk është e vërtetuar se mbi çfarë produktesh është kryer dhe nëse përputhet me produktet e dorëzuar nga OE për realizimin e kontratës.

Mospërputhja e specifikimeve teknike ka konsistuar në: dizajnin, mënyrën e paketimit, si dhe mallrat furnizuara nuk janë të prodhuara nga “P.” Ltd me vend origjinë në Irlandë, pasi atletet kishin të shënuar prodhimin made in Vietnam, si dhe nuk kishte asnjë certifikatë të konformitetit CE.

Veprime në kundërshtim me Kontratën 04/2 datë 08.04.2022, neni 2; Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”; VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës” pika 7; Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1. 6. Nga auditimi i zbatimit të kontratës me nr. 1752, datë 26.08.2022 me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering) për Akademinë e Sigurisë” në vlerë totale 247,967,144 lekë, për 36 muaj, nga kryqëzimi i procesverbaleve të mbajtura nga komisioni pranimit të malli për çdo ditë /vakt në “Libër procesverbal ushqimi” me fletë daljet ditore të ushqimit u konstatua se:

a) Për 24 (njëzet e katër) raste, në vitin 2022 në vlerën 2,498,669 lekë dhe 74 (shtatëdhjetë e katër) raste në vitin 2023 në vlerën 6,700,125 lekë në procesverbalet e mbajtura nuk janë shënuar numri i vakteve të marrë në dorëzim.

b) Për 6 (gjashtë) raste, në vitin 2022 në vlerën 8,521 lekë dhe 38 (tridhjetë e tetë) raste në vitin 2023 në vlerën 133,110 lekë nuk janë mbajtur procesverbalet e marrjes së vakteve në dorëzim, si dhe nuk janë të raportuara në librin e dorëzimit të ushqimit, por praktika ka të bashkëlidhur vetëm fletë daljen.

c) Për dy raste, në vitin 2022 në vlerën 15,520 lekë dhe 7 (shtatë) raste në vitin 2023 në vlerën 94,856 lekë rezultuan diferenca midis procesverbaleve të mbajtura dhe fletë daljeve, ku në fletë dalje ka më shumë racione, sesa racione të marrë në dorëzim sipas procesverbalit ditor të mbajtur. Sa më sipër, u konstatua parregullsi dhe mangësi në procedurat e menaxhimit dhe kontrollit të ushqimit të dorëzuar dhe të marrë në dorëzim nga Akademia e Sigurisë, veprime të cilat janë në kundërshtim me Kontratën me nr. 1752, datë 26.08.2022 neni 32, me urdhrin e Rektorit të AS me nr. 405, prot., 2130, datë 05.10.2022 “Për mënyrën e funksionimit, pranimit, administrimit kontrollit dhe zbatimin e kontratës së “Shërbim gatimi dhe Shpërndarjes së ushqimit” pika 4 dhe 5; Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 36.

- Nga auditimi u konstatua se bashkëlidhur praktikave nuk ka asnjë gjurmë të shpërndarjes së bonove të ushqimit, siç është përcaktuar në nenin 12 “Forca e përditshme e ushqimit” pika 12.5 si dhe me urdhrin e Rektorit të AS me nr. 405, prot., 2130, datë 05.10.2022 “Për mënyrën e funksionimit, pranimit, administrimit kontrollit dhe zbatimin e kontratës së "Shërbim gatimi dhe Shpërndarjes së ushqimit" pika 3.

7.1 Nga auditimi i zbatimit të kontratës me nr. 1752, datë 26.08.2022 me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering) për Akademinë e Sigurisë” në vlerë totale 247,967,144 lekë, për 36 muaj, u konstatua se:

Marrëveshja kuadër nr.150/6 prot, datë 19.8.2022 lidhur ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara si organ qendror blerës dhe operatorit ekonomik “S.” ShPK përcakton kushtet dhe rregullat për kryerjen e shërbimit me objekt: “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Akademinë e Sigurisë*”, ku AK në emër dhe për llogari të të cilit është lidhur marrëveshja kuadër është Akademia e Sigurisë. Si rrjedhojë nuk mund të bëhen pjesë e një marrëveshje kuadër autoritetet/entet kontraktore, të cilat nuk janë palë e marrëveshjes kuadër që në publikimin e saj.”.

Referuar dokumentacionit të administruar në lidhje me realizimin e kontratës, Akademia e Sigurisë ka ofruar “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering)” për Instituti i Përgatitjes së Qenve të Policisë së Shtetit, e cila është njësi shpenzuese me vete në varësinë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. Për Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë deri me datën 31.12.2023 është paguar vlera e shërbimit të kateringut në shumën prej 1,704,864 lekë pa TVSh, vlerë e cila është pakontraktuar, është jashtë parashikimeve të kushteve të kontratës dhe vlerave të parashikuara në marrëveshjen kuadër.

Veprim në kundërshtim me LPP 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Kreu XV nga neni 122 e vijues si dhe me VKM-në me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 60 pika 2; neni 64, pika 2; neni 107, pika 7.

7.2 Nga auditimi i marrjes në dorëzim të ushqimit nga IPQP, u konstatuan parregullsi dhe mangësi në procedurat e menaxhimit dhe kontrollit të ushqimit të dorëzuar dhe të marrë në dorëzim pasi:

- Ushqimi në IPQPSH shërbehej nga OE në basketa, i cili bëhej gati në ambientet e Akademisë së Sigurisë. Bashkëlidhur praktikës së shpenzimit të realizuar kishte vetëm Akt rakordimin e bërë nga IPQPSH, kundër firmosur nga OE, ku mungonte fletë dalje ditore provizore, regjistrimi i racioneve në “Libër procesverbal ushqimi”, si dhe procesverbalet e marrjes në dorëzim të ushqimit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Bazuar në kontratën, pritja dhe marrja në dorëzim e mallit është detyrë funksionale e Akademisë së Sigurisë.

Veprime në kundërshtim me Kontratën me nr. 1752, datë 26.08.2022 neni 32, me urdhrin e Rektorit të AS me nr. 405, prot., 2130, datë 05.10.2022 “Për mënyrën e funksionimit, pranimit, administrimit kontrollit dhe zbatimin e kontratës së "Shërbim gatimi dhe Shpërndarjes së ushqimit" pika 4 dhe 5; Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 36.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

1. Akademia e Sigurisë në bashkëveprim me Ministrinë e Brendshme të marrin masa për propozimin e ndryshimeve të VKM-së nr.320, datë 02.6.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit e saj”, në kuadër të harmonizimit të tij me përcaktimet

e Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” si dhe të sigurohet pajtueshmëria e akteve ligjore të brendshme të Akademisë me kuadrin ligjor në fuqi.

2. Rekomandimi: Akademia e Sigurisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të policisë të marrin masa për të propozuar në Ministrinë e Brendshme përfshirjen e personelit akademik të jashtë në strukturën e akademisë si punonjës me kontratë të përkohshme, për faktin se Akademia e sigurisë nuk administron të ardhura të veta për deklarin dhe pagesat e tyre.

3.1 Sektori i Financës të marrë masa për kreditimin e llogarisë 203 “Koncesione, Patenta, Licenca e te ngjashme” në vlerën bruto 150,000 lekë dhe debitimin e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune” për të njëjtën vlerë.

3.2 Sektori i Financës të marrë masa për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve, duke debituar llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” për shumën 52,898,979 lekë dhe kredituar llogarinë 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore” për të njëjtën vlerë.

3.3 Sektori i Financës të marrë masa për regjistrimin dhe pasqyrimin në kontabilitet të aktiveve të vlerësuara “Poligoni Stazz”, sipas çmimeve të dërguar nga MB në vlerën totale 11,354,304 lekë.

4. Titullari i Akademisë së sigurisë të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive ndaj Komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave, të cilët duke i pranuar ato në kundërshtim me specifikimet e përcaktuara në kontratë kanë çenuar cilësinë e mallrave, si dhe kanë shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën 1,820,100 lekë.

5. Titullari i Akademisë së sigurisë të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive ndaj Komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave të cilët duke i pranuar ato në kundërshtim me specifikimet e përcaktuara në kontratë kanë çenuar cilësinë e mallrave, si dhe kanë shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën 1,969,408 lekë.

6. Titullari i Akademisë së Sigurisë të marrë masa të menjëhershme për nxjerrjen e përgjegjësive të Komisionit të pritjes dhe kolaudimit në shërbimin e ushqimit, i cili nuk ka zbatuar një sërë kushtesh të kontratës, procedurat e përcaktuara për ndjekjen e zbatimit të kësaj kontrate, si dhe nuk ka lënë gjurmë auditimi mbi procedurat e kryera duke krijuar premisa për abuzim me fondet publike, ku për rastet e mësipërme, për të cilat është bërë e mundur përllogaritja e tyre rezultojnë në shumën 9,450 mijë lekë.

7. Titullari i Akademisë së Sigurisë në bashkëveprim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë të marrin masa të menjëhershme për nxjerrjen e përgjegjësive të nëpunësve, të cilët kanë kryer veprime në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore, duke përfshirë dhe paguar një shpenzim në vlerën prej 1,704,864 lekë par interes të një njësie tjetër shpenzuese, të pakontraktuar, të paparashikuar në kushtet të kontratës dhe e papërfshirë si palë në marrëveshjen kuadër që në publikimin e shërbimit.

1.2. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

I. Opinioni për auditimin financiar¹: i kualifikuar²:

Ne kemi audituar hartimin e pasqyrave financiare të Akademisë së Sigurisë, për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e

¹ -Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

² -Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar “ të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (faqe 54 dhe 60-61), “Një “Opinion i Kualifikuar”, jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërfshirjes, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.*”

performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinionit:

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit më 31 dhjetor 2023, referuar kuadrit rregullator në fuqi:

Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, etj.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 6,035 mijë lekë, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një “Opinionit të Kualifikuar” të auditimit.

- Nga Akademia e Sigurisë, në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, e cila përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve nuk është kontabilizuar asnjë detyrim gjatë vitit, vlerë e cila në fund të periudhës ushtrimore duhet të ishte debituar në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasqyrën e pozicionit financiar, pasi nga AS nuk është njohur si shpenzime të periudhave të ardhshme në pasqyrën financiare për vitin 2023, vlera prej 5,416,079 lekë e kreditorit S,R, detyrim i krijuar që në vitin 2019, si dhe nuk është raportuar si detyrim i prapambetur, si dhe plani i shlyerjes së tij sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme” dhe Udhëzimit plotësues nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, pika 126.1 germa b.

- Nga auditimi i llogarisë 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore” u konstatua se: Nga Akademia e Sigurisë është regjistruar vlera e “truallit/tokës” së shesheve dhe rrugëve, e cila është rivlerësuar sipas VKM-së me nr. 514, datë 30.7.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin Qark të Republikës së Shqipërisë” në vlerën 52,898,979 lekë. në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” ku në vite është llogaritur amortizimi me normën 20% mbi këtë vlerë, me ndikim negativ në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit, pasi për zërin truall/tokë nuk llogaritet amortizim.

- Nga auditimi i llogarisë 214 “Instalime, Teknike makineri, pajisje” u konstatua se, nga Akademia e Sigurisë është bërë vlerësimi “Poligoni Stazz”, sipas çmimeve të dërguar nga MB në vlerën totale 11,354,304 lekë, por nuk është pasqyruar në kontabilitet si rritje e aktiveve të institucionit, veprim në kundërshtim me Urdhrin e Ministrisë të Brendshme me nr. 1484, datë

23.10.2023, si dhe me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Klasa 2 ‘Aktive afatgjata’, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrave financiare, si dhe me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit.

- Nga auditimi i llogaritjes së amortizimit dhe vlerës neto të aktiveve të pasqyruara në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” u konstatua se: Për vitin 2023, për llogarinë 218 “inventar ekonomik” nga institucioni është përlogaritur amortizim vjetor më i lartë se vlera e aktiveve, ku si rrjedhojë vlera e amortizimit të akumuluar është më e lartë se vetë kostoja historike e aktiveve. Në kontabilitet është përlogaritur vlera negative për njëzet e katër aktive në shumë prej (257,867) lekë, vlerë e cila është zbritur nga gjendja neto e aktiveve, duke ndikuar në pasqyrimin jo real të gjendjes së tyre në kontabilitet dhe pasqyrim jo të drejtë të ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto. Ky veprim kontabël është bërë dhe për vitin 2022, ku për njëzet e katër aktive në kontabilitet janë pasqyruar në vlerë negative në shumë prej (323,176) lekë.

- Nga auditimi i zërave të “Pasqyrës së Performancës” u konstatua se, në Llogarinë 602 “Blerje mallra e shërbime” janë regjistruar dhe paguar, për vitin 2023, rikonstruksioni i tarracës së një nga godinave në pronësi të Akademisë së Sigurisë në vlerën 490,147 lekë. Nga AS janë planifikuar/realizuar si shpenzime “Izolim tarracë në godinën e AS”; Mbikëqyrja dhe Kolaudimi i punimeve të saj, vlera e të cilave duhet të ishte planifikuar në zërin e investime kapitale dhe të kontabilizoheshin si rritje e vlerës së aktivitetit, referuar Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin punimeve të ndërtimit” pika 1; pika 2, si dhe Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë së qeverisjes së përgjithshme” Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”.

Përgjegjësia e strukturave drejtuese të Subjektit

Strukturat menaxheriale të Akademisë së Sigurisë janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafit drejtues është përgjegjës për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Opinion për auditimin e përputhshmërisë (Kualifikuar³).

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit Akademia e Sigurisë me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Akademisë së Sigurisë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë”.

³ **Opinion i modifikuar/ kualifikuar:** Referuar Manualit të Përputhshmërisë të KLSH-së (vendim nr. 24, datë 29.12.2022 fq.104) Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura”.

Baza për opinionin e përputhshmërisë. Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit Akademia e Sigurisë në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, “Deklarata e Limës”; INTOSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20 dhe INTOSA P-50, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga AS dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e **opinionit të kualifikuar**.

Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:

- Nga auditimi i kryer është konstatuar mungesë koherence dhe harmonizimi midis kuadrit ligjor dhe atij nënligjor në fuqi. Konkretisht me ndryshimet e kryera përmes VKM-së nr.320, datë 02.6.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit e saj” pika 15 ndryshohet si vijon: “Personeli akademik me gradë policore përzgjidhet nga radhët e punonjësve të policisë së shtetit, sipas kriterëve të përcaktuara në statutin e Akademisë së Sigurisë dhe emërohet nga Rektori me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Gjithashtu, personeli akademik me gradë sipas statutit të strukturave përfituese emërohet nga Rektori me propozim të titullarëve të strukturave përfituese sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit midis titullarit të AS dhe titullarit të strukturave përfituese.

Në Statutin e Akademisë, miratuar me Urdhër të përbashkët nr.130, datë 10.3.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit si dhe Ministrit të Brendshëm si dhe në Rregulloren e brendshme të Akademisë, miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.77, datë 02.5.2023, respektivisht në nenin 24 të Statutit dhe nenin 70, pika 5 të Rregullores së Akademisë nuk janë reflektuar ndryshimet e parashikuara sipas VKM-së së lartpërmendur.

- Nga auditimi i listë-pagesave ndaj pedagogëve të jashtëm u konstatua se; Pagesat ndaj tyre janë trajtuar si honorare dhe jo si paga, ku është mbajtur tatim në burim në vlerën 15% dhe nuk është trajtuar dhe bashkuar bashkë me pagën e përfituesit. Mes pedagogëve dhe AS janë lidhur kontrata pune për çdo vit akademik, si rrjedhojë ata janë të punësuar, ku nga AS duhet të ishte bërë deklarimin e tyre si të punësua për efekt të llogaritjes dhe pagesës së sigurimeve. si dhe të tatimit mbi të ardhurave tatueshme. Mosdeklarimi i tyre nga AS si të punësuar, ka ndikuar dhe në mosdeklarimin/pagimin e tatimit nga dy ose më shumë punësime nga pedagogët e jashtëm. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8438 “Për Tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nenit 8, pika 1 dhe neni 13 pika 4, Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, VKM nr. 568, datë 6.10.2021 kapitulli II, pika 4, Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 79 dhe neni 13 pika 1. Nga auditimi i zbatimit të kontratave rezultoi se:

- Për kontratën nr. 24/1 datë 12.12.2022 me objekt “Për blerje uniformash dhe elementesh të tjerë përbërës të tyre” në vlerën totale 1,820,100 lekë dhe kontratën nr. 04/2 datë 08.04.2022 me objekt

“Për blerje këpucë, atlete sportive” në vlerë totale 1,969,408 lekë, nga shqyrtimi i marrjes në dorëzim të mallrave dhe ekzaminimi i mallrave gjendje në magazinë është evidentuar se nuk janë në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret e vlerësimit, ndërkohë që nga Komisioni i marrjes në dorëzim të tyre është cilësuar se: “Mallrat e dorëzuara nga OE janë konform specifikimeve të kërkuara”. Mospërputhja e specifikimeve teknike ka konsistuar në: përbërjen e materialit; dizajnin dhe mënyrën e paketimit, si dhe mallrat e furnizuara nuk janë të prodhuara nga “P.....” Ltd me vend origjinë në Irlandë, ashtu siç OE fitues ka deklaruar në ofertën e paraqitur në tender, kjo e vërtetuar edhe nga mungesa e certifikatës së origjinës së mallit, si dhe nga emërtimi i prodhuesit në etiketat e mallrave “J. C.” dhe “R.”. Veprime në kundërshtim me Kontratën neni 2; Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” nenin 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”; VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës” pika 7; Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1.

Sa më sipër pranimit i mallrave në kundërshtim me specifikimet e përcaktuara në kontratë kanë cënuar cilësinë e mallrave, si dhe kanë shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën 3,789 mijë lekë.

- Për kontratën me nr. 1752, datë 26.08.2022 me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering) për Akademinë e Sigurisë” në vlerë totale 247,967,144 lekë, për 36 muaj, nga kryqëzimi i procesverbaleve të mbajtura nga komisioni pranimit të mallit për çdo ditë /vakt në “Libër procesverbal ushqimi” u konstatua parregullsi dhe mangësi në procedurat e menaxhimit dhe kontrollit të ushqimit të dorëzuar dhe të marrë në dorëzim nga Akademia e Sigurisë, ku për rastet e trajtuara për të cilat është bërë e mundur përlllogaritja e tyre rezultojnë përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën 9,450 mijë lekë. Veprime të cilat janë në kundërshtim me Kontratën me nr. 1752, datë 26.08.2022 neni 32, me urdhrin e Rektorit të AS me nr. 405, prot., 2130, datë 05.10.2022 “Për mënyrën e funksionimit, pranimit, administrimit kontrollit dhe zbatimit të kontratës së “Shërbim gatimi dhe Shpërndarjes së ushqimit” pika 4 dhe 5; Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 36 - Nga auditimi u konstatua se bashkëlidhur praktikave nuk ka asnjë gjurmë të shpërndarjes së bonove të ushqimit, siç është përcaktuar në nenin 12 “Forca e përditshme e ushqimit” pika 12.5 si dhe me urdhrin e Rektorit të AS me nr. 405, prot., 2130, datë 05.10.2022 “Për mënyrën e funksionimit, pranimit, administrimit kontrollit dhe zbatimit të kontratës së “Shërbim gatimi dhe Shpërndarjes së ushqimit” pika 3.

- Nga auditimi i zbatimit të kontratës me nr. 1752, datë 26.08.2022 me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering) për Akademinë e Sigurisë” në vlerë totale 247,967,144 lekë, për 36 muaj, u konstatua se:

Marrëveshja kuadër nr.150/6 prot, datë 19.8.2022 lidhur ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara si organ qendror blerës dhe operatorit ekonomik “S.” ShPK përcakton kushtet dhe rregullat për kryerjen e shërbimit me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Akademinë e Sigurisë”, ku AK në emër dhe për llogari të të cilit është lidhur marrëveshja kuadër është Akademia e Sigurisë. Si rrjedhojë nuk mund të bëhen pjesë e një marrëveshje kuadër autoritetet/entet kontraktore, të cilat nuk janë palë e marrëveshjes kuadër që në publikimin e saj.

Referuar dokumentacionit të administruar në lidhje me realizimin e kontratës, Akademia e Sigurisë ka ofruar “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering)” për Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë së Shtetit, i cili është njësi shpenzuese me vete në varësinë e

Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. Për Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë deri me datën 31.12.2023 është paguar vlera e shërbimit të cateringut në shumën prej 1,704,864 lekë pa TVSh, vlerë e cila është pakontraktuar dhe jashtë parashikimeve të kushteve të kontratës dhe vlerave të parashikuara në marrëveshjen kuadër.

Veprim në kundërshtim me LPP 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Kreu XV nga neni 122 e vijues si dhe me VKM-në me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 60 pika 2; neni 64, pika 2; neni 107, pika 7.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 646/1 prot., datë 15.05.2024, në Akademinë e Sigurisë (AS), nga data 15.05.2024 deri më datën 12.07.2024, për periudhën e auditimit 01.01.2022-31.12.2023, u krye auditim Financiar dhe Përputhshmërie, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. J. G, (përgjegjës grupi)
2. A. Z, anëtar
3. L. Ll, anëtar
4. A. M, anëtar
5. A. Xh, anëtar
6. A. S. anëtar

a. Objektivat dhe qëllimi.

Objektivat specifike të auditimit është përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit, Akademia e Sigurisë me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu veprimtaria e institucionit, procedurat e prokurimit dhe shpenzimet vjetore të institucionit.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

Qëllimi i auditimit: Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar. Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Akademisë së Sigurisë.

b. Identifikimi i çështjes

Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësi të institucionit të Akademisë së Sigurisë, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat nënligjore në fuqi, Fushëveprimi i këtij

auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së AS, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përkatëse të AS, të cilat realizojnë koordinimin dhe zbatimin e strategjive që orientojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme të institucionit.

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Sipas përcaktimit të ISSAI 100 “*Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi*”, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Akademisë së Sigurisë.

c. Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese

Drejtimi i Akademisë së Sigurisë është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare dhe njerëzore në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafii drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

d. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Akademisë së Sigurisë dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimet dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit. Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit. Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe Kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet. Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Akademisë së Sigurisë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, paragrafi 44-51.

e. Kriteret e vlerësimit:

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “*Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar;
- Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH*”;
- VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017 “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit*” i ndryshuar;
- VKM-së nr. 881, Datë 28.10.2020, “*Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimin e saj*”;
- Udhëzimi nr.27, datë 29.12.2017 i Ministrit të Arsimit “*Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë*”
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme*”; i ndryshuar me Udhëzimin MFE nr. 5, datë 21.02.2022;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar;
- Urdhër i MFE nr. 54, datë 15.07.2010 “*Për miratimin e manualit të MFK*”;
- Udhëzimi MFE nr. 37, datë 06.10.2020 “*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*”;
- Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit;
- Rregullore e brendshme “*Mbi Procedurat e auditimit në KLSH*”, miratuar me vendimin nr. 7, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH-së;
- Akte të tjera ligjore/nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituar.

f. Standardet e Auditimit

ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

g) Metodat e auditimit

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin . Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve

ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepëricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit

h) Dokumentimi i auditimit

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 246, datë 29.12.2022 dhe atij të përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 245, datë 29.12.2022, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i Përgjithshëm

Akademia e Sigurisë është krijuar me Vendim nr.184, datë 20.12.1971 të Këshillit të Ministrave në vijim të Shkollës së Ministrisë së Brendshme. Akademia organizon programe studimi të arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike në të gjitha ciklet, kurse profesionale të formimit bazë dhe të kualifikimit të vazhduar për çdo gradë, kurse specializimi për çdo shërbim e profil dhe trajnim praktik për punonjësit e strukturave si:

Policia e Shtetit, Garda e Republikës, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Shërbimi i Provës, Shërbimi i çështjeve të brendshme në Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Policia Bashkiake, Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Persona fizikë e juridikë që ofrojnë shërbimin e

sigurisë fizike, subjekt të së drejtës private apo publike si dhe Institucione të tjera, pavarësisht emërimit, të krijuara me akte të tjera që operojnë në fushën e rendit dhe të sigurisë publike.

Njësitë kryesore përbërëse të Akademisë së Sigurisë janë: Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit si dhe Kolegji Profesional i Formimit Policor.

AS-ja gëzon status të veçantë, dhënë me Vendimin nr. 881, datë 28.10.2020 të Këshillit të Ministrave “*Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike, si dhe organizimin dhe funksionimin e saj*”. Statusi i veçantë i Akademisë konsiston në harmonizimin e ligjit për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë me ligjet përkatëse të Policisë së shtetit dhe të institucioneve të tjera ligj zbatuese.

Akademia e Sigurisë si institucion i arsimit të lartë është akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit nr.07, datë 27.01.2023 të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në Republikën e Shqipërisë. Bordi i Akreditimit ka dhënë vlerësimin përfundimtar pozitiv për Akademinë duke e akredituar për pesë vite. Gjithashtu, me vendim nr. 97, datë 23.9.2023 të Bordit të Akreditimit u akreditua programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor” në ‘Siguria dhe hetimi’ me kohëzgjatje 4 (katër) vite.

Referuar VKM nr.320, datë 02.6.2021 “*Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimin e saj*”, Akademia është njësi shpenzuese brenda programit buxhetor të Policisë së Shtetit.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit.

Në përputhje me VKM Nr. 320, datë 02.06.2021 *Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 881, Datë 28.10.2020, “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimin e saj, pika 9, Akademia e Sigurisë financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme. Akademia e Sigurisë është njësi shpenzuese më vete brenda programit buxhetor të Policisë së Shtetit.*

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Procedura për përgatitjen PBA 2023-2025
- Çelja e buxhetit dhe ndryshimet buxhetore për vitin 2022
- Realizimi i buxhetit 2022
- Procedura për përgatitjen PBA 2024-2026
- Çelja e buxhetit dhe ndryshimet buxhetore për vitin 2023
- Realizimi i buxhetit 2023
- Situacionet e shpenzimeve dhe të ardhurave
- Të tjera dokumente mbështetëse

Baza ligjore për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit është:

- Udhëzimin e Përhershëm të Ministrisë së Financave nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;
- Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”;
- Ligji nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”

- VKM Nr. 881, Datë 28.10.2020, “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit e saj”, i ndryshuar me VKM Nr. 320, datë 02.06.2021.
- Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.
- Udhëzimit Plotësues nr. 1, datë 10.01.2022, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022” të MFE;
- Udhëzimit nr.9, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”;
- VKM nr.130, datë 02.03.2022 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023 – 2025”;
- Udhëzimin Plotësues nr. 22, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023- 2025”;
- VKM nr. 535, datë 29.07.2022 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023- 2025”;
- Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” të MFE;
- Udhëzimit Plotësues nr. 2/1, datë 06.06.2023, “Për një shtesë në udhëzimin plotësues nr. 2 datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” të MFE;
- Udhëzimit nr.5, datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”;
- VKM nr. 195, datë 05.04.2023 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024 – 2026”;
- Udhëzimin Plotësues nr. 22, datë 07.07.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024- 2026”;
- VKM nr. 436, datë 19.07.2023 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024- 2026”;
- Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative.

1.1 Buxheti i vitit 2022

Përgatitja e PBA 2023 – 2025

Në kuadër të hartimit të PBA – së 2023 – 2025 dhe në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për Procedurat standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, të ndryshuar, të udhëzimit nr.9, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025" dhe VKM nr.130, datë 02.03.2022 "Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023 - 2025", Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me shkresën nr. 2258 prot., datë 27.06.2022 ka kërkuar nga ana e Akademisë së Sigurisë plotësimin e pasqyrave të Shtojcës 1/A për fazën e dytë të PBA 2023 – 2025.

Me urdhër të Drejtuesit të Akademisë së Sigurisë nr. 247, dt. 29.06.2022, “Mbi ngritjen e komisioneve për hartimin e kërkesave për PBA 2023 – 2025”, është ngritur grupi i punës për përgatitjen e PBA 2023 – 2025. Në vijim nga ana e AS me shkresën 1391/4, datë 12.07.2022 janë dërguar në Drejtorinë e Financave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasqyrat e PBA – së për periudhën 2023 – 2025, detajuar si në ***Aneksin nr.1/1*** të Raportit të Auditimit.

Buxheti 2022

b. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Me shkresën nr. 10084/4, datë 27.01.2022 Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme ka përcjelle në njësinë shpenzuese “Akademia e Sigurisë”, detajimin e buxhetit për shpenzimet korrente për vitin 2022, sipas artikujve kryesorë të strukturës buxhetore, detajuar si vijon:

1. Artikulli 600 “Paga dhe shpenzime të tjera personeli” është llogaritur për:

- a) Paga bazë ushtarake (paga për gradë);
- b) Shtesë page për funksion;
- c) Shtesë page për Vjetërsi;
- d) Paga së bashku me shtesat për punonjësit civilë,
- e) Shtesë page për vështirësi dhe rreziqe (Dëmshmëri shëndeti);
- f) Shtesë page për pune në turne të dyta e të treta;
- g) Shtesë page për punë jashtë orarit;
- h) Shpenzime për paga për oficeret e kontaktit.

Këto detyrime janë llogaritur bazuar në numrin e punonjesve sipas strukturës organike të miratuar (jo sipas numrit faktik), diferenca e fondit është kaluar në zërin shtesë page për turne të 2-ta e të 3-ta dhe shtesë page për punë jashtë orarit.

2. Detajimi i shpenzimeve në artikullin 601 "Kontribute për Sigurime shoqërore e shëndetësore", është llogaritur për numrin e punonjesve sipas strukturës organike të miratuar.

3. Për shpenzimet në artikullin 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, është bërë shpërndarja në nënartikujt sipas detajimit të dërguar nga AS në DPPSH.

4. Detajimi i shpenzimeve të miratuara në artikullin 606 "Transferimet buxhetore për familjaret e individët" është bërë:

- a) Për numrin e punonjesve që trajtohen me pagesë kalimtare;
- b) Për numrin e bashkëshortëve të ushtarakeve të transferuar;
- c) Pagesë për kompensime ushqimore;
- d) Pagesë për Kursantet e Akademisë së Sigurisë;
- e) Shpenzime të Veçanta (pune sekrete);
- f) Pagesë për Ndhima ekonomike për familjet e Policëve të vvarë.

Detajimi i buxhetit është mbështetur në limitin e përcaktuar nga Ministria e Financave, kërkesat e projekt - buxhetit për vitin 2022 dhe realizimin e buxhetit për vitin 2022 për secilën njësi shpenzuese, duke synuar financimin e aktiviteteve prioritare të Policisë, në përputhje me strategjitë sektoriale e ndërsektoriale, Planin e Integruar të Ministrisë (PIM), dhe strategjinë e Policisë së Shtetit, e paraqitur në mënyrë të përmbledhur në ***Aneksin nr.1/2*** të Raportit të Auditimit.

Në zbatim të Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, pika 66-74, me shkresën nr. 601/6 prot., datë 14.02.2022 të SP të Ministrisë së Brendshme, është dërguar në AS detajimi i fondit të veçantë për vitin 2022. Fondi i veçantë i miratuar për AS është në vlerën 800 mijë lekë për llogarinë 6060000 “Punonjës të trajtuar me pagë kalimtare”.

Ndryshimet buxhetore përgjatë vitit 2022

- Me Aktin Normativ nr.3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, është pakësuar me 6,275 mijë lekë fondi për llogarinë 600, me 799 mijë lekë fondi për llogarinë 601 dhe me 2,700 mijë lekë fondi për llogarinë 602.

- Me shkresën nr. 6524/1 prot, datë 23.06.2022 të Ministrisë Brendshme është njoftuar AS mbi shtesën e fondit për llogarinë 602 në vlerën 1,341 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 15691/1 prot., datë 29.08.2022 të MFE është miratuar shtesa për llogarinë 606 në vlerën 10,200 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 10642/6 prot, datë 01.11.2022 të Ministrisë Brendshme është njoftuar AS mbi shtesën e fondit për llogarinë 601 në vlerën 1,500 mijë lekë dhe pakësimin për llogarinë 600 në vlerën 4,000 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 3989 prot, datë 18.11.2022 të Ministrisë Brendshme është njoftuar AS mbi rialokimin e fondeve brenda llogarisë 602 në vlerën 980 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 11260/2 prot, datë 16.11.2022 të Ministrisë Brendshme është njoftuar AS mbi shtesën e fondit për llogarinë 600 në vlerën 2,500 mijë lekë dhe për llogarinë 606 në vlerën 1,100 mijë lekë, si dhe pakësimin për llogarinë 601 në vlerën 500 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 3815/1 prot, datë 21.11.2022 të Ministrisë Brendshme është njoftuar AS mbi rialokimin e fondeve brenda llogarive 602 dhe 606 në vlerën 393 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 4316/4 prot, datë 21.12.2022 të Ministrisë Brendshme është njoftuar AS mbi rialokimin e fondeve brenda llogarisë 602 në vlerën 2,673 mijë lekë.
- Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar është shtuar me 41,180 mijë lekë fondi për llogarinë 602.

- Me VKM nr. 898, datë 29.12.2022 është miratuar shtesa prej 2,040 mijë lekë për llogarinë 606.

Konstatim 1: Grupi i auditimit konstatoi se gjatë periudhes Maj – Shtator të vitit 2022 nga ana e Akademisë së Sigurisë është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit shtesë fondi për kryerjen e pagesës së akreditimit të institucionit, pagesave të kursantëve dhe utilitare. Për shkak të mungesës së fondeve ka patur vonesa në likuidimin e këtyre detyrimeve duke tejkaluar dhe afatet e përcaktuara.

Realizimi i buxhetit për vitin 2022

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion prej subjektit të audituar mbi realizimet buxhetore për vitin 2022 sipas ligjit të buxhetit nr. 115, datë 25.11.2021 në **Aneksin nr.1/3** të Raportit të Auditimit.

Referuar të dhënave në **Aneksin nr.1/3** rezulton se nuk ka në asnjë program me tejkalim të realizimit të fondeve të programuara. Në total realizimi vjetor është 99.94 % e fondeve të alokuara.

Akademia e Sigurisë realizon të ardhura sipas kategorive të mëposhtme:

- Të ardhurat nga kontrata e qerasë nr. 14/2 prot., datë 18.05.2022 me operatorin ekonomik shoqëria “B. T.”, për një afat 1 – vjeçar, nga data 01.05.2022 – 30.04.2023, për dhënien me qera të një sipërfaqe 111.9 m2, me vlerë 24,780 lekë në muaj. Në datën 31.08.2022 subjekti “B. T.” ka bërë kërkesë për ndërprerjen e kontratës, kërkesë e cila është miratuar nga AS.
- Të ardhurat nga kontrata e qerasë nr. 1752 prot., datë 26.08.2022 me operatorin ekonomik shoqëria “S.” shpk, për dhënien me qera të një sipërfaqe 400 m2 për ambientin “Kuzhinë”, në vlerën 192,000 lekë në muaj, për periudhën 26.08.2022 – 31.07.2023.
- Të ardhurat nga kontrata e qerasë nr. 38/3, datë 01.10.2021, me operatorin ekonomik “T. M.” PF, për vendosjen e distributorëve automatik për shpërndarjen e produkteve të ftohta/ngrohta, në vlerën 8,142 lekë në muaj.
- Të ardhurat nga kontrata e qerasë nr. 2127/5, datë 01.11.2022, me operatorin ekonomik “D. M.” PF, për vendosjen e distributorëve automatik për shpërndarjen e produkteve të ftohta/ngrohta, në vlerën 7,904 lekë në muaj. Për dhënien me qera, nga njësia është marrë miratimi i Zv. Drejtori i Përgjithshëm i DPPSH, me shkresën nr. 2278/2, datë 19.06.2023.

- Të ardhurat nga veprimtaria kryesore (licensat) përfaqësojnë të ardhura për trajnimin e punonjësve që punësohen në SHPSF-të e ndryshme dhe në zbatim të Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Financave nr. 345, datë 24.06.2015 tarifa ditore është 2500 lekë.
- Të ardhurat nga gjoha/urdhër zhdëmtime kanë të bëjnë me arkëtimin e detyrimeve që punonjësit kanë ndaj AS ose Zyrave të Përmbarimit. Arkëtimi bëhej në bazë dhe në zbatim të urdhër zhdëmtimit të nënshkruar nga punonjësi. Nga auditimi mbi procedurën dhe arkëtimin e kësaj të ardhure, rezultoi se arkëtimi bëhej duke kryer ndalesa në listë pagesë.
- Të ardhura nga shitja dhe veprimtaria ekonomike përfaqësojnë arkëtimet nga subjektet qeramarrëse për konsumin e ujit dhe energjisë elektrike në ambientin e marrë me qera nga Akademia e Sigurisë. Nga auditimi mbi procedurën dhe arkëtimin e kësaj të ardhure, rezultoi se arkëtimi bëhej mbi bazën e faturave mujore të konsumit të energjisë elektrike të konsumuar dhe ujit të pijshëm të konsumuar nga subjektet dhe faturës për arkëtim të lëshuar nga sektori i financës.

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion prej subjektit të audituar në *Aneksin nr.1/4* të Raportit të Auditimit paraqitet niveli i realizimit të të ardhurave të vitit 2022, të ardhura të cilat derdhen plotësisht në buxhetin e shtetit.

Realizimi i të ardhurave paraqitet në nivelin e moderuar prej 75% për arsye se arkëtimi i të ardhurave nga kontrata e qerasë me subjektin S. sh.p.k, e cila parashikohej të niste në fillim të vitit 2022, ka nisur në Shtator të vitit 2022.

1.2 Buxheti i vitit 2023

Përgatitja e PBA 2024 – 2026

Në kuadër të hartimit të PBA – së 2024 – 2026 dhe në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për Procedurat standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, të ndryshuar, të udhëzimit nr.5, datë 28.02.2023 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026", Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me shkresën nr. 2189 prot., datë 19.06.2023 ka kërkuar nga ana e Akademisë së Sigurisë plotësimin e pasqyrave të Shtojcës 1/A për fazën e dytë të PBA 2024 – 2026.

Me urdhër të Drejtuesit të Akademisë së Sigurisë nr. 291, dt. 23.06.2023, “Mbi ngritjen e komisioneve për hartimin e kërkesave për PBA 2024 – 2026”, është ngritur grupi i punës për përgatitjen e PBA 2024 – 2026.

Në vijim nga ana e AS me shkresën 1429/5, datë 07.07.2023 janë dërguar në Drejtorinë e Financave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasqyrat e PBA – së për periudhën 2024 – 2026, detajuar në *Aneksin nr.1/5* të Raportit të Auditimit.

Në krahasim me vitin 2022, kërkesat për shpenzimet buxhetore janë rritur me 27%, për arsye të rritjes së numrit të punonjësve, nga 161 në 170, rritjes së pagesave për shtesë turni, si dhe shpenzimeve më të larta për materiale dhe shërbime.

Buxheti 2023

b. Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Me shkresën nr. 1638, datë 17.02.2023 Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka përcjellë në njësinë shpenzuese “Akademia e Sigurisë”, detajimin e buxhetit për shpenzimet korrente për vitin 2023, sipas artikujve kryesorë të strukturës buxhetore, detajuar si vijon:

1. Artikulli 600 “Paga dhe shpenzime të tjera personeli” është llogaritur për:

- i) Paga bazë ushtarake (paga për gradë);
- j) Shtesë page për funksion;
- k) Shtesë page për Vjetërsi;
- l) Paga së bashku me shtesat për punonjësit civilë,
- m) Shtesë page për vështirësi dhe rreziqe (shëndeti);
- n) Shtesë page për pune në turne të dyta e të treta;
- o) Shtesë page për punë jashtë orarit;
- p) Shpenzime për paga për oficeret e kontaktit

Këto detyrime janë llogaritur bazuar në numrin e punonjësve sipas strukturës organike të miratuar (jo sipas numrit faktik), diferenca e fondit është kaluar në zërin shtesë page për turne të 2-ta e të 3-ta dhe shtesë page për punë jashtë orarit.

2. Detajimi i shpenzimeve në artikullin 601 "Kontribute për Sigurime shoqërore e shëndetësore", është llogaritur për numrin e punonjësve sipas strukturës organike të miratuar.

3. Për shpenzimet në artikullin 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, është bërë shpërndarja në nën artikujt si më poshtë vijon:

- a) Financimin e detyrimeve të pa likuiduara gjatë vitit 2022,
- b) Angazhimet e marra për periudhën më të gjatë se një vit,
- c) Financimin e detyrimeve për energji elektrike, ujë, shërbime postare, telefonike.
- d) Financimin e nevojave prioritare që ka njësia shpenzuese për vitin 2023, për të siguruar veprimtari normale gjatë gjithë vitit buxhetor,
- e) Financimin e shërbimit për akomodim e ushqim të oficerëve të vendeve fqinje për periudhën e sezonit veror,
- f) Financimi i shpenzimeve për mjetet me qera, në zbatim të kontratave të nënshkruara, do të bëhet në QFMT (Qendra e Furnizimit Materialo – Teknik në DPPSH), sipas udhëzimit përkatës që u është dërguar të gjitha njësiteve shpenzuese me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë
- g) Në zërin Softe informatike me karakter të përgjithshëm, (6021011), janë fondet për blerje të një programi financiar të licensuar.

4. Detajimi i shpenzimeve të miratuara në artikullin 606 "Transferimet buxhetore për familjaret e individët" është bërë:

- g) Për numrin e punonjësve që trajtohen me pagesë kalimtare;
- h) Për numrin e bashkëshortëve të ushtarakeve të transferuar;
- i) Pagesë për kompensime ushqimore;
- j) Pagesë për Kursantet e Akademisë së Sigurisë;
- k) Shpenzime të Veçanta (pune sekrete);
- l) Shpenzime për Programet e Mbrojtjes;
- m) Pagesë për Ndihma ekonomike për familjet e Policëve të vvarë;
- n) Pagesë për largësi vendbanimi nga qendra e banimit sipas VKM nr.451, datë 29.06.2022,

Detajimi i buxhetit është mbështetur në limitin e përcaktuar nga Ministria e Financave, kërkesat e projekt - buxhetit për vitin 2023 dhe realizimin e buxhetit për vitin 2023 për secilën njësi

shpenzuese, duke synuar financimin e aktiviteteve prioritare të Policisë, në përputhje me strategjitë sektoriale e ndërsektoriale, Planin e Integruar të Ministrisë (PIM), dhe strategjinë e Policisë së Shtetit, e paraqitur në mënyrë të përmblëdhur në **Aneksin nr.1/6** të Raportit të Auditimit.

Në zbatim të Ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, pika 62-70, me shkresën nr. 1006/5 prot., datë 23.02.2023 të SP të Ministrisë së Brendshme, është dërguar në AS detajimi i fondit të veçantë për vitin 2023. Fondi i veçantë i miratuar për AS është në vlerën 700 mijë lekë për llogarinë 6060000 “Punonjës të trajtuar me pagë kalimtare”.

Ndryshimet buxhetore përgjatë vitit 2023

- Me shkresën nr. 4565/4 prot, datë 31.05.2023 të Ministrisë Brendshme është njoftuar AS mbi shtesën e fondit për shpenzime personeli në vlerën 8,623 mijë lekë, në zbatim të VKM – së nr. 239, datë 20.04.2023, VKM – së nr. 238, datë 20.04.2023 dhe VKM – së nr. 242, datë 20.04.2023.

-Me shkresën nr. 5472/2 prot, datë 08.06.2023 të Ministrisë Brendshme është njoftuar AS mbi shtesën e fondit për llogarinë 602 në vlerën 3,060 mijë lekë.

-Me shkresën nr. 4486/4 prot, datë 27.06.2023 të Ministrisë Brendshme është njoftuar AS mbi shtesën e fondit për llogarinë 606 në vlerën 9,885 mijë lekë dhe pakësimin për llogarinë 600 në vlerën 1,000 mijë lekë.

-Me shkresën nr. 9782/1 prot, datë 21.09.2023 të Ministrisë Brendshme është njoftuar AS mbi transferimin e fondit shtesë në llogarinë 601 në vlerën 2,300 mijë lekë, në llogarinë 602 në vlerën 29,175 mijë lekë, dhe në llogarinë 606 në vlerën 150 mijë lekë.

-Me shkresën nr. 9927/4 prot, datë 18.10.2023 të Ministrisë Brendshme është njoftuar AS mbi shtesën e fondit për llogarinë 606 në vlerën 12,800 mijë lekë

-Me shkresën nr. 4486/4 prot, datë 27.06.2023 të Ministrisë Brendshme është njoftuar AS mbi shtesën e fondit për llogarinë 602 në vlerën 3,330 mijë lekë, në zbatim të Aktit Normativ nr. 5, datë 18.10.2023.

- Me shkresën nr. 4517 prot, datë 06.11.2023 të Ministrisë Brendshme është njoftuar AS mbi rialokimin e fondeve brenda llogarive 602 në vlerën 1,048 mijë lekë.

- Me shkresën nr. 17233/1 prot, datë 16.11.2023 të Ministrisë Brendshme është njoftuar AS mbi pakësimin e fondeve të llogarisë 600 në vlerën 4,600 mijë lekë dhe llogarisë 601 në vlerën 1,900 mijë lekë.

-Me shkresën nr. 18542/5 prot, datë 29.12.2023 të Ministrisë Brendshme është njoftuar AS mbi shtesën e fondit për llogarinë 602 në vlerën 8,235 mijë lekë, në zbatim të Aktit Normativ nr. 6, datë 14.12.2023.

Me shkresën nr. 5122 prot., datë 27.12.2023 të Ministrisë Brendshme është njoftuar AS mbi rialokimin e fondeve brenda llogarive 602 në vlerën 12,048 mijë lekë.

Konstatim 2: Grupi i auditimit konstatoi se gjatë periudhes Maj – Shtator të vitit 2023 nga ana e Akademisë së Sigurisë është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit shtesë fondi për kryerjen e pagesës për shërbimin e ushqimit dhe pagesës së kursantëve për parullë të përgjithshme. Për shkak të mungesës së fondeve ka patur vonesa në likuidimin e këtyre detyrimeve duke tejkalluar dhe afatet e përcaktuara.

Realizimi i buxhetit për vitin 2023

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion prej subjektit të audituar mbi realizimet buxhetore për vitin 2023 sipas ligjit të buxhetit 84/2022, në **Aneksin nr.1/6** të Raportit të Auditimit, paraqitet niveli i realizimit të buxhetit të vitit 2023:

Referuar të dhënave në *Aneksin nr.1/6* sipërcituara rezulton se nuk ka në asnjë program tejkalim të realizimit të fondeve të programuara. Në total realizimi vjetor është 98 % e fondeve të alokuara.

Akademia e Sigurisë realizon të ardhura sipas kategorive të mëposhtme:

- Të ardhurat nga kontrata e qerasë nr. 1753 prot., datë 01.08.2023 me operatorin ekonomik shoqëria “S.” ShPK, për ambientin “Kuzhinë”, në vlerën 205,680 lekë në muaj. Për dhënien me qera, nga njësia është marrë miratimi i MFE, me shkresën nr. 16502/6, datë 12.07.2023.
- Të ardhurat nga kontrata e qerasë nr. 1444, datë 23.06.2023 me operatorin ekonomik shoqëria “S.” ShPK, për ambientin “Bar – Kafe”, në vlerën 107,000 lekë në muaj.
- Të ardhurat nga kontrata e qerasë nr. 2127/5, datë 01.11.2022, amenduar me aneks kontratën nr. 1492 prot, datë 30.06.2023 me operatorin ekonomik “D. M.” PF, për vendosjen e distributorëve automatic për shpërndarjen e produkteve të ftohta/ngrohta, në vlerën 7,904 lekë në muaj. Për dhënien me qera, nga njësia është marrë miratimi i Zv/Drejtori i Përgjithshëm i DPPSH, me shkresën nr. 2278/2, datë 19.06.2023.
- Të ardhurat nga veprimtaria kryesore (licensat) përfaqësojnë të ardhura për trajnimin e punonjësve që punësohen në SHPSF-të e ndryshme dhe në zbatim të Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Financave nr. 345, datë 24.06.2015 tarifa ditore është 2500 lekë.
- Të ardhurat nga gjopa/urdhër zhdëmtime kanë të bëjnë me arkëtimin e detyrimeve që punonjësit kanë ndaj AS ose Zyrave të Përmbartimit. Arkëtimi bëhet në bazë dhe në zbatim të urdhër zhdëmtimit të nënshkruar nga punonjësi. Nga auditimi mbi procedurën dhe arkëtimin e kësaj të ardhure, rezultoi se arkëtimi bëhet duke kryer ndalesa në listë pagesë.
- Të ardhura nga shitja dhe veprimtaria ekonomike përfaqësojnë arkëtimet nga subjektet qeramarrëse për konsumin e ujit dhe energjisë elektrike në ambientin e marrë me qera nga Akademia e Sigurisë. Nga auditimi mbi procedurën dhe arkëtimin e kësaj të ardhure, rezultoi se arkëtimi bëhet mbi bazën e faturave mujore të konsumit të energjisë elektrike të konsumuar dhe ujit të pijshëm të konsumuar nga subjektet dhe faturës për arkëtim të lëshuar nga sektori i financës.

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion prej subjektit të audituar në *Aneksin nr.1/6* të Raportit të Auditimit, paraqitet niveli i realizimit të të ardhurave të vitit 2023, të ardhura të cilat derdhen plotësisht në buxhetin e shtetit:

Të ardhurat janë realizuar në masën 115%, për shkak të tejkalimi të parashikimit për llogarinë 7109600, për arsye se nuk ishte planifikuar arkëtimi i plotë vjetor i të ardhurave nga qeraja me operatorin ekonomik shoqëria “S.” ShPK.

2.2. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

1. Respektimi i strukturës së miratuar në Akademinë e Sigurisë dhe krahasimi me faktin.

Akademia e Sigurisë (në vijim “AS”) ka si mision zhvillimin e veprimtarive mësimore e shkencore në të gjitha ciklet e studimit nga njësitet kryesore në arsimin e lartë, në fushën e rendit e të sigurisë publike dhe përgatit specialistë për këto fusha. Ofron programe formimi, trajnimi të vazhduar për ecurinë në karrierë dhe specializime për të gjitha nivelet në Policinë e Shtetit dhe për institucionet kërkuese e përfituese të sigurisë publike dhe i certifikon ato.

Nga auditimi i strukturës organizative në funksion të objektivave të institucionit për periudhën në auditim u konstatua se është krijuar e ndryshuar në bazë të këtyre akteve ligjore:

1. Urdhër nr.288 datë 19.05.2017 “Për miratimin e strukturës organike të Akademisë së Sigurisë” nënshkruar nga Ministri i Brendshëm. Më pas me Urdhër nr.176, datë 13.03.2018 për “Disa

ndryshime në Urdhrin nr.288 datë 19.05.2017”. Urdhër nr.400 datë 02.04.2019 “Për disa ndryshime në emërtimet e funksioneve organike në strukturat e policisë së shtetit”. Në këtë urdhër emërtimi “Nëpunës civil” zëvendësohet me emërtimin “Punonjës administrativ”.

2.Më 21.12.2021 Urdhër për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Akademisë së Sigurisë nr.385, nr.3888/9 prot., nënshkruar nga Ministri i Brendshëm. Struktura përfshin 156 punonjës. Efektet administrative dhe financiare të kësaj strukture dhe organikës fillojnë në përfundimin e vitit akademik 2021-2022. Ky urdhër nuk është ekzekutuar.

3.Më 26.10.2022 Urdhër për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Akademisë së Sigurisë nr.5449/6 prot nënshkruar nga Ministri i Brendshëm. Urdhër “Për disa ndryshime në Urdhrin e Ministrisë së Brendshme nr.177 datë 13.03.2018”. Sipas këtij Urdhri struktura do të ketë 170 punonjës dhe në strukturë është shtuar Qendra e Edukimit Fizik dhe Sporteve Elitare që përbëhet nga 3 sektorë dhe ka gjithsej 13 punonjës. Gjithashtu pati ndryshime në numrin e përgjithshëm të punonjësve në Departamente e Sektorë të ndryshëm si dhe në emërtimin e tyre. Drejtoria e Mbështetjes Akademike eliminohet dhe vendoset Zyra ndihmëse e Rektorit. Sektori i Kurrikulave dhe Kontrollit të Cilësisë kthehet në Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë (që përbehet nga Sektori i kurrikulave dhe Koordinimit dhe Sektori i Sigurimit të Cilësisë dhe Shërbimeve Studentore). Qendra e kërkimeve shkencore nuk varet më nga Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit por është strukturë më vete dhe nga 3 sektorë ka kaluar në 2. Qendra e Trajnimeve Taktike/operacionale nuk është më pjesë e Kolegjit Profesional të Formimit Policor por qëndron më vete dhe përbëhet nga 2 sektorë. Shtohet Qendra e Edukimit Fizik dhe Sporteve Elitare që përbëhet nga 1 sektor dhe 2 seksione. Nuk është më Sektori i Disiplinës dhe Sigurisë së bashku me Seksionin e Mbikëqyrjes dhe Disiplinës (varësie) por vetëm Seksioni i Sigurisë.

4.Urdhër nr.47, datë 14.04.2023 për “Miratimin e strukturës dhe të organikës në nivel qendror, vendor dhe strukturat e veçanta të Policisë së Shtetit”. Sipas Organigramës së këtij Urdhri, vihen re disa ndryshime krahasuar me Urdhrin e vitit 2022. Administratori në ndryshim nga urdhri paraardhës nuk është në varësi të Bordit të Administrimit por të Rektorit dhe nuk ka më në varësi Seksionin e Sigurisë, por vetëm Sektorin e Financave dhe Sektorin Ekonomik. Sektori i Sigurisë tanimë në varësi të Sektorit të Burimeve Njerëzore.

5.Urdhër nr.688 datë 10.05.2023 “Për Implementimin e Strukturës Organike në Policinë e Shtetit”.

5.Urdhër nr.136, datë 22.09.2023 për “Disa ndryshime në Urdhrin nr.47, datë 14.04.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës në nivel qendror, vendor dhe strukturat e veçanta të policisë shtetit” nr.4191/20. Në këtë urdhër evidentohen ndryshimet në klasat e pagave.

Konstatim:

Nga auditimi i strukturës së AS u konstatua se ndryshimet e kryera në strukturën e institucionit ***nuk janë reflektuar gjithmonë në Rregulloren e tij***. Në Akademinë e Sigurisë janë miratuar gjithsej dy rregullore, e para me Vendim Senati nr.25, datë 18.12.2016 dhe e dyta me Vendimin nr.77, datë 02.05.2023 nga Senati i Akademisë së Sigurisë. Ndryshimet e kryera nga viti 2017 deri në vitin 2022 nuk janë pasqyruar në rregullore dhe derisa ka dalë rregullorja e re në vitin 2023, AS ka funksionuar me të vjetrën e cila nuk është përputhur me strukturën dhe ndryshimet e saj. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 9 pika 4, Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues, ku citohet se: *Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore: a) propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi; b) hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat*

e miratuar nga titullari i njësisë publike; Pika 4a) propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, si dhe Pika 4/f) Ndarjen e përgjegjësiqe që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë e deleguara. Shkak për këtë konstatim është neglizhenca institucionale nga ana e strukturave përgjegjëse dhe efekti që sjell është paqartësi në përshkrimet e punës dhe strukturën e përgjithshme të institucionit. Rëndësia e mesme.

2. Rekrutime, dalje në pension, masa disiplinore, largime, vende vakante.

Akademia e Sigurisë kryen procedurën e rekrutimeve për personelin e strukturës administrative të institucionit. Si fillim AS i dërgon një shkresë APP për publikim me shkresë dhe me CD njoftimin për shpalljen e kriterëve për pozicionin vakant (në rastin konkret shkresa nr.2409/1 prot., datë 04.11.2022 për pozicionin e Specialist Jurist në Sektorin Ekonomik). Më pas me përfundimin e afatit, me anë të një procesverbali (në këtë rast nr.2 datë 17.11.2022) pasqyrohet zhvillimi i mbledhjes së komisionit të vlerësimit të aplikantëve të cilët kërkojnë të punësohen në funksione administrative në strukturat e AS. Në këtë procesverbal shqyrtohen dosjet e aplikantëve dhe vlerësohen me pikë. Gjithashtu përshkruhet se pas përfundimit të shqyrtimit të dokumentacionit komisioni mori në intervistë të dy aplikantët dhe më poshtë vendoset tabela e vlerësimit me pikë. Më pas Komisioni i Vlerësimit publikon Vendim (në këtë rast nr.01 datë 21.11.2022) ku përshkruhen rezultatet e kandidatëve dhe i rekomandohet Rektorit të Akademisë së Sigurisë vazhdimi i procedurave për pranimin e fituesit në funksionin vakant. Më pas Rektori publikon Urdhër (në këtë rast nr.544 datë 05.12.2022) për Pranimin dhe Emërimin në Strukturën Administrative të një punonjësi administrativ. Gjithsej në vitin 2022 janë rekrutuar 7 punonjës dhe në vitin 2023 janë rekrutuar 7 punonjës. *Jo të gjitha dosjet ndodhen në AS pasi Sektori i Burimeve Njerëzore administron vetëm dosjet e punonjësve mbështetës të Administratës.*

Dalje në pension

Pensione 2022-2023			
Nr.	Punonjës Administrativ	Punonjës policie	Gjithsej
1	6	7	13

Burimi: AS, përpunuar nga grupi i auditimit

Gjithsej në periudhën objekt auditimi janë liruar për shkak të mbushjes së moshës së pensionit 13 punonjës. Në vitin 2022 janë liruar nga policia e shtetit 5 punonjës, ndërsa në vitin 2023 janë liruar 8 punonjës. Ndërkohë që ka patur vetëm një procedurë për shtyrjen e afatit të daljes në pension të një punonjësi, konkretisht Prof.As.I... N.....me detyrë Përgjegjës Departamenti, në Departamentin e Ruajtjes dhe Sigurisë Publike në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, në Akademinë e Sigurisë. Akademia e Sigurisë me shkresën nr.31/1 prot datë 21.01.2022 drejtuar Drejtuesit të Përgjithshëm të Policisë bëjnë kërkesën që I... N..... për shkak të ngarkesës së madhe t'i shtyhet afati i daljes në pension për 1 vit. Me shkresën nr.239/1 prot., datë 08.02.2022 miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit kërkesa për shtyrjen e afatit të daljes në pension pleqërie për Drejtuesin e parë I... N....., deri në përfundim të procesit mësimor në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, në Akademinë e Sigurisë, për vitin akademik 2021-2022.

Masa disiplinore

Në periudhën objekt auditimi 2022-2023, rezulton vetëm një masë disiplinore e brendshme për një punonjës policie. Vendim nr.53 datë 06.12.2023 “Për dhënie mase disiplinore një punonjësi policie”. N/Komisar A.R. me detyrë Specialist/Instruktur në Departamentin e Aftësimit Policor në Kolegjin Profesional të Formimit Policor, në Akademinë e Sigurisë merr masën disiplinore “Vërejtje”. Ky Vendim u nënshkrua nga Drejtori i Kolegjit Profesional i Formimit Policor. Në Raportin Përfundimtar të Verifikimit të Hetimit Disiplinor datë 06.12.2023 drejtuar Drejtorit të

Kolegjit Profesional të Formimit Policor, rezulton se instruktori nuk ndodhej në vendin e punës duke lënë pa zhvilluar aktivitetin sportiv në procesin mësimor dhe nuk i përgjigjej thirrjeve telefonike të kryera nga eprori i drejtpërdrejtë në kontrollin e datës 23.10.2023 për vijimin e procesit mësimor nga Komisar J.H.

Gjithashtu është dorëzuar nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore edhe një procedurë masë disiplinore e ardhur nga jashtë. Vendim nr.24 datë 31.01.2022 për “Pezullimin disiplinor të një punonjësi policie” nënshkruar nga Komandanti i Repartit Special Renea, ku urdhërohet që Komisari G.O. me detyrë Shef Seksioni për taktikat, teknikat dhe standartet e ndërhyrjes në Repartin Special “RENEA” për shkelje të rëndë disiplinore parashikuar nga neni 206, pika 6 “Mungon pa arsye nga puna mbi 3 ditë” të pezullohet disiplinarisht nga detyra 3 (tre) ditë pune deri në dokumentimin e plotë të shkeljes 31.01.2022-02.02.2022.

Largime

Largimet nga strukturat e Policisë së Shtetit për periudhën 2022-2023 janë reflektuar në tabelën më poshtë:

Largime 2022-2023			
Nr.	Viti 2022	Viti 2023	Gjithsej
1	8	6	14

Burimi: AS, përpunuar nga grupi i auditimit

- 13 prej këtyre largimeve kanë ndodhur me kërkesën e vetë punonjësit, ndërsa njëra prej tyre ka ndodhur për shkak se punonjësi është dënuar me masën “arrest me burg”.

Sikurse vihet re në tabelën e mësipërme, në fund të vitit 2022 numërohen 23 vende vakante, që është rreth 13,5% e totalit të strukturës së parashikuar për Akademinë e Sigurisë.

Nga auditimi i pozicioneve vakante të AS u konstatua se “Qendra e Edukimit Fizik dhe Sporteve Elitare” e cila përbëhet nga Shef Sektori, Seksioni i Sporteve Individuale (që ka 6 pozicione të parashikuara në strukturë) dhe Seksioni i Rekreacionit (që ka gjithashtu 6 vende të parashikuara në strukturë) vazhdon të ketë të gjitha pozicionet të paplotësuara që nga krijimi i saj në vitin 2022. Kjo bie në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm datë 26.10.2022, nr.5449/6 prot “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Akademisë së Sigurisë” ku përcaktohet se struktura e AS do të ketë të përfshirë edhe Qendrën e Edukimit Fizik dhe Sporteve Elitare, në pikën 3 të urdhrit thuhet se “Numri i punonjësve në organikën e Akademisë së Sigurisë është 170 punonjës.”

Gjithashtu për “Qendrën e Edukimit Fizik dhe Sporteve Elitare” nuk ka një përkrahje të mirëfilltë në rregulloren e institucionit, gjë që bie në kundërshtim me Nenin 1 të Rregullores së Akademisë së Sigurisë, miratuar me Vendim të Senatit të Akademisë së Sigurisë nr.77 datë 02.05.2023 ku thuhet: *Rregullorja e Akademisë së Sigurisë, ka për objekt përcaktimin e parimeve, rregullave, normave të organizimit funksionimit të institucionit, të strukturave përbërëse të tij, veprimtaritë e autoriteteve dhe organeve drejtuese, zgjedhjen apo emërimin e tyre, delegimin e kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave dhe të programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, ndihmës akademik, administrative, studentëve/kursantëve si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e AS-së*”. Shkak për këtë është mungesa e iniciativës nga ana e AS dhe strukturave përgjegjëse për shpalljen e vendeve vakante të institucionit dhe krijimit të një Rregulloreje të mirëstrukturuar. Efekti është një strukturë institucionit e paplotësuar, gjë që sjell mangësi në arritjen e objektivave të institucionit dhe zhvillimin e veprimtarive mësimore e shkencore. Rëndësia e lartë.

3. Mbi Procedurën e Krijimit dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit.

Gjatë auditimit u konstatua se për nëpunësit e AS zbatohen procedurat e legjislacionit për Kodin e punës parashikuar për institucionet e administratës shtetërore dhe gjithashtu Rregullorja e Policisë së Shtetit miratuar me VKM nr.750, datë 16.09.2015 i ndryshuar. Nga auditimi me përzgjedhje rastësore të dosjeve të personelit, ku u audituan 20 dosje rezultoi se në përgjithësi ato administrohen të inventarizuara në zbatim VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Nga auditimi i dokumentacionit pjesë e dosjeve të personelit, rezulton se pothuajse në të gjitha dosjet e personelit **mungon Libreza e Punës**, në mospërputhje me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, lidhja nr. 1, pika g “*libreza e punës*”. Vihet re mungesa e raportit mjeko-ligjor në 3 dosje personeli në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, lidhja 1, pika gj “*raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor si dhe konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë*”. Në 4 dosje fleta prezantuese është e paplotësuar dhe në 2 dosje Lista Regjistruese e Dokumentave është e paplotësuar, në kundërshtim me lidhjen nr.2 të VKM nr.833, datë 28.10.2020.

Në Akademinë e Sigurisë gjenden të administruara dosjet e punonjësve mbështetës të Administratës, ndërsa dosjet e punonjësve të tjerë ndodhen në DPPSH dhe **nuk administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore të AS**. Kjo bie në kundërshtim me Rregulloren e Akademisë së Sigurisë miratuar me Vendim të Senatit të Akademisë së Sigurisë nr.77, datë 02.05.2023 , “Të dhënat e Pozicionit të Punës të Shefit të Sektorit të Burimeve Njerëzore” ku thuhet se: c) *Organizon punën dhe ndjek përgatitjen e praktikave të emërimit, transferimit, të ndërprerjeve të marrëdhënieve të punës, rikthimit në strukturat e Policisë së Shtetit dhe merr masa për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.*

e) *Organizon punën dhe ndjek administrimin e dokumentacionit për pranimin në strukturat e Policisë së Shtetit dhe dokumentacionin për ecurinë në gradë të punonjësve të policisë.*

g) *Organizon punën dhe ndjek krijimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe plotësimin e regjistrave, dosjeve të personelit dhe kartelave personale për administrimin e të dhënave personale për punonjësit e policisë, personelin akademik dhe punonjësit administrativ që janë në organikë të strukturës.* Shkak për këto konstatime është mungesa e vëmendjes institucionale dhe efekti është se jo të gjitha dosjet e personelit janë të plota dhe Struktura e Burimeve Njerëzore të AS nuk kryen të gjitha funksionet e saj. Rëndësia e lartë.

4. Pagesat për trajnimin në Turqi të studentëve

Pas auditimit të pagesave të studentëve rezulton se gjatë vitit akademik 2021-2022, 5 studentë të Akademisë së Sigurisë janë përzgjedhur të kryejnë një trajnim me pagesë në Akademinë e Policisë në Turqi, i cili nisi më 14.11.2021. Në kuadër të këtij projekti u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Urdhër nr.1016 datë 05.11.2021 nr.6383/4 prot “Për ndjekjen e studimeve në Akademinë e Policisë në Turqi”. Në këtë urdhër thuhet se *Akademia e Sigurisë të kryejë trajtimin me pagesë të kursantëve për periudhën që ndjekin studimet.* Gjithashtu është nënshkruar dhe VKM nr.602, datë 24.05.2022 nr.3949 prot., “Për shfuqizimin e Urdhrit nr.1016/1 datë 10.11.2021” ku thuhet se trajtimi me pagesë i kursantëve fillon **nga data 14 nëntor 2021 deri në përfundimin e studimeve.** Ndërkohë, kjo bie në kundërshtim me VKM nr.200 datë 15.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Policisë së Shtetit” i ndryshuar, ku

thuhet konkretisht “Kursantët që pranohen në kolegjin profesional “Kolegji i Policisë”, në Akademinë e Sigurisë, gjatë periudhës së shkollimit përfitojnë trajtim me pagesë në masën 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj”, që do të thotë se nuk parashikohen të jenë të përfshira pagesat mbi studentët të cilët do të kryejnë trajnime jashtë vendit. Përgjatë 8 muajve të praktikës, 5 studentët janë paguar 8,000 lekë/muaj secili, me vlerën e kursantëve që pranohen në “Kolegjin e Policisë”, duke e çuar shumën në 320,000 lekë gjithsej. Shkaku i këtij konstatimi është keqinterpretim i bazës ligjore dhe efekti që ka është pagesa nga ana e AS e kursantëve, të cilët nuk janë parashikuar në VKM nr.200 datë 15.03.2017.

Kjo problematikë është hasur dhe në vitin pasardhës. Më 05.01.2023, nr.752/1 prot., Akademia e Sigurisë dërgon shkresën drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit lidhur me moskompetencë të Urdhrit me nr.611, datë 21.03.2023 “Për trajtimin me pagesë të studentëve që ndjekin studimet në Akademinë e Policisë Turqi”. AS mendon dhe gjykon se nuk i përket këtij institucioni zbatimi duke u bazuar në VKM nr.200, datë 15.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Policisë së Shtetit”. Trajtimin me pagesë në masën 8,000 lekë/muaj e përfitojnë vetëm kursantët që shkollohen në Akademinë e Policisë dhe jo ata që shkollohen jashtë vendit. Më 21.03.2023 Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nxjerr Urdhër nr.611 “Për trajtimin me pagesë të studentëve që ndjekin studimet në Akademinë e Policisë në Turqi” ku urdhërohet që 5 studentët të trajtohen me pagesë në masën 8,000 lekë në muaj për periudhën e papaguar gjatë viteve akademike 2021-2023 nga Akademia e Sigurisë.

5. Pedagogë të jashtëm

Pedagogët e Jashtëm janë pjesë e stafit akademik të Akademisë së Sigurisë. Marrëdhëniet e tyre të punës lidhen me anë të kontratës dhe pagesa kryhet në bazë të orëve që realizojnë dhe gradës që ata kanë. Akademia e Sigurisë bazohet në VKM nr.647 datë 05.10.2022 “Për disa ndryshime në VKM nr. 748 datë 11.06.2009”. Sipas listë-pagesave të AS, pagesat për pedagogët e jashtëm përgjatë viteve objekt auditimi janë të detajuar në *Aneksin 2/2* të Raportit të Auditimit.

Nga auditimi i pagesave të kryera për pedagogët e jashtëm, grupi i auditimit konstaton se Prof.Dr. B... C...është paguar për **178 orë mësimore** (pra 58 orë më tepër se sa lejohet në Udhëzimin nr.29, datë 10.09.2018) dhe Msc.Megi Cake është paguar për **125 orë mësimore** (5 orë më tepër se sa lejohet në Udhëzimin nr.29, datë 10.09.2018). Kjo bie në kundërshtim me Udhëzimin nr.29 datë 10.09.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë” ku sipas pikës 2: *Personeli akademik me kohë të pjesshme mund të mbulojë ngarkesën vjetore në auditor:*

a)Kategoria Profesor 120 orë në auditor.

b)Kategoria Lektor 120 orë në auditor.

c)Asistent-Lektor 120 orë në auditor.

Personeli akademik me kohë të pjesshme nuk mund të ketë orë suplementare. Ky personel paguhet deri në ngarkesën maksimale të përcaktuar në auditor.

Shkak i këtij konstatimi është neglizhenca institucionale dhe ka efekt negative në administrimin e fondeve publike.

Sa më sipër, nga auditimi i listë-pagesave u konstatua se **pagesat ndaj pedagogëve të jashtëm janë trajtuar si honorare dhe jo si paga**, për faktin se midis përfituesit dhe AS është lidhur kontratë pune. Shuma bruto e tyre është tatuar me 15%. Sipas Ligjit 8438 “Për Tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nenit 8, pika 1, gërma a: *Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: a) pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës;*

Neni 13, pika 4: *Përrjashtohen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2 000 000 (dy milionë) lekë. Ky përjashtim nuk zbatohet për individët, të cilët janë të punësuar në më shumë se një punëdhënës. Këta individë deklarojnë në deklaratën e tyre vjetore të të ardhurave, në një shumë të vetme, të gjitha të ardhurat e siguruara nga punësimi, llogarisin shumën totale të detyrimit tatimor mbi pagat, zbrasin, kur është rasti, tatimin e mbajtur nga punëdhënësi dhe përcaktojnë shumën e detyrimit tatimor që duhet të paguajnë për buxhetin e shtetit.*

Mbështetur në ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, *punëdhënësi informon punëmarrësin e punësuar me kohë pune të pjesshme për vendet e lira të punës dhe i siguron mundësi të barabarta me punëmarrësit dhe/ose punëkërkuessit e tjerë, për t’u punësuar në një punë me kohë të plotë. Gjithashtu, punëdhënësi informon punëmarrësin e punësuar me kohë pune të plotë për vendet e lira të punës dhe i siguron mundësi të barabarta me punëmarrësit dhe/ose punëkërkuessit e tjerë, për t’u punësuar në një punë me kohë të pjesshme.*

Me kontratën e punës me kohë të pjesshme, punëmarrësi pranon të punojë me orë, gjysmë dite pune ose ditë pune, për një kohëzgjatje normale javore ose mujore më të vogël se ajo e punëmarrësve që punojnë me kohë të plotë në të njëjtat kushte. Punëmarrësit me kohë të pjesshme gëzojnë të njëjtat të drejta si punëmarrësit me kohë të plotë të cilët kryejnë të njëjtën punë.

Sipas VKM nr. 568, datë 6.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” II, pika 4 thuhet: *Brenda orarit ditor të punës, të punësuarit mund të kryejnë veprimtari mësimdhënies pas miratimit nga titullari i institucionit, por jo më shumë se 4 (katër) orë në javë, të cilat kompensohen në orë pune, brenda javës, pas orarit ditor të punës. I punësuari që angazhohet në mësimdhënie detyrohet të depozitojë, pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit ku është i punësuar, kopjen e kontratës së lidhur me institucionin arsimor.*

Sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 79 citon: *Punëdhënësi dhe i vetëpunësuar janë të detyruar: a) të regjistrojnë në regjistrin vjetor të gjithë të punësuarit; b) të njoftojnë në organet tatimore për ndryshimet dhe lëvizjen e punonjësve, sipas procedurave të përcaktuara me Ligj; c) të bëjnë sigurimin nga dita e parë, kur i punësuari fillon punë; ç) të dorëzojnë në organet tatimore dokumentacionin, ku evidentohen paga dhe kontributi për çdo të punësuar, sipas formatit dhe afateve të përcaktuara me Ligj.*

Në konform të nenit të mësipërm nga ana e drejtorisë ekonomike bëhet deklarimi i punonjësve me kontratë pune të pjesshme të paktën **24 orë përpara** fillimit të punës sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku sipas nenit 119 të këtij ligji thuhet: *Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar: a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 200 000 (dyqind mijë) lekësh; b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.*

Prandaj, bazuar në shkresat që sillen nga përgjegjësit e departamenteve përkatëse për regjistrim apo çregjistrim të punonjësve me kontratë pune me kohë të pjesshme apo sipas ngarkesave mujore

të deklaruara në fillim të çdo viti akademik, drejtoria ekonomike çdo muaj bën regjistrimet apo çregjistrimet e punonjësve me kontratë pune me kohë të pjesshme.

Sipas ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” Neni 13, pika 1. *Kontributet do të paguhen nga personat e siguruar; 2. Kontributet e personave të punësuar nën një kontratë pune do të ndahen ndërmjet personit të siguruar dhe punëdhënësit të tij, në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe do të derdhen nga punëdhënësi; 3. Personat e detyruar për derdhjen e kontributeve janë përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tyre. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga e të punësuarve kontributet dhe t’i derdhë ato në llogari të administratës tatimore, sipas kriteve dhe procedurave të përcaktuara me ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.*

Sipas vendimit Nr. 77, datë 28.1.2015 “Për Kontributet e Detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i Sigurimeve Shoqërore dhe Sigurimi i Kujdesit Shëndetësor”, i ndryshuar, ku citon :

*Personat që zhvillojnë aktivitet ekonomik dhe kanë plotësuar moshën e punës, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës, janë si më poshtë vijon: b) **Të punësuarit me kontratë pune me ose pa afat, që punojnë me kohë të pjesshme, që zgjat më pak se 87 (tetëdhjetë e shtatë) orë në muaj, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, por jo më pak se niveli minimal, për degën e barrë lindjes, pensioneve, aksidenteve në punë e sëmundjeve profesionale dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor; c) Të punësuarit me kontratë pune, me kohë të plotë ose të pjesshme ditore, që zgjat më pak se 7 (shtatë) ditë kalendarike radhazi në vit, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për degën e aksidenteve në punë e sëmundjeve profesionale dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor; Për llogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore, të sigurimit të kujdesit shëndetësor, si dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi, zbatohet njëlloj, ashtu si për të ardhurat nga puna.***

Paga bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e të kujdesit shëndetësor, është paga e caktuar sipas legjislacionit në fuqi, ose në kontratën e punës, sipas rastit, me karakter të përhershëm, që lindin nga marrëdhëniet e punës.

Paga bruto mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore duhet të jetë jo më pak se sa paga minimale mujore në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, dhe jo më shumë se paga maksimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Paga mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor, nga data 01.01.2015 e në vazhdim, duhet të jetë jo më pak se sa paga minimale në shkallë vendi dhe deri në shumën e pagës bruto, sipas deklaratës së listëpagesës, për personat e punësuar.

Kontributi i detyrueshëm për të punësuarit me kontratë pune, që zgjat më pak se 87 orë në muaj është:

a) për sigurimet shoqërore, 23.3% të pagës bruto, sipas listëpagesës, **ku pjesa e punëdhënësit të jetë 13.92% dhe pjesa e të punësuarit 9.38%, por jo më pak se paga minimale dhe jo më shumë se paga maksimale**, e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore.

b) për sigurimin e kujdesit shëndetësor, 3.4% të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 1.7% dhe pjesa e të punësuarit 1.7%, **por jo më pak se paga minimale e përcaktuar në këtë vendim**, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor.

Të gjithë pedagogët e punësuar me kohë të pjesshme pranë Akademisë së Sigurisë regjistrohen pranë organeve tatimore dhe për to derdhet kontribut sipas bazës ligjore të mësipërme gjatë muajit apo muajve që ato kryejnë punën e tyre.

Sipas Udhëzimit Nr. 23 datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” pika 9.2 “Për personin e punësuar në dy tatimpagues thuhet:

Për personin e punësuar në dy tatimpagues (persona juridikë ose fizikë) deklarimi i të dhënave sipas përmbajtjes së deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” bëhet, nga të dy tatimpaguesit, si më poshtë:

a. *Kur shuma e pagave bruto mujore, që punonjësi merr nga të dy tatimpaguesit është më e vogël se kufiri i pagës maksimale për kontributet shoqërore, atëherë për këtë punëmarrës, secili prej subjekteve në mënyrë të pavarur, llogarit dhe deklaron kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore njësoj sikur personi të mos ish i punësuar në punëdhënës tjetër. **Pra kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore deklarohen mbi bazën e pagës reale por jo më pak se niveli i pagës minimale në shkallë vendi.***

b. *Kur shuma e pagave bruto mujore, që punonjësi merr nga të dy tatimpaguesit është sa, ose më e madhe, nga kufiri i pagës maksimale për kontributet shoqërore, atëherë për këtë punëmarrës, tatimpaguesi nga i cili ai merr pagën më të lartë llogarit dhe deklaron kontributet shoqërore mbi bazën e pagës reale deri në kufirin e pagës maksimale për kontributet shoqërore. Tatimpaguesi tjetër, nga i cili punëmarrësi merr pagën më të ulët deklaron dhe paguan kontributet shoqërore mbi bazën e pagës mujore, që rezulton si diferencë midis pagës maksimale për kontributet shoqërore me pagën, që punonjësi merr nga tatimpaguesi prej të cilit ai merr pagën më të lartë.... Kontributet e sigurimit shëndetësor llogariten dhe deklarohen nga të dy tatimpaguesit mbi bazën e pagës bruto mujore të punonjësit por jo më pak nga paga minimale në shkallë vendi dhe pa kufi të sipërm të saj.*

c. *Kur paga bruto mujore e punonjësit të njëri nga tatimpaguesit është sa, ose më e madhe, se kufiri i pagës maksimale për kontributet shoqërore, atëherë nga ky tatimpagues ato llogariten dhe deklarohen në nivelin e pagës maksimale për kontributet shoqërore. Tatimpaguesi tjetër nga i cili punonjësi merr pagën më të ulët, nuk llogarit dhe nuk deklaron kontribute shoqërore, por te emri i personit, në rubrikat e vlerave të kontributit shoqëror të të dhënave të listëpagesës vendos zero, si dhe në rubrikën “Shënime” ky subjekt shënon “Deklaruar kontribute shoqërore me pagë maksimale të tatimpaguesi “x” me NIPT...”, si dhe ruan vërtetimin e lëshuar nga tatimpaguesi që deklaron dhe paguan kontributet shoqërore në nivelin e pagës maksimale. Kontributet e sigurimit shëndetësor llogariten dhe deklarohen nga të dy tatimpaguesit mbi bazën e pagës bruto mujore të punonjësit por jo më pak nga paga minimale në shkallë vendi dhe pa kufi të sipërm të saj.*

Prandaj nga Akademia e Sigurisë duhet të deklarojnë punonjësit me kontratë me kohë të pjesshme si me kontratë pune me ose pa afat, që punojnë me kohë të pjesshme, që zgjat më pak se 87 (tetëdhjetë e shtatë) orë në muaj, në mënyrë që sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të paguhen jo më pak se **niveli i pagës minimale në shkallë vendi** siç parashikon ligji.

Gjithashtu pagesat e marrë nga kontratat e punës së lidhur mes AS dhe pedagogëve të jashtëm duhet të deklarohen dhe të paguhet tatim mbi të ardhurat personale sipas përcaktimeve të:

Udhëzimit të përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” pika 10 “Të ardhurat personale të tatueshme” ; 10.1 “Të ardhura personale të tatueshme sipas ligjit, konsiderohen të ardhurat nga punësimi sipas nenit 12, të ardhurat nga biznesi sipas nenit 13 dhe të ardhurat nga investimet (të ardhurat nga kapitali) të listuara në nenin 15 të ligjit”, si dhe pika 12 “Të ardhurat nga punësimi” ku në pikën 12.1 përcaktohet “Çdo përfitim i individit që ka lidhje me marrëdhëniet e punësimit, konsiderohet e ardhur nga punësimi dhe tatohet si e tillë, pavarësisht nëse është apo emërtohet pagë, rrogë, shpërblim, bonus, shtesë, kompensim etj. Parimi kryesor që një e ardhur të konsiderohet si e ardhur nga punësimi është që individi tatimpagues duhet të ndjekë udhëzimet

e paguesit të të ardhurave, pra punëdhënësit, apo personit (edhe ky në rolin e punëdhënësit) që i ka caktuar një detyrë/funksion, në mënyrë që të marrë pagën/rrogën/shpërblimin/bonusin/kompensimin apo shtesën, apo elemente të tjera të ngjashme me këto.....". Shkak i trajtimit të pedagogëve të jashtëm si pagesa honorare është mospagesa e sigurimeve nga ana e AS dhe efekti që ka është shmangie e detyrimeve tatimore dhe të ardhura të munguara. Rëndësia e lartë.

Auditimi i pagave të punonjësve për periudhën objekt auditimi:

Me përzgjedhjen rastësore të Listë-pagesave për vitet 2022 dhe 2023, u konstatua se llogaritjet për pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, siguracioni suplementar, si dhe tatimi mbi të ardhurat personale janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e tyre (me përjashtim të pedagogëve të jashtëm). U verifikuan fizikisht Listëpagesat e AS për vitin 2022 muajt Janar, Mars, Korrik, Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor. Gjithashtu dhe për vitin 2023 Listëpagesat për muajt Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Nëntor e Dhjetor. Listëpagesat janë plotësuar nga specialisti i financës, i caktuar për hartimin e pagave. Ato janë nënshkruar nga Shefi i Financës, Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues (Drejtor/Rektor deri në përcaktimin e Administratorit) dhe janë nënshkruar nga punonjësi i caktuar për menaxhimin e burimeve njerëzore, duke respektuar kërkesat e përcaktuara të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 69.

2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Në zbatim të pikës nr. 3 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër-shpenzim;
- Transaksionet e llogarive bankare;
- Pagesa për shërbime/mallra punë në zbatim të kontratave marrëveshje kuadër.

Nga auditimi me zgjedhje i transaksioneve të kryera përgjatë vitit 2022 dhe vitit 2023, bazuar në ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit” dhe ISSAI 1530 “Shënime praktike mbi ISA 530”. “ISA 530 zbatohet kur audituesi ka vendosur të përdorë kampionimin e auditimit në kryerjen e procedurave të auditimit. Ai merret me përdorimin nga audituesi të kampionimit statistikor dhe jostatistikor gjatë hartimit dhe përzgjedhjes së kampionit të auditimit, kryerjen e testeve të kontrolleve dhe testet e detajeve, dhe vlerësimin e rezultateve nga ky kampion, cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen”, mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit të realizuara në AS, veprimet e kryera me bankën konstatohet se, janë kryer konformë Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184 “Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”, si dhe Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe

procesimit të pagesës në degën e thesarit.”

a) Ligjshmëria dhe saktësia e kryerjes së veprimeve nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë:

Nga institucioni na është komunikuar se nuk ka asnjë veprim të realizuar nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë, të gjithë veprimet financiare janë realizuar nëpërmjet bankës.

b) Auditimi i transaksioneve të kryera me bankën:

U auditua me zgjedhje dokumentacioni mbështetës i veprimeve dhe transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës për periudhën objekt auditimit.

Konstatim:

1. Nga auditimi i urdhër-shpenzimeve për vitin 2022 dhe vitin 2023, nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua mangësi në lidhje me dokumentacionin justifikues, bashkëlidhur urdhër shpenzimeve si mëposhtë:

Në urdhër shpenzimet të cilat kishin të bënin me pagesat në lidhje me:

Pagat e punonjësve: Honoraret; Shpenzime-dieta për punonjësit; Pagat e ekscedenteve; Pagat e kursantëve; Pedagoget e jashtëm, etj. u konstatua se bashkëlidhur nuk kishte asnjë dokumentacion justifikues si listëpagesa dhe urdhrat e Titullarit të Akademisë së Sigurisë.

Për pagesat e kryera në lidhje me tatim e mbajtur ne burim mungon dokumentacioni justifikues/gjurma e auditimit se për kë është përlogaritur ky tatim. Urdhër shpenzimi ka të bashkëlidhur vetëm formularin e deklaramit.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me:

Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë

15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” **nenin 4, pika 26**, “Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumenti elektronik rregullohet me ligjin që rregullon dokumentin elektronik”; neni 12, pika 3, germa a); neni 12, pika 3, germa dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi; **Nenin 4, pika 19** “Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve”, si dhe të Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”.

- Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për vitin 2022 u konstatua se nga AS janë realizuar pagesa në lidhje me projektin “Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përbalimin e emergjencave civile” në shumën prej 709,796 lekë, financuar nga AKKSHI, pas aplikimit me shkresën nr. 410 datë 19.03.2021, si dhe Kontratës së lidhur me nr. 800 prot., datë 22.09.2021 mes AS dhe AKKSHI në vlerën prej 2,000,000 lekë.

Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se në Llogarinë 475 "Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhëse" është mbajtur vlera prej 1,290,233 lekë, e cila përfaqëson vlerën e pa shpenzuar të projektit “Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore

dhe nevojave për përbalimin e emergjencave civile”, financuar nga AKKSHI .

Nga AS me Shkresë nr. 900 prot, datë 29.04.2022 është dërguar pranë AKKSHI raporti 6 mujor për realizimin dhe financimin e projektit.

Raporti përfundimtar i projektit tek AKKSHI “Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përbalimin e emergjencave civile” është dërguar me shkresë nr, 623/2 datë 25.05.2023, pas rekomandimeve të lëna nga auditi i brendshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dërguar me shkresë nr.08/4, datë 18.05.2023.

AKKSHI pas monitorimit dhe vlerësimit të projektit, me shkresë nr. 1031 prot, datë 08.09.2023 ka dërguar në AS gjetje, konkluzion dhe rekomandimet.

Në seksionin C. **Rekomandime për plotësimin e dokumentacionit dhe buxhetin e pashpenzuar, pika 4 është kërkuar:** *Te realizohen, aty ku është e mundur, shpenzimet buxhetore të parashikuara në projekt, në të kundërt të gjithë buxheti i akorduar për realizimin e projektit i cili rezulton i pashpenzuar, të kthehet në buxhetin e shtetit brenda datës 30.09.2023.*

Deri në përfundim të auditimit në terren u konstatua se nga AS nuk është marrë asnjë masë për analizimin e shpenzimeve të papaguara, si dhe për zbatimin e rekomandimit dërguar nga AKKSHI germën **C pika 4**, ku sipas drejtuesit të projektit vlera e papaguar është në shumën prej 772,554 lekë, tabela si me poshtë:

Rolet e anëtarëve të projektit		Ditë pa paguar	Pagesa ditore	Shuma e mbetur pa paguar
1	Drejtes projektit	37	5,532	204,677
2	Koordinatorë	40	3,436	137,458
3	Kërkues shkencore I parë	11	7,350	80,850
4	Kërkues shkencore	11	6,049	66,543
5	Kërkues shkencore	17	5,214	88,634
6	Kërkues shkencore	17	3,587	60,972
7	Përgjegjës për vizibilit.	37	2,100	77,688
8	Konsulent finance.	13.4	4,159	55,732
			772,554	

2. *Auditimi i dokumentacionit të dietave mbi të cilat është bërë rimbursimi i shpenzimeve dieta brenda vendit për punonjësit.*

Nga auditimi i rimbursimit të shpenzimeve dieta për vitin 2022 dhe 2023 u konstatua se:

2.1. Tek urdhër shërbimi dieta janë përllogaritur edhe shpenzimet bazuar në biletat e udhëtimit, vlerë e cila nuk është përllogaritur bazuar në VKM-në me nr. 146, datë 26.2.1998, “Për tarifën e transportit të udhëtarëve”, i ndryshuar, por është marrë vlera e përcaktuar në biletat e dorëzuara nga personi udhëtues, ku KM e përcaktuar në biletë nuk përputhen me itinerarin e autorizuar.

- Me Urdhër shërbimin e z. H. L. bazuar në planin e inspektimit me nr. 1718, datë 22.08.2022 për inspektimin në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës Dibër, u konstatua se 2 biletat e dorëzuara përcaktojnë itinerarin Tiranë- Peshkopi, ku në biletë është shënuar 1-232 KM dhe Çmime 710 lekë; itinerarin Kukës- Tiranë, ku në biletë është shënuar 1-192 KM dhe Çmimi 600 lekë dhe itinerarin Peshkopi-Kukës, ku në biletë është shënuar 1-162 KM dhe Çmimi 510 lekë;

Punonjësi është rimbursuar për shumën 1820 lekë. Rimbursimi sipas VKM-së me nr. 146, datë 26.2.1998 “Për tarifën e transportit të udhëtarëve”, i ndryshuar: nga një vlerësim të përafërt, parashikon tarifa të ndryshme mbi ato të paguara.

Për itinerarin Tiranë - Peshkopi duhet të ishte paguar në vlerën 600 lekë, Kukës - Tiranë 500 lekë dhe Peshkopi - Kukës 400 lekë, atëherë shuma e rimbursuar do të ishte: 600 + 500 + 400 = 1500 lekë.

Diferenca ndërmjet shumës aktuale të paguar dhe shumës së përcaktuar sipas VKM-së është: $1820 - 1500 = 320$ lekë, paguar më tepër nga Institucioni.

- Me Urdhër shërbimin e z. J. D. bazuar në planin e inspektimit me nr. 1718, datë 22.08.2022 për inspektimin në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës Dibër, u konstatua se 2 biletat e dorëzuara nuk kanë të përcaktuar itinerarin dhe njëra ka të përcaktuar itinerarin Peshkopi Kukës, ku në biletë është shënuar 1-162 KM dhe Çmimi 510 lekë; Punonjësi është paguar për shumën 1820 lekë.

Për Itinerari Peshkopi – Kukës duhet të ishte të ishte paguar në vlerën 400 lekë.

Diferenca ndërmjet shumës aktuale të paguar dhe shumës së përcaktuar sipas VKM-së është: $1820 - 400 = 1420$ lekë, paguar më tepër nga Institucioni.

- Me Urdhër shërbimin e z. A. J. bazuar në planin e inspektimit me nr. 1208/3, datë 30.06.2022 për inspektimin në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlore Gjirokastër në terren u konstatua se 4 biletat e dorëzuara nga të cilat është përcaktuar itinerari Vlore- Sarandë dhe anasjelltas ku në biletë është shënuar 1-232 KM dhe Çmimi 710 lekë;

Punonjësi është rimbursuar për shumën 1420 lekë, vlera e rimbursuar për km e përshkruara është në kundërshtim me VKM-në me nr. 146, datë 26.2.1998 “Për tarifën e transportit të udhëtarëve”, i ndryshuar ku largësia në KM mes dy qyteteve është poshtë 62 km. Shuma që duhet të rimbursohet është në vlerën $190 \text{ lekë} * 2 = 380$ lekë. Sa më sipër është rimbursuar më tepër për shumën prej 1040 lekë.

- Me Urdhër shërbimin e z. A. J. bazuar planin në inspektimit me nr. 2076/1, datë 30.09.2022 për inspektimin në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlore Gjirokastër në terren datë 03.10.2022-04.10.2022 u konstatua se 4 biletat e dorëzuara nga të cilat është përcaktuar itinerari Vlore-Gjirokastër është shënuar 1-162 KM dhe Çmimi 510 lekë dhe Gjirokastër Sarandë ku në biletë është shënuar 1-162 KM dhe Çmimi 510 lekë;

Punonjësi është rimbursuar për shumën 1020 lekë. Vlera e rimbursuar për km e përshkruara është në kundërshtim me VKM-në me nr. 146, datë 26.2.1998 “Për tarifën e transportit të udhëtarëve”, i ndryshuar ku largësia në KM mes dy qyteteve është poshtë 75 km.

- Me Urdhër shërbimin e z. A. I. bazuar planin në inspektimit me nr. 786/2, datë 14.04.2022 për inspektimin në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë me datë 09-13.05.2022 në terren u konstatua se 2 biletat e dorëzuara nga të cilat është përcaktuar itinerari Tiranë Korçë dhe anasjelltas, në biletë është shënuar 1-232 KM dhe Çmimi 710 lekë;

Punonjësi është rimbursuar për shumën 1420 lekë.

Vlera e rimbursuar për km e përshkruara është në kundërshtim me VKM-në me nr. 146, datë 26.2.1998 “Për tarifën e transportit të udhëtarëve”, i ndryshuar ku largësia në KM mes dy qyteteve është poshtë 162 km. Shuma që duhet të rimbursohet është në vlerën $510 \text{ lekë} * 2 = 1020$ lekë. Sa më sipër është rimbursuar më tepër për shumën prej 400 lekë.

- Me Urdhër shërbimin e z. E. Ç. bazuar në planin e inspektimit me nr. 1208/3, datë 30.06.2022 për inspektimin në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë në terren u konstatua se 2 biletat e dorëzuara me itinerar Tiranë Vlorë dhe anasjelltas janë bileta taksi veture në shumën 1600 lekë mbi të cilën është rimbursuar vlera e transportit.

- Me Urdhër shërbimin e z. A. J. i bazuar në planin e inspektimit me nr. 1208/3, datë 30.06.2022 për inspektimin në Drejtorinë Vendore të policisë Vlorë në terren u konstatua se 2 biletat e dorëzuara me itinerar Tiranë Vlorë dhe anasjelltas janë bileta taksi veture në shumën 1600 lekë mbi të cilën është rimbursuar vlera e transportit.

Sa më sipër rimbursimi është bërë në kundërshtim me VKM-në nr. 146, datë 26.2.1998 dhe VKM me nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” pika 4, e cila përcakton “tarifat dhe rregullat për rimbursimin e

shpenzimeve të transportit për udhëtarët, ku përcakton që rimbursimi të bëhet bazuar në tarifat e përcaktuara për transportin publik, dhe jo për taksi veture”. Urdhrit i Ministrit të MIE nr. 48, datë 7.4.2023 “Për miratimin e distancave kilometrike ndërmjet qyteteve të Republikës së Shqipërisë dhe hartës së përditësuar të rrjetit rrugor kombëtar”.

- Me Urdhër shërbimin e z. M. U. bazuar në planin e inspektimit me nr. 1208/3, datë 30.06.2022 për inspektimin në Drejtorinë Vendore të policisë Kukës- Dibër në terren u konstatua se 6 biletat e dorëzuara mbi të cilën është rimbursuar vlera e transportit në shumën 2860 lekë nuk kanë të përcaktuar itinerarin dhe datën e lëvizjes, janë dorëzuar të paplotësuar nga personi udhëtues.

- Me Urdhër shërbimin e z. E. M. bazuar në planin e inspektimit me nr. 1208/3, datë 30.06.2022 për inspektimin në Drejtorinë Vendore të policisë Kukës- Dibër në terren u konstatua se 6 biletat e dorëzuara mbi të cilën është rimbursuar vlera e transportit në shumën 2860 lekë nuk kanë të përcaktuar itinerarin dhe datën e lëvizjes, janë dorëzuar të paplotësuar nga personi udhëtues.

- Me Urdhër shërbimin e z. A. Ll. bazuar në planin e inspektimit me nr. 1208/3, datë 30.06.2022 për inspektimin në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës- Dibër në terren u konstatua se 6 biletat e dorëzuara mbi të cilën është rimbursuar vlera e transportit në shumën 2860 lekë nuk kanë të përcaktuar itinerarin dhe datën e lëvizjes, janë dorëzuar të paplotësuar nga personi udhëtues.

- Me Urdhër shërbimin e z. H. L. bazuar planin në inspektimit me nr. 1208/3, datë 30.06.2022 për inspektimin në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër në terren u konstatua se 2 biletat e dorëzuara mbi të cilën është rimbursuar vlera e transportit në shumën 1400 lekë nuk kanë të përcaktuar itinerarin dhe datën e lëvizjes, janë dorëzuar të paplotësuar nga personi udhëtues.

- Me Urdhër shërbimin e z. J. H. bazuar në planin e inspektimit me nr. 1208/3, datë 30.06.2022 për inspektimin në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër në terren u konstatua se 2 bileta e dorëzuara mbi të cilën është rimbursuar vlera e transportit në shumën 1400 lekë nuk kanë të përcaktuar itinerarin dhe datën e lëvizjes, janë dorëzuar të paplotësuar nga personi udhëtues.

- Me Urdhër shërbimin e z. L. N. bazuar në planin e inspektimit me nr. 1208/3, datë 30.06.2022 për inspektimin në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës-Dibër në terren u konstatua se 6 biletat e dorëzuara mbi të cilën është rimbursuar vlera e transportit në shumën 2860 lekë nuk kanë të përcaktuar itinerarin dhe datën e lëvizjes, janë dorëzuar të paplotësuar nga personi udhëtues.

- Me Urdhër shërbimin e znj. R. G. bazuar në planin e inspektimit me nr. 1208/3, datë 30.06.2022 për inspektimin në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër në terren u konstatua se 2 biletat e dorëzuara mbi të cilën është rimbursuar vlera e transportit në shumën 1400 lekë nuk kanë të përcaktuar itinerarin dhe datën e lëvizjes, janë dorëzuar të paplotësuar nga personi udhëtues.

- Me Urdhër shërbimin e z. A. I. bazuar planin në inspektimit me nr. 786/4, datë 06.05.2022 për inspektimin në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë me datë 09-13.05.2022 në terren u konstatua se 4 biletat e dorëzuara mbi të cilën është rimbursuar vlera e transportit në shumën 1840 lekë nuk kanë të përcaktuar itinerarin dhe datën e lëvizjes, janë dorëzuar të palotësuar nga personi udhëtues. Për të gjitha vlerat e rimbursuara sa më lartë, ku dokumenti është i paplotësuar me itinerare dhe datën e udhëtimit, vlera e përlogaritur e transportit është kryer mbi bazën e çmimit të vënë në biletën e transportit.

Sa më sipër i gjithë vlera e rimbursuar është në kundërshtim me

- VKM-në me nr. 146, datë 26.2.1998 si dhe nuk është mbështetur në dokumente vërtetues të rregullt.

- Urdhrit të Ministrit të MIE nr. 48, datë 7.4.2023 “Për miratimin e distancave kilometrike ndërmjet qyteteve të Republikës së Shqipërisë dhe hartës së përditësuar të rrjetit rrugor kombëtar”.

- Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” **nenin 4, pika 26**, “Dokument financiar”

është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumenti elektronik rregullohet me ligjin që rregullon dokumentin elektronik”; neni 12, pika 3, germa a); neni 12, pika 3, germa dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi; **Nenin 4, pika 19** “Gjurma e auditimit” si dhe të Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”. Si dhe pika 36 “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve”

- Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde mbi zbatimin e buxhetit" pika 165 “Për të gjitha shpenzimet e kryera nëpunësi zbatues kryen kontrollin para pagesës, lidhur me mjaftueshmërinë e disponibiliteteve mujore të parashikuara në planin e arkës, kontrollon dokumentet origjinale të mjaftueshme që vërtetojnë kryerjen e shpenzimit dhe kontrollin e tjera të nevojshme dokumentare”.

2.2 Nga auditimi i urdhër shërbimeve për vitin 2022- 2023 u konstatua se përlllogaritja e dietave nuk është sipas përcaktimeve të VKM-së me nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” pike 2 ku citon se: “Për shërbime në një largësi mbi 50 km jashtë qendrës së punës, kur punonjësi kthehet brenda ditës, trajtimi financiar i tij përfshin dietën ditore, në masën 500 (pesëqind) lekë në ditë, si dhe shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni. Përgjyhet nga ky rregull punonjësit që dërgohen për shërbime në një largësi mbi 50 km, jashtë qendrës së punës, dhe që zgjatën mbi tri ditë pune, në bazë të programit të miratuar nga titullari apo zyrtari përgjegjës që autorizon shërbimin, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi”.

Parregullsitë e evidentuara lidhen kryesisht me:

- Përlllogaritje të gabuar të dietave ditore.

- Mosrespektim të kufirit prej 500 lekë për dietë ditore për udhëtimet brenda ditës mbi 50 km.

Parregullsi në respektimin e dispozitave ligjore për shpenzimet për udhëtime e dieta, të cilat kanë rezultuar me efekt negativ në buxhetin e shtetit në shumën prej 17,700 lekë. Më konkretisht: për praktikatat e pasqyruara në tabelë si mëposhtë.:

Viti 2022			Data e lëvizjes		Vlera në lekë	Rimbursim i i Tepërt
Urdhër Rektori/Autorizim/Plan veprimi	Itenerari	Personi Udhëtuese	Nisje	Kthim		
202 datë 08.07.2022	Tirane Elbasan	A..... U....	08.07.2022	08.07.2022	1,000	1,000
Autorizimi 247 datë 25.10.2022	Tirane Fier	A..... U....	05.10.2022	05.10.2022	1,000	500
ska autorizim	Tirane Fier	A..... U....	04.03.2022	04.03.2022	1,000	500
68 datë 03.03.2022	Tirane- Durrës	A..... U....	04.03.2022	04.03.2022	1,000	1,000
93 datë 29.03.2022	Tirane- Durrës	A..... U....	29.03.2022	29.03.2022	1,000	1,000

110 datë 13.04.2022	Tirane- Durrës	A..... U....	13.04.2022	13.04.2022	1,000	1,000
112 datë 14.04.2022	Tirane- Durrës	A..... U....	14.04.2022	14.04.2022	1,000	1,000
122 datë 19.04.2022	Tiranë Shkodër	A..... U....	19.04.2022	19.04.2022	1,000	500
129 datë 03.05.2022	Tirane- Durrës	A..... U....	04.05.2022	04.05.2022	1,000	1,000
130 datë 04.05.2022	Tirane- Durrës	A..... U....	05.05.2022	05.05.2022	1,000	1,000
146 datë 13.05.2022	Tirane- Durrës	A..... U....	13.05.2022	13.05.2022	1,000	1,000
136 datë 08.04.2022	Tirane Rrëshen	E.... F...	04.05.2022	04.05.2022	1,000	500
137 datë 08.04.2022	Tirane Elbasan	E.... F...	04.05.2022	05.05.2022	2,000	1,000
136 datë 08.04.2022	Tirane Shkodër	H... B....	11.04.2022	11.04.2022	1,000	500
136 datë 08.04.2022	Tirane Shkodër	H... B....	12.04.2022	12.04.2022	1,000	500
136 datë 08.04.2022	Tiranë Shkodër	G... Sh...	11.04.2022	11.04.2022	1,000	500
136 datë 08.04.2022	Tiranë Shkodër	G... Sh...	12.04.2022	12.04.2022	1,000	500
136 datë 08.04.2022	Tiranë Shkodër	H... B...	11.04.2022	11.04.2022	1,000	500
136 datë 08.04.2022	Tiranë Shkodër	H... B...	12.04.2022	12.04.2022	1,000	500
ska dokumentacion për këto data	Tirane Elbasan	E.... F....	04.04.2022	04.04.2022	1,000	1,000
Viti 2023						
pa numër protokollit pa datë	Tirane Durrës	A....T...	16.05.2022	16.05.2022	1,000	1,000
518 datë 07.09.2023	Tirane Durrës	A... K...	29.07.2023	30.09.2023	1,000	100
518 datë 07.09.2023	Tirane Durrës	S..... P...	29.07.2023	30.09.2023	1,000	100
518 datë 07.09.2023	Tirane Shkodër	S... K....	16.05.2022	16.05.2022	1,000	500
G23 datë 23.05.2023	Tirane Durrës	G... J....	23.05.2023	23.05.2023	1,000	1,000
					Totali	17,700

3. Lidhur me administrimin e shpenzimeve të karburantit, u konstatua se janë ngritur komisionet e përcaktimit të normativave të automjeteve në përdorim nga Akademia e Sigurisë, përcaktuar nga drejtorja e mbështetjes logjistike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të policisë. Shpërndarja e karburantit bëhet në bazë të buxhetit të miratuar dhe kërkesave për karburant që bëhen në bazë të autorizimeve për lëvizjen e mjetit. Për çdo muaj janë mbajtur fletë-udhëtime në të cilat janë plotësuar me lëvizjet me destinacionet përkatëse kur udhëtimet kanë qenë jashtë Tirane, duke përshkruar distancat në kilometra të tyre nga drejtuesit e mjeteve. Për lëvizjet ditore nga përdoruesit e mjeteve janë evidentuar në fletët e udhëtimit gjithë lëvizjet e kryera, të cilat janë kundërfirmuar nga personat udhëtues. Në fletët e udhëtimit janë bashkëlidhur kuponat tatimor për sasi të furnizuara, të lëshuara nga OE që ka kontratë me institucionin.

Konstatim:

Nga auditimi i pasqyrës së lëvizjes së mjetit për periudhën 2022-2023 u konstatua se:

Në pasqyrën e lëvizjes së mjetit me targë AB954AG për muajin Mars 2022 janë përshkruar destinacioni i lëvizjes së mjetit, i cili ka lëvizur jashtë Tirane dhe për asnjë nga lëvizjet nuk janë vënë KM e përshkruara.

Në pasqyrën e lëvizjes së mjeteve për vitin 2023 dhe përkatësisht për muajt si mëposhtë:

Muaji	Targa
Tetor 2023	POL.....
	TB.....F
Nëntor 2023	Ab.....EI
	TB.....F
	AB.....G
	AB.....R
Dhjetor 2023	AB....FR
	Ab.....EI
	TR.....7T

Nuk ka të përshkruar destinacionin e lëvizjes së mjetit, po vetëm është shënuar AS-lëvizje-AS dhe për asnjë nga lëvizjet nuk janë vënë KM e përshkruara.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me:

Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”.

- Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Nenin 4, pika 19 “Gjurma e auditimit”

- Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 36 “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve”.

- Si dhe rregulloren “Për Menaxhimin e mjeteve të Policisë së Shtetit” neni 13 “Administrimi dhe mirëmbajtja e automjeteve në përdorim të Aparatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit” pika 10 ku përcakton se: Për të gjithë shërbimet brenda Qytetit të Tiranës, në fletë udhëtimi nuk është e nevojshme të shënohet çdo rrugë, por mjafton të konfirmohet numri i kilometrave të përshkruar brenda qytetit sipas shënimit të tahometrit. Për rrugët jashtë qytetit (interurbane) plotësimi bëhet për çdo lëvizje.

- Në fund të çdo muaji janë hartuar pasqyrat përmbledhëse të konsumit mujor dhe mbylljes së muajit për çdo targë dhe zotërues mjeti. Për justifikimin e konsumit të karburantit janë kryer llogaritjet mujore që janë evidentuar në pasqyrën përmbledhëse e konsumit të karburantit, nga znj. L. D., konfirmuar nga Shefja e Sektorit Ekonomik znj. L. Sh..

Konsumin e karburantit për kaldajat dhe gjeneratorët

Në lidhje me konsumin e karburantit për kaldajat dhe gjeneratorët, konstatohet se Akademia e Sigurisë ka në përdorim 6 kaldaja për ngrohje dhe 5 gjenerator.

Konsumimi i lëndës djegëse sipas viteve detajuar si mëposhtë:

Viti 2022

Viti 2022, Lënda djegëse në litra					
Nr	Kaldaja	Çelja	Hyrje	Dalje	Gjendje 31.12.2022
1	Komanda	322.8	3000	3137.8	185
2	Hotel 5 Katëshe	505			505
3	Korpusi mësimor		3100	2074	1026

4	Hoteli 3 katëshe	182	2564	961	1785
5	Hoteli D+C	712	3452	3939.53	224.47
6	Palestra	71	950	843	178

Viti 2022, Lënda djegëse në litra					
Nr	Gjeneratori	Çelja	Hyrje	Dalje	Gjendje 31.12.2022
1	Gabinës	80		69	11
2	Korpusi mësimor	36.5		34.5	2
3	Kolegji	26.5		22.5	4
4	Hoteli C	70		42	28
5	Hoteli D	75		42	33

Viti 2023

Viti 2023, Lënda djegëse në litra					
Nr	Kaldaja	Çelja	Hyrje	Dalje	Gjendje 31.12.2023
1	Komanda	185	3000	2554	631
2	Hotel 5 Katëshe	505			505
3	Korpusi mësimor	1026		264	762
4	Hoteli 3 katëshe	1785	2500	4204.6	80.4
5	Hoteli D+C	224.47	8600	8756.47	68
6	Palestra	178	900	951.5	126.5

Viti 2023, Lënda djegëse në litra					
Nr	Gjeneratori	Çelja	Hyrje	Dalje	Gjendje 31.12.2023
1	Gabinës	11	40	51	0
2	Korpusi mësimor	2	40	33	9
3	Kolegji	4	40	23	21
4	Hoteli C	28	40	36	32
5	Hoteli D	33	40	36	37

Me urdhër të Ministrit të Brendshme nr. 405 datë 06.03.2006 është miratuar normativa e konsumit të lëndës djegëse dhe periudhat e ndezjes së kaldajave në Akademinë e Sigurisë.

Për vitin 2022 me urdhër nr.39, datë 31.01.2022 është ngritur komisioni i pranimit dhe kolaudimit të mallrave dhe shërbimeve , pajisjeve ngrohje-ftohje chillera/kaldaja Kondicioner.

Për vitin 2023 me urdhër nr.45 datë 02.02.2023 është ngritur komisioni i pranimit dhe kolaudimit të mallrave dhe shërbimeve , pajisjeve ngrohje-ftohje chillera/kaldaja Kondicioner.

Grupi i auditimi konstatoi se nuk është konstatuar dhe verifikuar gjendja e lëndës djegëse në cisternat e karburantit në fund të çdo sezoni të ngrohjes për secilën nga kaldajat dhe gjenerator e AS dhe nuk është pasqyruar niveli i lëndës djegëse në depozitat e kaldajave dhe gjeneratorëve.

Grupi i auditimit nuk mund të bëjë dot verifikimin e rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimit për përdorimin e karburantit në kaldajat dhe gjeneratorët pasi pavarësisht se janë mbajtur proces verbal me orarin e punës së tyre për secilin muaj, nuk ka gjurmë auditimi se sa ka qenë gjendja në cisternat e karburantit të tyre në çdo fillim viti ose në përfundim të sezonit.

Veprimet në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36, 74 dhe pika 122.

Zbatimi i Kontratave

- Paguesa për shërbime/mallra punë në zbatim të kontratave marrëveshje kuadër.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave për mallra/shërbime përgjatë vitit 2022 dhe vitit 2023, mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve si dhe të kontabilitetit të realizuara në AS konstatohet se,

1. Nga auditimi i zbatimit të kontratës me nr. 24/1 datë 12.12.2022 me objekt “Për blerje uniformash dhe elementesh të tjerë përbërës të tyre për AS” në vlerë totale 3,387,144 lekë lidhur mes AS dhe OE fitues “G. S.” të procedurës së prokurimit të zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara u konstatua;

OE fitues ka deklaruar në ofertë e paraqitur në tender se mallrat do të jenë të prodhuara nga subjekti “P.” Ltd me vende origjinë në Irlandë me distributor për shitjen e tyre nga OE “E.” shpk.

Bashkëlidhur kontratës janë lëshuar dhe deklaratat e Tipit të BE-së për konformitetin e produkteve, ku është cituar se produktet të cilat do të vihen në dispozicion janë konform kërkesave thelbësore të sigurisë dhe shëndetit të rregullores PPE(BE) 2016/425. Në deklaratë është cituar se janë prodhuar sipas standarteve më të larta duke përdorur komponentë të cilësisë së lartë. Në deklaratë janë të paraqitur dhe mostrat e uniformës që do prodhohen.

Deklaratat janë hartuar në P., I. Industrial park, W. I. me datën 28.01.2022.

Nga AK janë marrë dy furnizime:

Nga komisioni i marrjes në dorëzim ngritur me urdhër të Titullarit me nr. 39, datë 31.01.2022 i ndryshuar më përbërje R. D.; Sh. G dhe A.B dhe me nr. 45, datë 02.02.2023 më përbërje LD.; Sh. G. dhe A.B. u konstatua se:

Me datën 28.12.2022 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të 250 kostumeve dimërore në vlerën 2100 lekë pa TVSH /njësi dhe 250 kostumeve verore në vlerën 1,195 lekë pa TVSH /njësi. AS ka bërë likuidimin e OE me urdhër shpenzimit me nr. 271, datë 30.12.2022 në vlerën prej 988,500 lekë.

Me datën 30.10.2023 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të 330 kostumeve dimërore në vlerën 2100 lekë pa TVSH /njësi. AS ka bërë likuidimin e OE me urdhër shpenzimit me nr. 248, datë 06.11.2023, në vlerën prej 831,600 lekë.

Në procesverbalin e marrjes në dorëzim është cituar se mallrat e dorëzuara nga OE janë konform specifikimeve të kërkuara.

Nga OE janë dorëzuar fletët e analizës e testimit, të cilat janë kryer me datën 22.12.2022 të cilat janë përdorur për të gjithë furnizimet që OE ka sjellë në Akademinë e Sigurisë.

Mallrat mbi të cilët është bërë analiza e testimit, nuk i është vënë në dispozicion AK dhe nuk ka gjurmë se mbi cilin produkt është bërë testimi.

Në nenin 2 “Specifikimet teknike” të kontratës me nr. 24/1 datë 12.12.2022 me objekt “Për blerje uniformash dhe elementesh të tjerë përbërës të tyre për AS” është përcaktuar se:

Specifikimet teknike duhet të vijnë në mbështetje të shtojcës nr.5, Njoftim për Lidhje Kontrate nr. 122/6 Prot., date 02.06.2022, me Nr Reference REF-25868-04-20-2022, ardhur nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, si Organ Qendror Blerës/OQB.

Kostume sportive dimërore (Tuta, bluze). Tutat, të jene me dy xhepa anash që mbyllen me zinxhirë. Të kenë dy shirita anësore. Në mes të lidhen me dy lidhëse llastik me 2-3 tegela dhe një rip (ushkure) në mes. Tutat në Llastikun mbrapa të kenë numrin, masën.

Bluzat, të jene i njëjti material, të hapen me zinxhirë deri në fund. Në krahë të kenë shirita anësore të njëjtë, të kenë dy xhepa që mbyllen me zinxhirë. Në fund të bluzës dhe mëngëve të kenë punim me llastik deri 4-5cm të gjerë. Bluzës të qafa lartë i vendoset numri/masa. Në pjesën e prapme të bluzës nga brenda lart të shkruhet "Akademia e Sigurisë".

Kompleti dimërorë të prodhohet nga i njëjti material, shiritat anësor të jenë i njëjti material dhe të kenë ngjyrë të njëjtte tutat dhe bluza. Materiali për prodhimin e kompletit të jenë të përzierje 40-50% pambuk dhe 50-60% poliestër. Nga brenda materiali i përdorur të jetë i veshur në mënyrë të rregullt me shtresë pambuku. Në komplet të jenë të vendosura të dhënat e kërkuara.

Kompleti të jete i ambalazhuar, brenda te cilës të jenë të shënuara përmasat, modeli dhe emri i firmës prodhuese me te dhëna te shkurtuara. Masat dhe ngjyrat do të përcaktohen në momentin e lidhës së kontratës.

Kostumet sportive verore (mbathje, bluza me mëngë të shkurtra). Mbathje sportive, të jenë material përzierje pambuk me poliestër 30-70% me ngjyra të ndryshme. Në bel të jenë me lidhëse me llastik me dy tre fije. Në pjesën e pasme nga brenda lart vendoset numri/masa. Anash te ketë shirita me ngjyrën e materiali të përdorur. Çdo pale të jetë e paketuar. Bluzat me mëngë të shkurtra, të jenë me material 100% pambuk. Modeli T-shirt me tegela të rregullta. Ngjyra të jete e kombinuar me ngjyrën e mbathjeve Nga pas ti vendoset numri/masa.

Mallrat të jenë të shoqëruara me raport-testimi lëshuar nga organet kompetente të akredituara, certifikatat e konformitetit ose cilësisë CE/ ekuivalent si dhe certifikatën e origjinës.

Nga verifikimi në vend i mostrave të produkteve të marra në dorëzim u konstatua se:

1. Paketimi i tyre nuk ishte sipas specifikimeve të kërkuara në kontratë, pasi ato ishin të paketuara në ambalazh qese, mbi të cilën **nuk kishte asnjë shënim për përmasat, modeli dhe emri i firmës prodhuese me te dhëna te shkurtuara.**

2. **Kostumet sportive verore**, Mbathjet sportive **nuk kishin anash shirita, siç janë kërkuar në specifikimet teknike.**

Nga mostra e verifikuar “Mbathje sportive” ngjyrë blu kishin të shënuar përbërje 50% Pol dhe 50% Pam dhe nuk ishin sipas specifikimeve të kërkuara ku: Mbathje sportive, të jenë material përzierje pambuk me poliestër 30-70% me ngjyra të ndryshme.

3. Të gjithë pantallonat e tjera të shkurtra u mungon viza anash.

3. Gjithashtu nga verifikimi i mostrave “Bluzat me mëngë të shkurtra” ku Etiketa e prodhimit ka të shkruar “J. C.”, kishin material 70% Poliestër dhe 30% Pambuk, dhe jo sipas specifikimeve të kërkuara: Bluzat me mëngë të shkurtra, të jenë me material 100% pambuk.

4. Në etiketa ishte e shënuar emri i kompanisë J. C., si dhe vendi i prodhimit Shqipëri (made in Albania).

Si dhe një pjesë të kostumeve kishin në etiketa të shënuar emri i kompanisë nga “K. E.” dhe T-shirt të kuqe ishin pa numër të stampuar.

- T-shirt Blu nga kompania “R.” nuk kishin numra të stampuar.

Sa më sipër, produktet e sjella janë në kundërshtim me ofertën e paraqitur nga OE fitues pasi është deklaruar se mallrat do të jenë të prodhuara nga “P.” Ltd me vend origjinë në Irlandë me distributor për shitjen e tyre “E.” shpk.

Etiketimi i bluzave me emrin e tregtare J. C. e cila nuk është prodhuese sipas ekstraktit në QKB është në kundërshtim me dokumentet e dorëzuar në tender, ku në deklaratën e datës 04.05.2022 është deklaruar se:

Do të përmbush kërkesat e AK me kontratë furnizimi për të gjithë artikujt objekt prokurimi me kompaninë prodhuese "P." Ltd, nëpërmjet distributorit zyrtar në Shqipëri, kompania "E." Shpk me nr Nipt: L.....Q.

*Kostumet sportive dimërore (Tuta Bluzë) dhe Kostumet sportive verore (mbathje, bluza me mëngë të shkurtra) **ka deklaruar se vendi i origjinës është Irlandë** dhe certifikata e konformitetit nga kompania “P.”*

- Mallrat e marra në dorëzim nuk janë të shoqëruara me certifikatën e origjinës, siç është kërkuar në DT dhe në kontratën e lidhur mes palëve.

Konkluzion:

Sa më sipër konstatohet se kontrata nuk është realizuar sipas Specifikimeve teknike të përcaktuara në shtojcës nr.5, Njoftim për Lidhje Kontrate me nr. 122/6 Prot., datë 02.06.2022, me numër Reference REF-25868-04-20-2022, ardhur nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, si Organ Qendror Blerës/OQB, si dhe përcaktimeve të kontratës me nr. 24/1 datë 12.12.2022 me objekt “Për blerje uniformash dhe elementesh të tjerë përbërës të tyre për AS” në vlerë totale 3,387,144 lekë lidhur mes AS dhe OE fitues “G. S.”.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” nenin 124 “**Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës**” ku përcaktohet se: *Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi.*

Si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës” pika 7 ku përcakton se: Personi apo strukturat e ngarkuara nga titullari i autoritetit/entit kontraktor, sipas legjislacionit të fushës në fuqi, duhet të ndjekin me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t’u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës.

Personi apo strukturat e ngarkuara për ecurinë e zbatimit të kontratës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:

- a) Harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;
- b) Kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë;
- c) Administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- ç) Sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë, dhe afateve, kur është rasti;
- d) Menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/modifikime/përshtatje të saj;
- dh) Raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;
- e) Administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës, dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
- ë) Mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;
- f) Përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së.

Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqëruar të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e

specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.

Me shkresën nr. 2471 datë 01.11.2023 nga AS drejtuar Degës së Thesarit Tiranë ka kërkuar mbylljen e kontratës me nr. 24/1 datë 12.12.2022 me objekt “Për blerje uniformash dhe elementesh të tjerë përbërës të tyre për AS” për periudhën 12.12.2022 deri me datën 31.12.2023 obliguar në vlerë totale 3,387,144 lekë, e cila është realizuar në shumën prej 1,820,100 lekë.

Për veprimet e mësipërm ngarkohet me përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave.

2. Nga auditimi i zbatimit të kontratës me nr. 04/2 datë 08.04.2022 me objekt “Për blerje këpucë, atlete sportive” në vlerë totale 2,091,744 lekë lidhur mes AS dhe OE fitues “G. S.” të procedurës së prokurimit të zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara u konstatua; OE fitues ka deklaruar në formularin e ofertës në tender, vendi i origjinës është Irlandë, nga prodhuesi “P.t” Ltd.

Nga AK janë marrë tre furnizime:

Nga komisioni i marrjes në dorëzim ngritur me urdhër të Titullarit me nr. 39, datë 31.01.2022 i ndryshuar më përbërje F.K., G. Gj.; L. D. Sh. G. dhe A. B. dhe në furnizimet e tjera është zëvendësuar L.D. me R.D., si dhe me Urdhër nr. 45, datë 02.02.2023 më përbërje L.D., Sh, G, dhe A.B. u konstatua se:

Me datën 15.04.2022 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të 172 këpucë atlete në vlerën 2160 lekë pa TVSH /njësi. AS ka bërë likuidimin e OE me urdhër shpenzimit me nr. 72, datë 27.04.2022 në vlerën prej 445,824 lekë, bazuar në fature e lëshuar nga OE me nr. 30/2022, datë 15.04.2022 në vlerën 445,824 lekë.

Me datën 09.12.2022 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të 217 këpucë atlete në vlerën 2160 lekë pa TVSH /njësi. AS ka bërë likuidimin e OE me urdhër shpenzimit me nr. 243, datë 15.12.2022 në vlerën prej 554,176 lekë, nga 562,464 lekë që është fatura e lëshuar nga OE me nr. 126/2022 datë 09.12.2022.

Me datën 24.10.2023 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të 374 këpucë atlete në vlerën 2100 lekë pa TVSH /njësi. AS ka bërë likuidimin e OE me urdhër shpenzimit me nr. 248, datë 06.11.2023, në vlerën prej 831,600 lekë.

Në Deklaratën e garancisë së mallit OE ka deklaruar se garancia për mallrat objekt prokurimi blerje këpucë për Akademinë e Sigurisë është 6 muaj konform specifikimeve teknike sipas standardeve Evropiane.

Në procesverbalin e marrjes në dorëzim është cituar se mallrat e dorëzuara nga OE janë konform specifikimeve të kërkuara dhe bashkëlidhur është fletë analizës ku vërtetohet plotësimi i parametrave teknike të kërkuar.

Konstatim:

Nga OE për të dy furnizimet është vënë në dispozicion raporti i testimit i lëshuar me datën 27.01.2022 ku është përcaktuar se “*këpucë atlete faqet kombinuar lëkurë natyrale dhe tekstile rrytë 30%, gomë e bute tabani i atleteve poroz dhe i trashë*”.

Raport testimi i realizuar nga Laboratori fiziko mekanik dhe kimik i tekstilit dhe lëkurës, është realizuar mbi kampione përpara se: të realizohej procedura e prokurimit; të përcaktoheshin specifikimet dhe përpara se të lidhej kontrata marrëveshje kuadër me nr. 98/5 datë 02.03.2022 dhe kontrata mes OE dhe AS.

Nga OE është paraqitur dhe një raport testimi i datës 01.09.2022 ku është përcaktuar: “Shollë e bardhë me relief, lartësia 1.5 cm në majë dhe 3.5 cm në thembër, rezistencë në shkëputje 12kn/m ndaj abrazionit 130m3 ndaj përkulje 10%”.

Në nenin 2 “Specifikimet teknike” të kontratës me nr. 04/2 datë 08.04.2022 me objekt “Për blerje këpucë, atlete sportive” është përcaktuar se:

Specifikimet teknike duhet të vijnë në mbështetje të shtojcës nr.5 Njoftim për Lidhje Kontrate nr.98/5 Prot., date 02.03.2022, me numër Reference REF-07231-10-05-2021, ardhur nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, si Organ Qendror Blerës/OQB.

- Këpucë atlete të jene me përbërje të kombinuar lëkure të ndërthurur me rrjete në masën 20-30%. Të kenë lidhëse të cilat kalojnë në vrima të përforcuara me tegela të rregullt me hap të njëjtë, pa grumbullime penjsh. Këpucët (atletet), të jenë të përshtatshme për vrapim në terrene të hapura, pjesa që prek tokën të jete prej gome të butë, ku të jenë stampuar dukshëm numri.

Tabani nga brenda të jete i trashë dhe poroz. Atletet të jenë ngjyra të ndryshme, të cilat do të përcaktohen në momentin e lidhjes së kontratës. Të paketohen në kuti kartoni të shkruara të dhënat, sipas kërkesave të mësipërme.

Numri i këpucës të jetë i dallueshëm dhe të jete sipas standardit evropian. Materialet e përdorura për veshjet sportive të jene me cilësi të lartë dhe ngjyrat rezistonte gjatë larjes dhe agjenteve atmosferike. Masat dhe ngjyrat do të përcaktohen në momentin e lidhjes së kontratës. Mallrat të jenë të shoqëruara me fletë-analize të kryer nga Institucione të certifikuar, ku të vërtetohet plotësimi i parametrave teknik të kërkuara nga ana jonë.

Nga verifikimi në vend i mostrave të produkteve të marra në dorëzim u konstatua se:

-Në ftesën për ofertë është paraqitur se vendi origjinës është Irlandë dhe certifikatë e lëshuar nga organet e akredituar CE nga P. “Deklaratën e konformitetit CE”, ndërkohë nga verifikimi i mostrave rezultoi se atletet kishin të shënuar prodhimin made in Vietnam, si dhe nuk kishte asnjë certifikatë të konformitetit.

-Paketimi i tyre nuk ishte sipas specifikimeve të kërkuara në kontratë, pasi në kutitë e ambalazhimit të produkteve nuk kishte të shkruara të dhënat, sipas kërkesave të kërkuara.

- Në pjesën e atletes që prek tokën nuk ishte e stampuar dukshëm numri i kërkuar sipas specifikimeve teknike.

- Fletë-analiza e dorëzuar nga OE nuk është e vërtetuar se mbi çfarë produktesh është kryer dhe nëse përputhet me produktet e dorëzuar nga OE për realizimin e kontratës.

Konkluzion:

Sa më sipër konstatohet se kontrata nuk është realizuar sipas Specifikimeve teknike të përcaktuara në shtojcës nr.5, Njoftimit për Lidhje Kontrate me nr. 122/6 Prot., datë 02.06.2022, me numër Reference REF-25868-04-20-2022, ardhur nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, si Organ Qendror Blerës/OQB. si dhe përcaktimeve të kontratës me nr. 04/2 datë 08.04.2022 me objekt “Për blerje këpucë, atlete sportive” në vlerë totale 2,091,744 lekë lidhur mes AS dhe OE fitues “G. S.”.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 124 “**Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës**” ku përcaktohet se: *Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi.*

Si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës” pika 7 ku përcakton se: Personi apo strukturat e ngarkuara

nga titullari i autoritetit/entit kontraktor, sipas legjislacionit të fushës në fuqi, duhet të ndjekin me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës.

Personi apo strukturat e ngarkuara për ecurinë e zbatimit të kontratës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:

- a) Harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;
- b) Kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;
- c) Administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- ç) Sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë, dhe afateve, kur është rasti;
- d) Menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/modifikime/përshtatje të saj;
- dh) Raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;
- e) Administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës, dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
- ë) Mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;
- f) Përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së.

Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqëruar të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.*

Me shkresën nr. 2511, datë 08.11.2023 nga AS drejtuar Degës së Thesarit Tiranë ka kërkuar mbylljen e kontratës me nr. 04/2 datë 08.04.2022 me objekt “Për blerje këpucë, atlete sportive”, për periudhën 08.04.2022 deri me datën 31.12.2023 obliguar në vlerë totale 2,091,744 lekë, e cila është realizuar në shumën prej 1,969,408 lekë.

Për veprimet e mësipërm ngarkohet me përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave.

Konkluzion:

Për të kontratat e lidhur mes AS dhe OE fitues “G. S.” me objekt “Për blerje uniformash dhe elementesh të tjerë përbërës të tyre për AS” dhe me objekt “Për blerje këpucë, atlete sportive” kontratat nuk janë realizuar sipas Specifikimeve teknike të përcaktuara në shtojcës nr.5, Njoftim për Lidhje Kontratës,.

Si konkluzion ndodhemi në kushtet e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga OE të përcaktuara në nenin 78 pika 1/b të LPP.

3. Nga auditimi i zbatimit të kontratës me nr. 1752, datë 26.08.2022 me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering) për Akademinë e Sigurisë” në vlerë totale 247,967,144 lekë, për 36 muaj, lidhur mes AS dhe OE fitues “S.” shpk të procedurës së prokurimit të zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara u konstatua;

3.1. Me urdhër të Titullarit me nr. 39, datë 31.01.2022 i ndryshuar më përbërje L. D., P. K., O.P. dhe Sh.B. dhe me nr. 45, datë 02.02.2023 më përbërje L.D.,P.K., dhe A..Xh., është ngritur komisioni i pritjes dhe kolauditimit në shërbimin e ushqimit.

- Nga kryqëzimi i procesverbaleve të mbajtura nga komisioni pranimit të malli për çdo ditë /vakt në “Libër procesverbal ushqimi” me fletë daljet ditore të ushqimit ka rezultuar se:

a) Për 24 (njëzet e katër) raste, në vitin 2022 dhe 74 (shtatëdhjetë e katër) raste në vitin 2023 në procesverbalet e mbajtura nuk janë shënuar numri i vakteve të marrë në dorëzim, sipas tabelës më poshtë:

Viti 2022

Mëngjesi	Data		Nr. racioneve flete dalje
proces verbalet	26.09.2022	0	249
proces verbalet	29.09.2022	0	261
proces verbalet	07.10.2022	0	32
proces verbalet	11.10.2022	0	35
proces verbalet	31.10.2022	0	223
proces verbalet	24.11.2022	0	319
Dreka		0	
proces verbalet	26.09.2022	0	360
proces verbalet	29.09.2022	0	343
proces verbalet	03.10.2022	0	69
proces verbalet	07.10.2022	0	68
proces verbalet	11.10.2022	0	65
proces verbalet	31.10.2022	0	523
proces verbalet	08.11.2022	0	485
proces verbalet	16.11.2022	0	474
proces verbalet	24.11.2022	0	476
proces verbalet	02.11.2022	0	447
proces verbalet	06.11.2022	0	343
Dreka			
proces verbalet	20.09.2022	0	251
proces verbalet	26.09.2022	0	261
proces verbalet	29.09.2022	0	7
proces verbalet	31.10.2022	0	336
proces verbalet	16.11.2022	0	323
proces verbalet	24.11.2022	0	311
proces verbalet	06.11.2022	0	310

Mëngjesi	Data		Nr. racioneve flete dalje
proces verbalet	05.01.2023	0	292
proces verbalet	06.01.2023	0	292
proces verbalet	12.01.2023	0	292
proces verbalet	16.01.2023	0	210
proces verbalet	20.01.2023	0	292
proces verbalet	09.02.2023	0	250

proses verbalet	03.03.2023	0	332
proses verbalet	09.03.2023	0	342
proses verbalet	16.03.2023	0	355
proses verbalet	18.03.2023	0	286
proses verbalet	28.03.2023	0	332
proses verbalet	31.03.2023	0	318
proses verbalet	03.04.2023	0	209
proses verbalet	05.05.2023	0	342
proses verbalet	13.04.2023	0	324
proses verbalet	20.04.2023	0	108
proses verbalet	09.05.2023	0	54
proses verbalet	26.05.2023	0	30
proses verbalet	06.06.2023	0	20
proses verbalet	12.06.2023	0	389
proses verbalet	26.06.2023	0	403
proses verbalet	05.07.2023	0	412
proses verbalet	06.07.2023	0	411
proses verbalet	13.07.2023	0	411
proses verbalet	25.07.2023	0	401
proses verbalet	30.08.2023	0	397
proses verbalet	15.09.2023	0	396
proses verbalet	19.09.2023	0	389
proses verbalet	27.10.2023	0	444
proses verbalet	24.11.2023	0	519
proses verbalet	01.12.2023	0	516
proses verbalet	02.12.2023	0	504
proses verbalet	14.12.2023	0	527
Dreka			
proses verbalet	16.01.2023	0	419
proses verbalet	20.01.2023	0	419
proses verbalet	24.01.2023	0	277
proses verbalet	28.02.2023	0	597
proses verbalet	03.03.2023	0	554
proses verbalet	18.03.2023	0	436
proses verbalet	28.03.2023	0	550
proses verbalet	31.03.2023	0	520
proses verbalet	03.04.2023	0	538
proses verbalet	29.05.2023	0	135
proses verbalet	06.06.2023	0	149
proses verbalet	26.06.2023	0	544
proses verbalet	03.10.2023	0	609
proses verbalet	19.10.2023	0	633
proses verbalet	02.12.2023	0	723
Darka			
proses verbalet	09.01.2023	0	292
proses verbalet	12.01.2023	0	292
proses verbalet	24.01.2023	0	238
proses verbalet	01.02.2023	0	230
proses verbalet	21.02.2023	0	327
proses verbalet	28.02.2023	0	324
proses verbalet	01.03.2023	0	332
proses verbalet	06.03.2023	0	342
proses verbalet	16.03.2023	0	365
proses verbalet	23.03.2023	0	316
proses verbalet	28.03.2023	0	332
proses verbalet	03.04.2023	0	342
proses verbalet	04.04.2023	0	342
proses verbalet	09.05.2023	0	54
proses verbalet	06.06.2023	0	20

proces verbalet	10.06.2023	0	380
proces verbalet	14.06.2023	0	420
proces verbalet	26.06.2023	0	419
proces verbalet	04.07.2023	0	412
proces verbalet	30.08.2023	0	397
proces verbalet	31.08.2023	0	397
proces verbalet	19.09.2023	0	389
proces verbalet	12.10.2023	0	392
proces verbalet	24.11.2023	0	505
proces verbalet	26.12.2023	0	92
proces verbalet	27.12.2023	0	92

b) Për 6 raste, në vitin 2022 dhe 38 (tridhjetë e tetë) raste në vitin 2023 nuk janë mbajtur procesverbalet e marrjes së vakteve në dorëzim, si dhe nuk janë të raportuara në librin e dorëzimit të ushqimit , por praktika ka të bashkëlidhur vetëm fletë daljen sipas tabelës më poshtë:

Viti 2022

Data	Vakti	Racionet në fletë dalje	Mungon
22.10.2022	mëngjesi	5	libri I dorëzimit/procesverbalin
22.10.2022	dreka	5	libri I dorëzimit/procesverbalin
22.10.2022	darka	5	libri I dorëzimit/procesverbalin
23.10.2022	mëngjesi	5	libri I dorëzimit/procesverbalin
23.10.2022	dreka	5	libri I dorëzimit/procesverbalin
23.10.2022	darka	5	libri I dorëzimit/procesverbalin

Viti 2023

13.03.2023	darka	20	procesverbal
14.03.2023	mëngjesi	24	procesverbal
14.03.2023	dreka	36	procesverbal
14.03.2023	darka	24	procesverbal
20.03.2023	darka	27	procesverbal
21.03.2023	darka	20	procesverbal
22.03.2023	mëngjesi	20	procesverbal
22.03.2023	dreka	28	procesverbal
22.03.2023	darka	20	procesverbal
10.05.2023	darka	31	libri I dorëzimit/procesverbal
13.05.2023	mëngjesi	8	libri I dorëzimit/procesverbal
13.05.2023	dreka	8	libri I dorëzimit/procesverbal
13.05.2023	darka	8	libri I dorëzimit/procesverbal
14.05.2023	mëngjesi	8	libri I dorëzimit/procesverbal
14.05.2023	dreka	8	libri I dorëzimit/procesverbal
14.05.2023	darka	8	libri I dorëzimit/procesverbal
15.05.2023	mëngjesi	8	libri I dorëzimit/procesverbal
15.05.2023	darka	12	libri I dorëzimit/procesverbal
16.05.2023	mëngjesi	12	libri I dorëzimit/procesverbal
20.05.2023	dreka	10	libri I dorëzimit/procesverbal
01.06.2023	mëngjesi	25	libri I dorëzimit/procesverbal
23.06.2023	dreka	9	libri I dorëzimit/procesverbal
14.10.2023	mëngjesi	3	libri I dorëzimit/procesverbal
14.10.2023	dreka	3	libri I dorëzimit/procesverbal
14.10.2023	darka	3	libri I dorëzimit/procesverbal
15.10.2023	mëngjesi	3	libri I dorëzimit/procesverbal

15.10.2023	dreka	3	libri I dorëzimit/procesverbal
15.10.2023	darka	3	libri I dorëzimit/procesverbal
20.10.2023	darka	3	libri I dorëzimit/procesverbal
21.10.2023	mëngjesi	3	libri I dorëzimit/procesverbal
21.10.2023	dreka	3	libri I dorëzimit/procesverbal
05.11.2023	darka	3	libri I dorëzimit/procesverbal
30.11.2023	mëngjesi	13	libri I dorëzimit/procesverbal
07.12.2023	darka	3	libri I dorëzimit/procesverbal
08.12.2023	mëngjesi	3	libri I dorëzimit/procesverbal
08.12.2023	dreka	3	libri I dorëzimit/procesverbal
08.12.2023	darka	3	libri I dorëzimit/procesverbal
09.12.2023	mëngjesi	3	libri I dorëzimit/procesverbal

c) Për dy raste, në vitin 2022 dhe 7 shtatë raste në vitin 2023 rezultuan diferenca midis procesverbaleve të mbajtura dhe fletë daljeve, ku në fletë dalje ka më shumë racione sesa racionet e marrë në dorëzim sipas procesverbalit ditor të mbajtur sipas tabelës më poshtë:

Data	Vakti	Racione ne fletë dalje	Racione në proces verbal	Diferenca	Çmimi/pa tvsh	Vlera e paguar
25.10.2022	mëngjesi	342	321	21	116.36	2,444
01.11.2022	dreka	523	501	22	476.79	10,489
10.03.2023	darka	315	259	56	116.9	6,546
15.03.2023	mëngjesi	317	312	5	116.36	582
15.03.2023	darka	355	335	20	116.9	2,338
27.03.2023	dreka	549	539	10	476.79	4,768
11.04.2023	darka	324	317	7	116.9	818
12.09.2023	dreka	441	411	30	476.79	14,304
13.09.2023	dreka	441	411	30	476.79	14,304
29.09.2023	mëngjes	398	389	9	116.36	1,047
29.09.2023	dreka	315	310	5	476.79	2,384
02.10.2023	dreka	659	657	2	476.79	954
02.10.2023	darka	439	389	50	116.9	5,845
04.12.2023	darka	531	430	101	116.9	11,807
13.03.2023	dreka	48	20	28	476.79	13,350
Totali						91,980

Sa më sipër, u konstatua parregullsi dhe mangësi në procedurat e menaxhimit dhe kontrollit të ushqimit të dorëzuar dhe të marrë në dorëzim nga Akademia e Sigurisë, veprime të cilat janë në kundërshtim me:

- Kontratën me nr. 1752, datë 26.08.2022 neni 32 Kontrollat ku përcakton:

31.1 Të drejtën e kontrollit të cilësive së ushqimit të gatuar, pastërtisë e ka personi i autorizuar nga Autoriteti Kontraktor, në prani të përfaqësuesit të Kontraktuesit.

31.2 Sektori ekonomik i Porositësit ka të drejtën të ushtroje kontroll për: sasinë, cilësinë, pastërtinë gjatë procesit të shpërndarjes së ushqimit në prani të përfaqësuesit të Kontraktuesit. Kontraktuesi është i detyruar të ruaj kampionet e çdo lloj ushqimi dhe vakti jo me pak se 24- ore.

31.3 Përfaqësuesi i caktuar nga Akademia e Sigurisë, çdo vakt firmos procesverbalin e ndërrimit të kampionit dhe librin e kontrollit cilësor të ushqimit për çdo gjellë të gatuar. Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi në rast se përfaqësuesi i Akademisë së Sigurisë nuk paraqitet në orarin e caktuar për kontrollin e ushqimit të gatuar.

- Me urdhrin e Rektorit të AS me nr. 405, prot., 2130, datë 05.10.2022 "Për mënyrën e funksionimit, pranimit, administrimit kontrollit dhe zbatimin e kontratës së "Shërbim gatimi dhe

Shpërndarjes së ushqimit" ku është përcaktuar në pika 4 dhe 5: “Për vaktin 'Drekë dhe për vaktin "Mëngjes dhe Darkë", nga e hëna deri te premtën, të funksionoj një komision pranimi malli, i cili ka për detyrë të kontrolloj cilësinë e ushqimit të gatuar, sasinë e racioneve ushqimore, duke e krahasuar me fletë-daljen provizore të ardhur nga subjekti kontraktor, dhe evidentuar në Librin e pranimit të ushqimit, për çdo vakt ushqim të specifikuar....”,

- Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 36 “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve”.

- Nga auditimi u konstatua se bashkëlidhur praktikave nuk ka asnjë gjurmë të shpërndarjes së bonove të ushqimit, siç është përcaktuar në nenin 12 “Forca e përditshme e ushqimit” pika 12.5 ku është përcaktuar se “Bonot do të përgatiten nga Kontraktuesi dhe do të vulosën nga porositi. Shpërndarja e Bonove do të bëhen kursantëve nga Personi i autorizuar nga AS” si dhe me urdhrin e Rektorit të AS me nr. 405, prot., 2130, datë 05.10.2022 “ Për mënyrën e funksionimit, pranimit, administrimit kontrollit dhe zbatimit të kontratës së "Shërbim gatimi dhe Shpërndarjes së ushqimit" pika 3. Kontraktori do të sjellë në A.S, në Seksionin e Sigurisë- Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, bonot e ushqimit në ditën që merr Raport Forcën.

Personat që japin forcën, do të tërheqin bonot e ushqimit dhe do të bëjnë shpërndarjen e tyre në, Kursant/Studentë me dokumentin "Liste shpërndarje".

3.2. Gjithashtu nga auditimi i zbatimit të kontratës me nr. 1752, datë 26.08.2022 me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering) për Akademinë e Sigurisë” në vlerë totale 247,967,144 lekë, për 36 muaj, lidhur mes AS dhe OE fitues “S.” shpk të procedurës së prokurimit të zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara u konstatua;

- Me shkresën nr. 6043, datë 11.10.2022 me lëndën “Mbi furnizimin me ushqim të Insitutit të Përgatitjeve së Qenve të Policisë së Shtetit” të Drejtorit të Departamentit për Shërbimet Mbështetëse në DPPSH, ka autorizuar Akademinë e Sigurisë: Të furnizojë me ushqim të gatuar me racion ditor (me 3-vakte dhe vaktin dreke) Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë së Shtetit, sipas kërkesës për numrin e kursanteve që do të trajnohen çdo ditë. Dokumentimi i procesit do të behet në zbatim të Udhëzimit nr. 30, date 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", pikës 55, për hyrjet e mallrave që qarkullojnë pa pagese, sipas procedurave të rregullta të parashikuara në procesin e pritjes dhe marrjes në dorëzim për shërbimin e ushqimit. Drejtoria e Mbështetjes Logjistike në fund të muajit për racionet ditore të furnizuara, të përgatisë urdhër- dorëzimin për kalimin pa pagese të shërbimit nga Akademia e Sigurisë për IPQPSH. Mbulimi i shërbimit të ushqimit për Instituti i Përgatitjes së Qenve të Policisë së Shtetit, në lidhje me trajtimin me ushqim të kursanteve që trajnohen në këtë institucion, deri në zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe lidhjen e kontratës për "Shërbim gatimi dhe shpërndarjen e ushqimit" nga ky institucion.

Me shkresën nr. 5163/1, datë 28.12.2022 me lëndën “Mbi furnizimin me ushqim të Insitutit të Përgatitjeve së Qenve të Policisë së Shtetit” të Drejtorit të Departamentit për Shërbimet Mbështetëse në DPPSH, ka autorizuar Akademinë e Sigurisë: Të furnizojë me ushqim të gatuar me racion ditor (me 3-vakte dhe vaktin dreke) Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë së Shtetit,

sipas nevoja dhe kërkesës për numrin e kursanteve që do të trajnohen sipas periudhës për vitin 2023.

Autorizimi është bërë pas një memo të datës 15.12.2022 nr. Prot 6774, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nga Drejtori i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin me lëndën “Mbi furnizimin me ushqim të kursantëve në Institutin e përgatitjes së qeneve të policisë” ku është kërkuar:

Instituti i Përgatitjes së Qeneve të Policisë në zbatim të detyrave funksionale për përgatitjen e qeneve të Policisë së Shtetit, zhvillon çdo vit program mësimor me kursantet që merren me përgatitjen e qeneve të miratuara nga Akademia e Sigurisë, program i cili korrespondon në të njëjtën kohë me programin vjetor të studenteve dhe kursanteve në Akademia e Sigurisë. Për trajtimin me ushqim të kursanteve gjatë zhvillimit të procesit mësimor, në zbatim të VKM-së nr. 189, datë 15.03.2017, "Për trajtimin me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit, të studenteve dhe kursantëve në institutet mësimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar ose arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre", nga ana jonë çdo vit janë kryer procedurat e prokurimit me vlerë të vogël për një sasi rreth 1400 racione ditore "shërbim gatimi dhe shpërdorje ushqimi" në vite ose 12 racione ditore në ditë, me vlerë rreth 850,000 leke në vit. Duke qënë një sasi e vogël ditore për këtë shërbim, zhvillimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël ka hasur në vështirësi dhe ka patur gjithmonë probleme për furnizimin me ushqim të kursanteve, pasi nuk afrohen firma serioze për këtë qëllim, por njësi të vogla tregtare që nuk plotësojnë kushtet.

Nisur nga këto vështirësi duke qënë së programi vjetor i trajnimit të kursanteve është në të njëjtën kohë, si dhe e njëjta normë trajtimi ushqimor me atë të Akademisë së Sigurisë për zgjidhjen e këtij problemi mendojmë se; furnizimi me ushqim të bëhet nga Akademia e Sigurisë duke marrë dakortësinë e tyre dhe të kompanisë kontraktuese që furnizon këtë Institucion.

Sa më sipër:

Akademia e Sigurisë në zbatim të autorizimit të lartpërmendur ka ofruar shërbimin e kërkuar në dakortësi me Kontraktorin, por të pa dokumentuar në formë shkresore dhe në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në kontratën e lidhur për këtë shërbim.

Për Institutin e Përgatitjes së Qeneve të Policisë deri me datën 31.12.2023 është paguar vlera e shërbimit të cateringut në shumën prej 1,704,864 lekë pa TVSh, vlerë e cila është jashtë parashikimeve të kushteve të kontratës dhe vlerave të parashikuara në marrëveshjen kuadër.

Zbatimi i autorizimit të lëshuar nga Drejtori i Departamentit për Shërbimet mbështetëse në DPPSH, nga strukturat përgjegjëse të Akademisë është veprim në kundërshtim me LPP 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Kreu XV “Zbatimi i kontratës” nga neni 122 e vijues si dhe me VKM-në me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 64 “Llojet e marrëveshjes kuadër” pika 2 ku përcakton se: Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen ndryshime të kushteve, për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër.

Nëse nevojat e autoritetit/entit kontraktor ndryshojnë, atëherë do të duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Një operator ekonomik i kërkohet të përgatisë ofertën e tij për kontratën bazuar në marrëveshjen kuadër vetëm në lidhje me kushtet, për të cilat është rënë dakord paraprakisht në marrëveshjen kuadër.

Si dhe Neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës” pika 7 “Personi apo strukturat e ngarkuara nga titullari i autoritetit/entit kontraktor, sipas legjislacionit të fushës në fuqi, duhet të ndjekin me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t’u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe

kushteve të kontratës”, Personi apo strukturat e ngarkuara për ecurinë e zbatimit të kontratës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:

dh) Raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;

e) Administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës, dhe **sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;**

Gjithashtu nga auditimi në lidhje me marrjen në dorëzim të ushqimit nga IPQP, u konstatuan parregullsi dhe mangësi në procedurat e menaxhimit dhe kontrollit të ushqimit të dorëzuar dhe të marrë në dorëzim nga Akademia e Sigurisë, pasi:

- Ushqimi në IPQPSH serviret nga OE në basketa, i cili bëhet gati në ambientet e Akademisë së Sigurisë, pasi *komisioni pranimit malli, ka kontrolluar cilësinë e ushqimit të gatuar, sasinë e racioneve ushqimore, duke e krahasuar me fletë-daljen provizore të ardhur nga subjekti kontraktor, dhe evidentuar në Librin e pranimit të ushqimit, për çdo vakt ushqim të specifikuar....”, si rrjedhojë AS ka detyrë të bëjë fletë dalje provizore, si dhe të regjistrojë në Librin e pranimit ditore dhe për ushqimin i cili dërgohet tek IPQPSH.*

- Gjithashtu dhe në autorizimin e dërguar nga DPPSH është përcaktuar që pritja dhe marrja në dorëzim e mallit do bëhet nga Akademia e Sigurisë. Drejtoria e Mbështetjes Logjistike në fund të muajit për racionet ditore të furnizuara, të përgatisë urdhër- dorëzimin për kalimin pa pagese të shërbimit nga Akademia e Sigurisë për IPQPSH, gjë e cila nuk është realizuar.

Akt rakordimi është bërë nga IPQPSH kundër firmosur nga OE dhe ka të bashkëlidhur vetëm fletë dalje mujore dhe jo fletë dalje ditore provizore, si dhe mungojnë procesverbalet e marrjes në dorëzim të ushqimit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

- Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 36 “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve”, si dhe pika 55.

- Nga auditimi rezultoi se fletë daljet e ushqimit nuk janë firmosur nga *komisioni i pranimit të mallit, i cili ka për detyrë që të kontrollojë sasinë e racioneve ushqimore të sjellë nga OE, (gjë e cila nuk është e dokumentuar)*, por është firmosë vetëm nga magazinierja e cila nuk është prezentë në pranimin e mallit.

Për veprimet e mësipërm ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i pranimit, administrimit kontrollit dhe zbatimin e kontratës së "Shërbim gatimi dhe Shpërndarjes së ushqimit".

Për sa është trajtuar në Project raportin rubrika C. Masa për shpërblim demi, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1448/5, datë.03.09.2024 administruar në KLSH me nr. 646/4 prot., datë 04.09.2024, nga Akademia e Sigurisë ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në nenin 16 të kontratës me nr. 1752, date 26.08.2022, në pikën 16-1, thuhet: "Kontraktuesi merr përsipër të kryej shërbimin në raste dalje të kursanteve në terren për stërvitje të ndryshme. Ky shërbim do të sigurohet deri në qendrën e stërvitjes", pra jemi plotësisht në zbatim të kushteve të kontratës.

Në asnjë raste nuk ka marrëdhënie shkresore apo dokumentare midis: Subjektit S.....dhe Institutit të Përgatitjes së Qeneve të Policisë.

Në faqen 57, paragrafi trete i projekt raportit thuhet "Zbatimi i autorizimit të lëshuar nga ana e Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse, nga strukturat përgjegjëse të Akademisë së Sigurisë është veprim në kundërshtim me Ligjin 162/2020, "Për prokurimin Publik", kreu XV zbatimi i kontratës, nga neni 12 e vijues, për sa me sipër ju sqarojmë se: • Zbatimi i këtij autorizimi nuk ka lidhje me kushtet e kontratës apo marrëveshjes kuadër. Autorizimi është brenda kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave me nr.30, date 27.12.2011, dhe konkretisht të nenit 55, për qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve pa pagese midis institucioneve, pra autorizimi ka të bëjë me shpërndarjen e mallit apo shërbimit pasi është bërë hyrje në magazinat e Akademisë së Sigurisë. Theksojmë se të gjitha dokumentet definitive financiare të hartuar për këtë shërbim si fatura elektronike e OE S., fletë hyrja definitive e Akademisë së Sigurisë si dhe procesi verbal i pritjes dhe kolaudimit të mallrave dhe shërbimeve janë hartuar vetën nga ana e subjektit S. në cilësinë e OE dhe institucionit Akademia e Sigurisë në cilësinë e AK, pra në asnjë rast nuk do të gjeni Institutin e Përgatitjes së Qeneve të Policisë si pale në marrëveshjes, kontrate apo dokumente financiare. Në çdo rast sektori i financës në Akademinë e Sigurisë ka likuiduar vlerën e faturës elektronike të hartuar nga ana e subjektit S., të pranuar nga personi përgjegjës që administron sistemin e faturave elektronike, në Akademinë e Sigurisë, fletë hyrjen mujore të hartuar nga ana e magazinierit të Akademisë së Sigurisë dhe proces verbalin e hartuar nga ana e komisionit të pritjes dhe kolaudimit të mallrave të ngritur në Akademinë e Sigurisë.

Shpërndarja e ushqimit apo trajtimi i punonjësve të Policisë së Shtetit me ushqim pa pagese është një proces tjetër dhe nuk ka lidhje me marrëveshjen kuadër apo kontratën e lidhur midis subjektit S. dhe Akademisë së Sigurisë, ky proces bazohet në VKM me nr. 189, date 15.03.2017. Gjithashtu ju informojmë se, në Akademinë e Sigurisë trajnohen punonjës policie nga të gjitha njësitë shpenzuese të Policisë së Shtetit dhe bazuar në VKM me nr. 189, date 15.03.2017, për ditët që janë në trajnim Akademia e Sigurisë u shpërndan ushqim pa pagese, pavarësisht vendit se ku do të zhvillohet trajnimi, ky veprim nuk nënkupton se të gjitha këto njësi shpenzuese kanë marrëdhënie kontraktuale me OE S., të gjitha veprimet që kryen subjekti S. me këto njësi shpenzuese janë gjithmonë për llogari të Institucionit të Akademisë së Sigurisë si autoritet kontraktor.

Në përfundim mendojmë se në asnjë rast nga ana e Autoritetit Kontraktor Akademia e Sigurisë nuk janë shkelur kushtet e marrëveshjes kuadër me nr. 150/6, date 19.08.2022, pra nuk kanë ndryshuar sasi të racioneve, çmimi për njësi si dhe tejkallimi i vlerës së kontratës. Gjithashtu nuk është shkelur asnjë nga nenet e kontratës me nr. 1752, date 26.08.2022, çdo lloj marrëdhënie është kryer vetëm midis OE S. dhe institucionit Akademia e Sigurisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor. Për sa i përket masës për shpërbllim demi në shumën prej 1,704,864 leke, mendojmë se kjo shumë vërtete i është bërë dalje njësisë shpenzuese Instituti Përgatitjes së Qeneve të Policisë, por ky veprim është kryer pasi malli është bërë hyrje në magazinat e Akademisë së Sigurisë sipas dokumenteve të lartpërmendura. Në asnjë rast nuk ka diferencë midis sasisë së bërë hyrje në magazinën e Akademisë së Sigurisë dhe faturave të subjektit S., gjithashtu të gjitha këto sasi të furnizuara janë shpërndarë sipas kërkesave të VKM me nr. 189, date 15.03.2017, të shoqëruara me të gjithë dokumentacionin financiar ligjor.

Me detyrimin për të zbatuar autorizimin e lëshuar nga DPPSH nr.5163/1, date 28.12.2022 është kërkuar gjithashtu, që dokumentimi i procesit të bëhet në zbatim të Udhëzimit nr.30, date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikës 5.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Marrëveshja kuadër nr.150/6 prot, datë 19.8.2022 lidhur ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara si organ qendror blerës dhe operatorit ekonomik "S." SH.P.K

përcakton kushtet dhe rregullat për kryerjen e shërbimit me objekt: **“Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Akademinë e Sigurisë. Autoriteti kontraktor në emër dhe për llogari të të cilit është lidhur marrëveshja kuadër është Akademia e Sigurisë.**

Bazuar në neni 60 pika 2 të VKM-në nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, përcaktohet se: *“Në njoftimin e procedurës së prokurimit duhet të përcaktohen të gjitha autoritetet/entet kontraktore përfituese. Nuk mund të bëhen pjesë e një marrëveshje kuadër autoritetet/entet kontraktore, të cilat nuk janë palë e marrëveshjes kuadër që në publikimin e saj.”*

Përmes kontratës së shërbimit nr.1752 prot, datë 26.8.2022, operatori ekonomik i shpallur fitues (S.-AL SH.P.K) nga procedura e prokurimit, e zhvilluar nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, ka marrë përsipër për të kryer shërbimin në favor dhe për llogari të Akademisë sipas kushteve të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit.

Palët kontraktuese të kontratës janë Akademia e Sigurisë në cilësinë e porositësit të shërbimit dhe shoqëria “S.” në cilësinë e kontraktuesit/furnizuesit. Instituti i përgatitjes së qenve të policisë jo vetëm që nuk është palë në këtë kontratë por nuk ka asnjë dispozitë të kontratës që të parashikojë përfaqësimin e interesave/kërkesave të Institutit për përfitimin nga ky shërbim përmes Akademisë së Sigurisë.

Siç është trajtuar dhe në material, Autorizimi për furnizim është bërë pas një memo të datës 15.12.2022 nr. Prot 6774, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nga Drejtori i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin me lëndën “Mbi furnizimin me ushqim të kursantëve në Institutin e përgatitjes së qeneve të policisë” ku është kërkuar: Instituti i Përgatitjes së Qenve të Policisë në zbatim të detyrave funksionale për përgatitjen e qenëve të Policisë së Shtetit, zhvillon çdo vit program mësimor me kursantet që merren me përgatitjen e qenëve të miratuara nga Akademia e Sigurisë, program i cili korrespondon në të njëjtën kohë me programin vjetor të studenteve dhe kursanteve në Akademia e Sigurisë. Për shkak të dështimit të procedurës së prokurimit nga ky institucion varësie për të cilin çdo vit e ka prokuruar vetë këtë shërbim, është kërkuar përfshirja e kursantëve të kësaj qendre për trajtim ushqimor nga Kontrata e lidhur me S. AL dhe Akademisë së Sigurisë.

Sa më sipër nuk jemi në kushtet e trajtuara sipas observimit tuaj.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion gjatë auditimit në terren kjo sasi merrej në dorëzim nga vetë Instituti dhe fletë hyrje dhe dalje firmoseshin nga Instituti i Përgatitjes së Qenve të Policisë ku kjo më pas përfshihej në vlerën totale mujore të rakordimeve të Akademisë së Sigurisë dhe S. AL.

Pra, Akt rakordimi është bërë nga IPQPSH kundër firmosur nga OE dhe ka të bashkëlidhur vetëm fletë dalje mujore dhe jo fletë dalje ditore provizore, si dhe mungojnë procesverbalet e marrjes në dorëzim të ushqimit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Për sa më sipër, ofrimi shërbimit ndaj Institutit të përgatitjes së qenve të policisë përmes Akademisë konsiderohet shkelje e objektit të kësaj kontrate si dhe kushteve të Marrëveshjes Kuadër, pasi Akademia e Sigurisë është përfitues i vetëm i kontratës në cilësinë e Autoritetit Kontraktor ose porositësit të shërbimit.

Referuar dokumentacionit të administruar pagesa e bërë për shpenzimet e kateringut në shumën prej 1,704,864 lekë pa TVSh, për Institutin e përgatitjes së qenve të policisë, është vlerë e cila nuk është kontraktuar dhe realizuar një procedurë kontraktimi si dhe është jashtë parashikimeve të kushteve të kontratës dhe vlerave të parashikuara në marrëveshjen kuadër.

Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenin 122 e vijues të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” Kreu XV “Zbatimi i kontratës”, nenet 64 pika 2, dhe 107 pika 7 të VKM-së

nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Marrëveshjen kuadër nr.150/6 prot, datë 19.8.2022, si dhe kontratën e shërbimit nr.1752 prot, datë 26.8.2022.

Sa më sipër observimi nuk merret në konsideratë.

2.4 Auditimi i llogarive vjetore.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë

1. Formati 1: Pasqyra e pozicionit financiar;
2. Formati 2: Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
3. Formati 3: Pasqyra e flukseve monetare;
4. Formati 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto;
5. Formati 5: Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
6. Formati 6: Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
7. Formati 7: Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto (si dhe regjistri i aktiveve);
8. Formati 8: Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

a. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022 “*Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*”.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përpunueshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, me Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Rezulton se, veprimet kontabël janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga Akademia e Sigurisë, situacione këto të rakorduar me degën e Thesarit.

PF është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore. Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

- për vitin 2022 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 496, datë 23.02.2023, “Dërgimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2023” për Akademinë e Sigurisë, duke respektuar afatet ligjore.00

- për vitin 2023 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 511, datë 16.02.2024, “Dërgimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2023” për Akademinë e Sigurisë, duke respektuar afatet ligjore.

Sa sipër ka gjetur zbatim paragrafi 117, i Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, që përcakton se;

“Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit”.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

b. Saktësia dhe rregullueshmëria e pasqyrave financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara ***Auditimi i llogarive performancës financiare***

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konfirmo rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Totali i ardhurave të funksionimit në “Pasqyrën e Përformancës” është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2).

Për vitin 2023 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 382,258 mijë lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 375,175 mijë lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 7,083 mijë lekë

Totali ii + iii = 0 lekë

Nga auditimi i zërave të shpenzimeve rezulton se në Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës” është pasqyruar dhe reflektuar ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën prej (1,138,855) lekë, veprime në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika “Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve.

Aktivitet qarkulluese

Aktivitet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

- Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”: Sipas UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, Pika 49:

Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitorë të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

Pasqyrimi në vlerën 1,461,310 lekë përfaqëson diferencën e mbetur pa u përdorur nga fondet e Qeverisë Holandeze dhënë Akademisë së Sigurisë për zbatimin e një projekti qysh prej vitit 2014, në shumën 171,077 lekë, dhe shumën prej 1,290,233 lekë, e cila përfaqëson vlerën e pa shpenzuar të projektit “*Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile*”, financuar nga AKKSHI sipas kontratës me nr. 808, datë 22.09.2021.

Klasa 3 “Gjendja e inventarit”, në fund të vitit 2023, rezulton në vlerën prej (1,138,855) lekë. Në krahasim me vitin 2022 peshën më të madhe e zë rritja e zërit “Materiale”, diferenca e cila është pasqyruar në llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”.

Pasqyrimi në pozicionin financiar i të drejtave dhe detyrimeve.

*** Situata e Detyrimeve të Prapambetura:**

- Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve ku nga AS është paraqitur në vlerën zero lekë.

Nga auditimi u konstatua se AS ka detyrime të papaguara ndaj një punonji në lidhje me vendimet e proceseve gjyqësore të fituara ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së

- Vendimi me nr. 254 datë 14.05.2019 i Gjykatës së Shkallës Pare Gjirokastrë Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ti njohë paditësi S. R. gradën policore Drejtues i 1 nga data 27.12.2007 e në vazhdim. ku deri momentin e auditimit në terren kreditori nuk i është rikthyer grada e fituar sipas vendimit gjyqësorë. Nga databaza e Drejtorisë së Policisë rezulton se shuma e përlllogaritur si detyrim deri në momentin e daljes së vendimit të gjykatë është në vlerën 14,407,030 lekë.

Kjo shumë është detyrim i cili nga Akademia e Sigurisë duhet të ishte njohur që në momentin e marrjes së vendimit gjyqësor.

Deri me datën 31.12.2023 nga AS është paguar vlera e pagës neto prej 8,990,951 lekë.

Konstatim:

Nga AS vlera prej 5,416,079 lekë e kreditorit S. R. nuk është njohur si shpenzime të periudhës ushtrimore për vitin 2023, si dhe nga AS referuar Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 37, datë 06.10.2020 “*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*” dhe në zbatim të udhëzimit plotësues “*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023*” me nr.2, datë 19.01.2023, pika 126.1 germa b nuk është raportuar si detyrim i prapambetur, si dhe plani i shlyerjes së tij.

Sa më sipër konstatohet se, vendimet e proceseve gjyqësore nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer. Si rrjedhojë ky detyrim nuk është njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por është njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim

me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

Sa më sipër, shumat e vendimeve gjyqësore duhet të ishte reflektuar në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

*** Llogari të arkëtueshme:**

- Llogaritë 423-429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*” në vlerën 2,767,765 lekë, përbëhet nga detyrimet e:

- Tridhjetë e dy ish-punonjësve të Akademisë së Sigurisë në vlerën prej 1,155,205 lekë, e cila është evidentuar në kontabilitet nga vitet 1996 deri në 2010.

- Katër firmave private për shumën 959,405 lekë, të cilat kanë furnizuar institucionin me mallra dhe materiale dhe kryerje shërbimesh, veprime të ndodhura para vitit 1996 për vlerën 763,405 lekë dhe një subjekt në vlerën 196,000 lekë e krijuar në 2010, ku nga institucioni i është kërkuar Drejtorisë së Tatimeve si dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR-së), për shlyerje por këto firma kanë falimentuar me kohë.

- Gjashtë ish-punonjës të Akademisë së Sigurisë në vlerën 653,155 lekë, nga të cilët për 5 persona në vlerën 13,155 lekë të krijuara në vitin 2016, të cilët janë pa shpresë arkëtimi për arsye të largimit nga jeta dhe daljes në pension dhe vlera prej 640,000 lekë e cila ka të bëjë me një gjobë nga audit i Brendshëm i Drejtorisë së Policisë ndaj një punonjësi.

Konstatim:

Llogaritë 423-429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*” për vlerën 972,560 lekë, e cila ka të bëjë me vlerën e debitorëve të trashëguar nga vitet 1996-2010 dhe për vlerën 13,155 lekë të krijuara në vitin 2016, u konstatua se nga AS është bërë identifikimi i të gjithë debitorëve (si ata fizike dhe ish-punonjës edhe subjekte juridike) sipas vjetërsisë dhe u janë dërguar disa herë shkresa zyrtare personave fizike si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Nga ana Institucionit për debitorët ish-punonjës nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e detyrimit, si rrjedhojë ky detyrim është i paarkëtueshëm, pasi ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në nenin 203 pika 1 Kodi i Punës “Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet”, si dhe neni 115 Kodit Civil “Parashkruhen brenda afateve prej dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë”.

- Në lidhje me detyrimet ndaj personave fizike dhe subjekteve juridike, të krijuat para vitit 2010 bazuar në Kodin Civil, neni 114 “Afatet e parashkrimit” ku citon se “Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë” dhe neni 121 “Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës” ky detyrim është i parashkuar.

- Llogaria 4342 “*Të tjera operacione me shtetit debitor*” paraqitet në vlerën 30,494,806 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka Akademia e Sigurisë ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2023, përkatësisht për pagat, për tatim taksa, për sigurime shoqërore dhe sigurime shëndetësore në vlerën 20,855,536 lekë, si dhe vlera e faturave të shpenzimeve të konstatuara në dhjetor, të cilat paguhen në janar 2024, në vlerën 9,639,270 lekë, e cila ka të bëjë me detyrimin ndaj subjektit privat S.

ShPK për faturën me nr.11/2024, datë 05.01.2024, e cila përfaqëson vlerën e shërbimit të ushqimit kateringë të furnizuar për muajin Dhjetor 2023.

Aktivitet afatgjatë

Në formatin nr. 1 “Aktivitet e Afatgjatë” në vlerën neto prej 941,130 mijë lekë, janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë, “Aktive Afatgjatë jo materiale” në vlerën neto 15 mijë lekë dhe “Aktive Afatgjatë materiale” në vlerën neto 941,115 mijë lekë.

- Llogaria 203 “Koncesione, Patenta, Licenca e te ngjashme” paraqitet në fund të vitit në vlerën neto prej 15,017 lekë, e cila ka të bëjë me vlerën neto të programit “Financa 5” të instaluar në këtë institucion që nga viti 2006.

Konstatim:

- Vlera bruto prej 150,000 lekë për “Financa 5”, e cila është klasifikuar në 203 “Koncesione, Patenta, Licenca e te ngjashme”, vlerë e cila ka të bëjë me aktive afatgjatë, duhet të ishte klasifikuar në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune” ku amortizimi në vite nga institucioni edhe pse është klasifikuar në llogarinë 203 është llogaritur me normën 25 % dhe jo 15%, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Klasa 2 ‘Aktive afatgjatë’ dhe pika 36 “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjatë”, me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit.

- Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën neto prej 183,110,967 lekë, për sipërfaqe trualli 12,911.50 m2 nën objekt dhe 16,113 m2 sipërfaqe rruge dhe sheshe.

- Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione” paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën neto prej 525,189,877 lekë. Në mënyrë analitike paraqitet si mëposhtë:

Nr	Emërtimi i Objektivit	Viti	Shuma	Amortizimi	Shuma
		ndërtimit		llogaritur	neto
1	Vend Roja	2012	11,479,845	3,447,788	8,032,057
2	Administrata	1940	18,450,975	7,045,329	11,405,646
3	Blloku Mencë Gazhinë	1989	58,129,606	23,509,732	34,619,874
4	Korpusi Mësimor nr.1	1975	69,933,162	26,349,726	43,583,436
5	Fjetina 5-kateshe	1988	74,736,148	27,528,276	47,207,872
6	Fjetina 3- kateshe	1980	71,368,241	24,199,312	47,168,929
7	Kaldaje + Lavanteri	1980	5,416,955	2,058,253	3,358,702
8	Poligoni Qitjes	2012	57,125,459	17,132,706	39,992,753
9	Blloku I Magazinave	2012	26,525,431	7,923,733	18,601,698
10	Qendra Shëndetësore	2012	31,611,210	9,502,990	22,108,220
11	Postbllok + muri rrethues	1989	4,506,300	1,654,236	2,852,064
12	Hoteli Oficerave Madhore	2015	61,439,932	17,162,798	44,277,134
13	Shtëpia e Miqve	2015	61,485,742	17,165,944	44,319,798
14	Magazine Palestër	2015	12,478,175	4,111,386	8,366,789
15	Fusha Sportive	2015	87,623,424	24,399,607	63,223,817
16	Blloku Trajnimit	2015	93,841,592	26,220,944	67,620,648
17	Shtëpia Taktike	2015	16,454,997	4,581,578	11,873,419
18	Depo Uji	2015	8,327,621	2,321,758	6,005,863
19	Kabina Elektrike	2015	805,925	234,767	571,158
	Totali		771,740,740	246,550,863	525,189,877

Burimi: Akademia e Sigurisë

Konstatim:

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se;

Nga Akademia e Sigurisë është kryer pagesa me urdhër shpenzimin nr. 287, datë 21.12.2023 ndaj OE "U." shpk për realizimin e rikonstruksionit të tarracës së një nga godinave në pronësi të Akademisë së Sigurisë në vlerën 490,147 lekë.

Situacioni i punimeve të realizuar nga OE është në vlerën 544,608 lekë me TVSh, konfirmuar me faturën tatimore me nr. 27/2023, datë 08.12.2023.

Nga AS është mbajtur vlere prej 54,461 lekë si fond garancie në vlerën prej 10 % për të cilën nuk është bërë regjistrimi në kontabilitet në llogarinë 466 "Kreditore për mjete në ruajtje" dhe nuk është deklaruar as në thesar si fond garancie, vlerë e cila do të zhbllkohet në favor të kontraktuesit pas përfundimit të periudhës së Garancisë së Defekteve (365 ditë kalendarike pas Kolaudimit të objektit).

Nga auditimi u konstatua se nga AS është prokuruar dhe Mbikëqyrja dhe Kolaudimi i punimeve të tarracës së godinës së AS, ku është lidhur kontrata me nr. 2702, datë 05.12.2023 për mbikëqyrjen e punimeve me objekti "*Izolim tarracë në godinën e AS*" me OE "G ." shpk në vlerën prej 8,100 lekë dhe kontrata me nr. 2791, datë 14.12.2023 për kolaudimin e punimeve me objekti "Izolim tarracë në godinën e AS" me OE "H. c." në vlerën 1020 lekë.

Me datën 23.06.2022 në prani të Mbikëqyrësit të OE "G." si dhe Sipërmarrësi i punimeve Shoqëria "U." shpk përfaqësuar nga Drejtuesi Teknik është mbajtur proces- verbal për vërtetimin e datës së përfundimit të punimeve të kontratës, ku ka konfirmuar se ato janë konform kushteve të kontratës. Data e përfundimit të punimeve sipas kontratës është **19.12.2023**. Data e përfundimit të punimeve **faktike është 07.12.2023**, dorëzuar fatura tatimore me nr. 94/2023 datë 12.12.2023 në vlerën prej 9,720 lekë.

Akt i kolaudimit është mbajtur me datën 14.12.2023 nga kalaudatori, i cili e ka kolauduar punimet e objektit brenda dite. Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se janë planifikuar/realizuar si shpenzime "Izolim tarracë në godinën e AS"; Mbikëqyrja dhe Kolaudimi i punimeve të saj, vlere e të cilave duhet të ishte planifikuar në zërin e investime kapitale dhe të kontabilizoheshin si rritje e vlerës së aktivitetit, referuar Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" pika 1 ku citohet se .." Mbikëqyrja e punimeve bëhet për çdo projekt dhe ka për qëllim kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh dhe anën ekonomike të tij" dhe pika 2 " ...Vlere e kërkuar nga subjekti konkurrues për mbikëqyrjen, duhet të përfshihet në tarifat e përcaktuara në përputhje me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", si dhe Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë së qeverisjes së përgjithshme" Klasa 2 "Aktivet Afatgjata".

- Llogaria 213 "Ruge, rrjete, vepra ujore", paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën neto prej 60,699,070 lekë. Gjatë vitit nuk ka pësuar ndryshime.

Konstatim:

Nga auditimi i zërave të regjistruar në llogarinë 213 u konstatua se: Nga Akademia e Sigurisë është regjistruar vlere e "truallit/tokës" së këtyre shesheve dhe rrugëve, e cila është rivlerësuar sipas VKM-së me nr. 514, datë 30.7.2014 "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin Qark të Republikës së Shqipërisë" në vlerën 52,898,979 lekë.

Keq klasifikimi i regjistrimit kontabël ka bërë të mundur mbivlerësimin e llogarisë 213 "Ruge,

rrjete, vepra ujore”, si dhe nënvlerësimin e llogarisë 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në shumën bruto prej 52,898,979 lekë, ku amortizimi në vite është llogaritur me normën 20%, me ndikim negativ në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit, pasi për zërin truall/tokë nuk llogaritet amortizim.

Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar.

- Llogaria 214 “Instalime, Teknike makineri, pajisje”, paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën neto prej 60,699,070 lekë, e cila ka pësuar ndryshime gjatë vitit nga:

- Blerje “Lavatrice profesionale” në vlerën 928,800 lekë, bërë hyrje më fletë hyrjen nr. 90, date 04.12.2023. bashkëlidhur është procesverbali i marrjes në dorëzim mbajtur me datën 04.12.2023 dhe fatura tatimore me nr. 68/2023, datë 24.11.2023.

- Shtesë nga regjistrimet e Armatimeve bazuar në Urdhrin e Ministrit të Brendshëm me nr. 1484, datë 23.10.2023 “Për menaxhimin me çmime të aktiveve të shërbimit të armatimeve dhe pajisjeve speciale nga njësia shpenzuese të policisë së shtetit dhe administrimi i dokumentacionit”, ku qëllimi i urdhrin është menaxhimi me çmimet të aktiveve të shërbimit të armatimeve dhe pajisjeve speciale, administrimin e dokumentacionit dhe përfshirjes së tyre në bilancin kontabël të Policisë së Shtetit.

Nga Drejtoria e përgjithshme e Policisë së Shtetit është dërguar shkresa nr. 4023, datë 18.12.2023 të gjitha njësite shpenzuese për zbatim të urdhrin të MB, ku bashkëlidhur janë dërguar dhe çmimet e këtyre aktiveve.

Nga Akademia e Sigurisë është bërë vlerësimi i sasisë gjendje të këtyre aktiveve duke i vënë çmimin e referencës dërguar nga Policia e Shtetit ku ka rezultuar:

Pajisje Optike në vlerën 185,000 lekë; Pajisje Speciale në vlerën 16,864,791 lekë; Armatime në vlerën 28,760,505 lekë, në total në shumën prej 45,810,296 lekë.

Konstatim:

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se në kontabilitet nuk është pasqyruar vlera e “Poligoni Stazz” e vlerësuar sipas çmimeve të dërguar nga MB në vlerën totale 11,354,304 lekë. Mospasqyrimi i tyre në kontabilitet është veprim në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm me nr. 1484, datë 23.10.2023, si dhe me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar, Klasa 2 ‘Aktive afatgjata’, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrave financiare, si dhe me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit.

Vlera prej 4,813,883 lekë, e cila ka të bëjë me vlerën e “Municioneve” është regjistruar në llogarinë 312 “Materiale”.

- Pakësuar me vlerën 264,028 lekë nga nxjerrja jashtë përdorimi të aktiveve.

Konstatim:

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se

Me urdhër shpenzimin nr. 209 datë 23.01.2022 nga AS është bërë blerje blerja e tre bolierëve në shumën 46,776 lekë, sipas urdhër prokurimit me nr. 32 datë 07.11.2022 dhe faturës tatimore të lëshuar nga OE me nr. 29/2022 datë 13.11.2022.

Nga auditimi u konstatua se shuma prej 46,776 lekë nga AS është regjistruar si shpenzim i periudhës 2022 në llogarinë 602 dhe nuk është bërë hyrje si aktiv në llogarinë 214 “Instalime, Teknike makineri, pajisje”, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018

“Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Klasa 2 ‘Aktive afatgjata’, me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit.

- Llogaria 215 “Mjete Transporti” paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën neto prej 5,690,366 lekë. Gjatë vitit ka pësuar ndryshime, nga dalja jashtë përdorimi të tre automjeteve, përkatësisht të dy automjeteve Ford Mercedez në vlerën 3,073,086 lekë dhe një Furgon Policie në vlerën 3,600,000 lekë. Në total ne koston historike në vlerën 9,746,172 lekë.

Bazuar në urdhrin e Ministrit të Brendshëm me nr. 159, datë 24.10.2023 “Për nxjerrjen nga përdorimi të mjeteve të transportit dhe aktiveve të tjera”, në të cilën është bërë miratimi i nxjerrjes jashtë përdorimi të mjeteve të transportit e aktiveve të tjera, në inventar të strukturave vartëse të MB, sipas Vendimit të komisionit të nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi datë 13.10.2023 dhe tabelës përmbledhëse me të dhënat përkatëse.

Me Urdhrin e Rektorit nr. 444 , datë 13.11.2023 është ngritur Komisioni i tjetërsimit dhe asgjësimit të mjeteve të miratuara jashtë përdorimi.

Nga komisioni është mbajtur relacioni i asgjësimit me nr. 2524/4, datë 30.11.2023 dhe procesverbali 1, datë 30.11.2023, ku është cituar se komisioni asgjësoi/transformoi me defomim, copëtim e thyerje në prani të gjithë komisionit mbetjet plastike e të tjera në masën 1464 kg. Gomat i janë kaluar poligonit të qitjes për tu përdorur si barriera në muret anësore. Ndërsa sasia prej 4241 kg është bërë gati për skrap, kur të realizohet ankandi nga QFMT.

Me fletë daljen nr. 79, datë 15.11.2013 është bërë dalje nga kontabiliteti i vlerës se tre mjeteve.

- Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën neto prej 27,821,501 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit si rezultat;

Kalim pa pagesë nga QFMT tek Akademia e Sigurisë së pajisjeve:

- 6 Karrige rrotullues bërë hyrje me Fletë hyrjen nr. 4, datë 21.02.2023 në shumën prej 82,800 lekë.

- poltron rrotullues bërë hyrje me Fletë hyrjen nr. 5, datë 31.03.2023 në shumën prej 19,440 lekë.

- kasaforte sekrete bërë hyrje me Fletë hyrjen nr. 8, datë 08.05.2023 në shumën prej 45,600 lekë.

- 20 Kompjuterë Desktop Dell bërë hyrje me Fletë hyrjen nr. 55, datë 27.10.2023 në shumën prej 2,383,200 lekë.

Na u vu në dispozicion vetëm autorizimi i tërheqjes së mallit nga magazinierja.

Konstatim:

Nga auditimi i procesit të kalimit të aktiveve, u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur miratimin për kalim kapitali, autorizimi i tërheqjes së aktivitetit, procesverbali i marrjes në dorëzim, (urdhri i dorëzimit të malli mes palëve), kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga institucioni që ka bërë kalim kapitali, deri në momentin e daljes nga pronësi, ku vlera e këtyre aktiveve të transferuara janë regjistruar me vlerën historike nga institucionet përfituese, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës reale të aktiveve neto.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, në kapitullin III të udhëzimit “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”. Mungesa e dokumentacioneve shoqëruese le të hapur ciklin e transferimit të kapitalit nga një institucion në tjetrin.

- Tre krevate portativ të marrë nga Kryqi i Kuq bërë hyrje me fletë hyrjen nr. 40, datë 27.06.2023. Kalimi ka të bashkëlidhur aktin e dhurimit nga Kryqi i Kuq datë 20.04.2023 ku janë cituar 4 kravate, protokolluar në Akademinë e Sigurisë me nr. 1061, datë 04.05.2023, dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim me nr. 1061/2, datë 08.05.2023 nga komisioni i ngritur nga Rektori me nr. 1061/1, datë 08.05.2023.

Në procesverbal është cituar se janë marrë në dorëzim 3 copë ku është përcaktuar dhe vlera prej 4000 lekë/copa. Bashkëlidhur mungon gjurma e argumentimit të vlerës së përcaktuar për copë, si dhe procesverbali i marrjes në dorëzim nga palët, pasi ka mospërputhje të sasisë së dhuruar me atë të marrë në dorëzim.

- Gjatë vitit kemi pakësime në vlerën 1,879,708 si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve realizuara gjatë vitit 2023.

Konstatim:

Nga auditimi analitik i llogarive 214 “Instalime, Teknike makineri, pajisje” dhe 218 “Inventar ekonomik”, u konstatua se:

Në vitin 2021 është bërë vlerësimi i aktiveve për jashtë përdorimi për llogarinë 214 në vlerën 264,028 dhe për llogarinë 218 në vlerën 1,879,808.

Në vitin 2022 dhe në vitin 2023 janë vlerësuar po të njëjtat aktive për dalje jashtë përdorimi, ku nga institucioni këto aktive janë mbajtur në kontabilitet si aktive në përdorim duke llogaritur amortizimin për vitet 2022 dhe 2023.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 103-109. Aktivët kalojnë në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”, pasi ato janë vlerësuar për jashtë përdorimi dhe deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre mbahen nga institucioni duke bërë daljen nga Inventari i institucionit dhe mbajtjen e tyre në magazinë me një flete hyrje rikupero.

Për vitin 2022, në formatin nr. 7/a “Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” (me koston historike) duhet të ishin reflektuar këto aktive si nxjerrje jashtë përdorimi, duke debituar llogarinë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” në vlerën neto. por pa ndikim në rezultatin financiar të vitit 2022.

Mbajtja e tyre në kontabilitet ka ndikuar në fondin neto të institucionit, pasi për këto aktive është përlllogaritur amortizimi vjetor për vitin 2021-2023, të cilat ato kanë qenë të vlerësuar për jashtë përdorimi, sipas metodës së përcaktuar në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 103.

Nga auditimi i llogaritjes së amortizimit dhe vlerës neto të aktiveve të pasqyruara në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” për vitin 2023 u konstatua se për vitin 2023, për llogarinë 218 “inventar ekonomik” është përlllogaritur amortizim vjetor negative si dhe vlera neto e njëzet e katër aktiveve në kontabilitet janë pasqyruar në vlerë negative në shumë prej -257,867 lekë vlerë e cila është zbritur nga gjendja e aktiveve, duke ndikuar dhe në pasqyrimin jo real të gjendjes së tyre në kontabilitet dhe pasqyrim jo të drejtë të **ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto.**

Ky veprim kontabël është bërë dhe për vitin 2022, ku për njëzet e katër aktiveve në kontabilitet janë pasqyruar në vlerë negative në shumë prej -323,176 lekë.

Veprimi mësipërm është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”. Klasa 2 “Aktivët Afatgjata”, **me ndikim material në fondet neto të institucionit.**

Gjithashtu u konstatua se për të gjithë pajisjet të cilat janë bërë hyrje në vitin 2022 dhe 2023 nuk është përlllogaritur amortizimi vjetor përkatësisht për vitin në të cilën është bërë marrja në dorëzim e aktivitetit (duke e përlllogaritur atë për ditët që është bërë hyrje në atë vit), por janë pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar me koston historike.

Konstatim:

- Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se një pjesë e “*pajisjeve elektronike*” janë klasifikuar në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe jo në llogarinë 218600 “*pajisje elektronike*”, ku amortizimi në vite është llogaritur me normën 20 % dhe jo 25%, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar, Klasa 2 ‘Aktive afatgjata’ dhe pika 36 “*Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata*”, me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit.

Konstatim:

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se

Me urdhër shpenzimin nr. 250, datë 19.12.2022 nga AS është bërë blerje materiale për riparimin e pajisjeve zyra në vlerën 88,800 lekë.

Nga analiza e zërave të bërë hyrje u konstatua se janë bërë blerje 20 copë tastiera me USB në vlerën 13,440 lekë dhe një copë USB DVD në vlerën 2560 lekë, për të cilat janë bërë regjistrimi i tyre si mall konsumi dhe jo si aktive afatgjata, veprime në kundërshtim me Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar, Klasa 2 ‘Aktive afatgjata’, me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit.

Pasivet Afatshkurtra

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2023, konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasive afatshkurtra në vlerën 1,025,725 mijë lekë.

- Llogaria 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 9,639,270 lekë, përfaqëson detyrimin ndaj subjektit privat S. shpk për faturën me nr.11/2024, datë 05.01.2024, e cila ka të bëjë me shërbimin e ushqimit catering të furnizuar për muajin Dhjetor 2023.

- Llogaria 42 “Personeli dhe llogari të lidhur me to” në vlerën 14,691,345 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2023, që paguhen në Janar të vitit 2024.

- Llogaria 431 “Personeli dhe llogari të lidhur me to” në vlerën 1,461,829 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2023, të cilat paguhen në Janar të vitit 2024.

- Llogaria 435 & 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror në shumën prej 4,193,361 lekë dhe e sigurimit shëndetësor në shumën 509,001lekë të muajit Dhjetor 2023, të cilat paguhen në muajin Janar 2024.

- Llogaria 4341 “Te tjera operacione me shtetin (kreditor)” në shumën prej 2,767,765 lekë përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa-arkëtuara nga vitet e mëparshme. Kjo llogari përbëhet nga saldo debitorë të llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”.

- Llogaria 475 “Te ardhura për t’u regjistruar vitet pasardhëse” në shumën prej 1,461,310 lekë, vlerë e cila është debituar në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar”.

Konstatim:

Llogaria 475 “Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhëse”. është llogarive rregulluese, ku në të, evidentohen të ardhurat që janë arkëtuar përpara ngjarjes ose veprimit që krijon të ardhura.

Nga auditimi u konstatua se ngjarjet dhe veprimi për të cilën janë arkëtuar është realizuar, për fondet e Qeverisë Holandeze dhënë Akademisë së Sigurisë për zbatimin e një projekti qysh prej vitit 2014, të cilat janë përdorur në vitin 2023 për blerje “Lavatriçe profesionale” në vlerën 928,800 lekë të trashëguara nga vitit 2022, ku vlera e mbetur prej ne shumen 171,077 lekë, duhet të ishte

kredituar në llogarinë 101 “Fondet e veta”.

Ndërsa vlera prej 1,290,233 lekë, e cila përfaqëson vlerën e pa shpenzuar të projektit “*Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile*”, financuar nga AKKSHI sipas kontratës me nr. 808, datë 22.09.2021, të mbahet në këtë llogari deri në momentin e finalizimit të likuidimit ndaj persona përfitues të projektit.

Konstatim:

-Nga auditimi i pasqyrës së formatit nr. 3 “cash-flow” u konstatua se pasqyra nuk është plotësuar në përputhje me shpenzimet dhe të ardhurat e realizuara gjatë vitit, por pa ndikim material në rezultatin e institucionit.

Në zërin “*Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime korente (+)*” është vënë vlera prej 306,640,170 lekë, ndërsa sipas rakordimit me thesarin kjo shumë është në vlerën 372,784,845 lekë.

Gjatë vitit nga institucioni është bërë blerje aktivesh në vlerën 928,800 lekë nga të ardhurat e trashëguara, ku në pasqyrën e “cash flow” është regjistruar si shpenzim korrent dhe jo në zërin “*Për detyrime e Investime të viti ushtrimor(-)*”.

Gjithashtu dhe zëri “*Rritja /Rënia neto e Mjeteve monetare*” në pasqyrën e cash flow është paraqitur në vlerën 695,243,083 lekë, ku kjo vlerë duhet të ishte pasqyruar në vlerën (928,800) lekë, me qëllim që shuma e IV+V= VI, vlerë e cila paraqitet në llogarinë 520 “Disponibilitete ne Thesar” të pasqyrës së pozicionit financiar.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, paragrafi 3.5 “*Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetare*”.

c) Inventarizimi i pronës shtetërore , nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Nga auditimi u konstatua se AS ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, neni 26 ku citohet: “*Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...*” dhe neni 31, citohet “*...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit ne m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...*”.

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2021-2023.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi, është realizuar procesi i inventarizimit për vitin 2021; 2022 dhe 2023, sipas përcaktimeve në Paragrafin nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar që sanksionin se:

“*Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave,*

Hyrja e aktiveve në përgjithësi është dokumentuar me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*". Dalja e aktiveve në përgjithësi është realizuar konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*".

Inventarizimi fizik

Në urdhrin e Rektorit çdo vit është ngritur komisioni i inventarizimit "*Mbi inventarizimin e aktiveve fizike*".

Nga auditimi i procesit të inventarizimit u konstatua se:

Procesi i inventarizimit të aktiveve është kryer nga komisioni i ngritur sipas urdhrin të Rektorit çdo vit "*Mbi inventarizimin e aktiveve fizike*, me nr. 496, datë 08.11.2022 dhe me nr. 408, datë 06.10.2023 ku me përbërje të komisioneve ishte si anëtar/kryetar shefi i sektorit të financës dhe në rolin e kryetarit të komisionit të inventarizimit qendror të inventarizimit ishte Administratori i Akademisë së Sigurisë.

Konstatim:

Përfshirja e shefit të sektorit të financës dhe Administratorit të Akademisë së Sigurisë në komisionin e inventarizimit të aktiveve dhe materialeve të institucionit është veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 82 ku citohet se "*Komisioni nuk duhet të jete më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/ përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi „,*" si dhe ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 22 "*veprimtaria e kontrollit*" pika 3. b "*ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin*".

Nga komisioni i inventarizimit është mbajtur procesverbali, ku është fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljes nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, ditën kur është filluar inventarizimi fizik i aktiveve sipas përcaktimit të paragrafit 83, të UMFE nr. 30/2011, i ndryshuar, ku citon "*Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe behet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja behet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material*".

Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrit kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë, sipas përcaktimeve të paragrafit nr. 26, të Udhëzimit të MFE me nr. 30/2011. Në dosje janë depozituar kartelat/ fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkuara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

Në fund të procesit të inventarizimit, nga komisioni është përgatitur informacion përmbledhës mbi inventarizimin,

Për inventarizimin e vitit 2023 relacioni i përfundimit të inventarizimit është mbajtur me nr. 397, datë 07.02.2024 "*Për realizimin e procesit të inventarizimit*".

Ndërsa me shkresën e dërguar me nr. 4003, datë 03.10.2023 nga Departamenti për Shërbimet Mbështetëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, ku është kërkuar që në zbatim të Ligjit

nr.10296 date 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30 date 27.12.2011 "Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 664, datë 10.09.2015 "Për përcaktimin e përgjegjësiave në menaxhimin e aktiveve, krijimin e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, nxjerrjes nga përdorimi sipas kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, Njësite Shpenzuese të varësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, kanë detyrimin ligjor të realizojnë procesin e inventarizimit dhe të vlerësimit të aktiveve në periudhën Tetor-Dhjetor të çdo viti buxhetor. Me qëllim njohjen, monitorimin dhe kontrollin e situatës lidhur me realizimin e këtij detyrimi, kërkohet të raportoni në Drejtorinë e Financave dhe në Drejtorinë e Mbështetjes Logjistike në DPSSH, duke dërguar zyrtarisht si me poshtë:

1. Urdhrit të Titullarit të njësisë tuaj shpenzuese "Mbi krijimin e komisioneve për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve për vitin buxhetor 2023".

2. Përfundimet e procesit të inventarizimit dhe të vlerësimit të aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimi, brenda datës 31 Dhjetor 2023.

Sa më sipër nga komisioni nuk është respektuar afati i realizimit të inventarizimit të kërkuar brenda datës 31 Dhjetor 2023.

Konstatim:

Në relacion nga komisioni është shprehur se s'ka diferenca materiale, por ka stoqe në magazinë.

Në relacion mungon lista në sasi dhe vlerë e artikujve për të cilën komisioni pretendon se janë jashtë qarkullimi, artikujve për të cilët nuk gjejnë përdorim.

Gjithashtu në lidhje me instrumentet dhe pajisjet dentare për të cilat komisioni shprehet se nuk janë në funksion që nga viti 2014 nuk ka një listë të tyre dhe vlerën përkatëse të regjistruara në kontabilitet.

Në lidhje me aktivet material të hotelit pesë katesh. i cili është jashtë funksioni komisioni citon se aktivet si krevate janë jashtë funksioni dhe nuk riparohen, por pa bashkëngjitur një listë të tyre dhe vlerën kontabël të regjistruar, me qëllim vlerësimin e tyre nga komisioni i vlerësimit, i cili do ngrihet nga titullari i institucionit.

Sa më sipër, në procesverbal komisioni është shprehur se një pjesë e mallrave/aktiveve nuk janë në gjendje pune, por nuk ka evidentuar listën me zërat e aktiveve të cilat janë jashtë funksioni dhe zërat e aktiveve funksionale gjendje në magazinë as në shënimet/vërejtje të "Fletë Inventarit", si dhe nuk është shprehur në lidhje me vlerësimin paraprak për cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, të cilin së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Titullarit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" paragrafi 85/c.

Më pas, Titullari nuk ka marrë masa për ngritjen e komisionin të vlerësimit, për vlerësimin e aktiveve të cilat relatohen nga komisioni i inventarizimit si jo funksionale, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" paragrafi 96-99 dhe 102. Mos realizimi i vlerësimit të aktiveve nga institucioni ndikon në mos planifikimi efektiv financiar afatmesëm të nevojave të institucionit për zëvendësimin e këtyre aktiveve, që janë në përfundim të ciklit të tyre të funksionimi.

Nga komisioni është konstatuar dhe është relatuar se në Fakultetin e Hetimit dhe Sigurisë ka rezultuar materiale pa inventar në vlerën prej 909,500 lekë, ku është mbajtur një procesverbal me datën 06.12.2023 ku është evidentuar lista e aktiveve dhe është bërë vlerësimi i tyre në bazë të çmimeve aktuale në inventarin faktik të institucionit dhe atij në publikimin online.

Në relacion komisioni është shprehur se këto aktive në kabinetin e Fakultetit të hetimit dhe sigurisë janë përdorur për trajnime për nevoja të Drejtorisë së emergjencave civile.

Në lidhje me krijimin e këtyre aktiveve nuk ka asnjë gjurmë auditimi, nëse janë blerë nga institucioni nëse kanë qenë donacione apo janë në pronësi të Agjencisë së Emergjencave civile.

Nga Akademia e Sigurisë është bërë hyrje provizore/ruajtje me datën 07.12.2023 të këtyre aktiveve të vlerësuara në vlerën 909,500 lekë. Deri në auditimin në terren të grupit nga AS nuk ishte marrë asnjë masë për kontabilizimin e tyre në kontabilitet ose kalimin e tyre në institucionin që i ka në përgjegjësi material.

b) Vlerësimi i aktiveve

Me Urdhrin nr. 143 datë 14.04.2022 të drejtorit/Rektorit i ndryshuar me nr. 190, datë 19.05.2023 është ngritur komisioni “Për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve qarkulluese dhe aktive afatgjata”, për aktivet e identifikuara në relacionin e inventarizimit të vitit 2021-2022.

Në fund të procesit të vlerësimit për vitin 2022, komisioni i vlerësimit për aktivet e institucionit ka mbajtur procesverbalin me nr. 1, datë 08.06.2022, për 214 artikuj të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimit në vlerën 4,003,569 lekë.

Në fund të procesit të vlerësimit për vitin 2023, komisioni i vlerësimit për aktivet e institucionit ka mbajtur procesverbalin me nr. 1, datë 25.05.2023, për 212 artikuj në vlerën 3,913,470 lekë të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimit, nga ku u konstatua se artikujt e vlerësuar, si të dëmtuar janë po të njëjtit artikuj që janë vlerësuar në vitin 2021 dhe vitin 2022.

Në relacionin e vlerësimit është relatuar procedura e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, ku janë përcaktuar shkaqet e daljes jashtë përdorimit të këtyre aktiveve, vlera e mbetur e tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i aktiveve, veprime në përputhje me paragrafin 102-105 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Nga Komisioni i Vlerësimit me shkresën nr. 1/1, datë 08.06.2023 është dërguar kërkesa për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të këtyre artikujve drejtuar Administratorit të Akademisë.

Vlerësimi i aktiveve nuk është bërë çdo vit nga institucioni

c) Nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve

Me Urdhrin nr. 143 datë 14.04.2022 të Rektorit, i ndryshuar me nr. 190, datë 19.05.2023 është ngritur komisioni “Për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve qarkulluese dhe aktive afatgjata”, për aktivet e identifikuara në relacionin e inventarizimit të vitit 2021-2022, i përbërë nga 5 anëtarë, me përbërje tjetër nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, sipas përcaktimit të parashikuar nga paragrafi 97, të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Mbështetur në relacionin e komisionit të vlerësimit dhe në proces - verbalin e vlerësimit të aktiveve 2022-2023, Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi/asgjësimit në Procesverbalin e mbajtur në datën 30.06.2023, për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve është përshkruar procedura e ndjekur ku raportohet se: një pjesë e artikujve janë shkatërruar dhe janë transportuar në landfill nga mjetet e pastrimit të bashkisë si dhe nga mjeti i QFMT. Ndërsa artikujt metalike, hekuri ose me pjesë metalike u transportuan në QFMT për tu bërë hyrje për skrap. Në përfundim të procesit të asgjësimit u bë hyrje material për skrap me fletë -hyrje nr. 39, datë 27.06.2023 në sasinë 160 kg.

2.5 Prokurimet me fonde publike.

Grupi i auditimit, për të realizuar qëllimin dhe objektin e auditimit të përputhshmërisë mbi prokurimet publike, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, të VKM-së nr. 918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, të VKM-së nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Për vitin 2022 janë realizuar në total 15 procedura prokurime me vlerë të vogël, nga ku janë parashikuar 6,204,995 lekë si fond limit dhe vlera e kontratës së realizuar është 4,116,324 lekë pa TVSh.

Për vitin 2023 janë realizuar në total 38 procedura prokurime me vlerë të vogël, nga ku janë parashikuar 14,453,772 lekë si fond limit dhe vlera e kontratës së realizuar është 10,848,737 lekë pa TVSh.

Grupi i auditimit ka audituar të gjitha procedura prokurimit me vlerë të vogël, të realizuara për vitin 2022 dhe vitin 2023.

1. Regjistri i parashikimeve

- Autoriteti Kontraktor ka krijuar në SPE regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar, në Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021 “Për hartimin e parashikimit të regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit dhe regjistrin të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit publik”, të cilat janë dërguar me nr. 178, datë 27.01.2022 dhe nr. 149, datë 18.01.2023.

Sa më sipër regjistrat nuk janë përgatitur, sipas afatit të përcaktuar Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021 pika 3 ku citohet se “Regjistri i parashikimit të procedurave të prokurimit duhet të përgatitet nga AK jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës”.

- Ligji i buxhetit nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” është botuar në fletoren zyrtare nr.197 datë 21.12.2021.

- Ligji i buxhetit nr. 84, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023” është botuar në fletoren zyrtare nr.171 datë 21.12.2022.

- Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP <https://www.app.gov.al>.

2. Regjistri i realizimeve

Në lidhje me regjistrin e realizimit të vitit 2022- 2023 u konstatua se në përgjithësi nuk është paraqitur me formën dhe mënyrën që është parashikuar, kreut II të Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021 dhe nenit 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua se:

- Regjistrat e realizimit nuk janë të plotë.

- Në regjistrin e realizimit nuk janë futur si të realizuar të gjitha procedurat të cilat janë mbyllur në 2022 dhe 2023.

Mos pasqyrimi i procedurave të realizuara në regjistrin e realizimit ka ardhur si rrjedhojë mos arkivimit të procedurave në SPE, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 30.07.2021 “Për Mënyrën e zhvillimit të procedurave të procedurave të prokurimit me mjete elektronike” pika 3.11. “Arkivimi i procedurës së prokurimit në SPE”, “Pas publikimit në sistem të njoftimit të lidhjes së kontratës së nënshkruar, faza e radhës që shfaqet tek skedari “Detyrat e Mbetura” për nëpunësi i autorizuar “Arkivo Tenderin”, me Manual Teknik “Për zhvillimin e procedurave të prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër dhe krijimin e minikontratave në sistem” me Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021 Kreu II “Regjistri i realizimit të

procedura të prokurimeve publike” pika 1, si dhe me pikën 3 të nenit 16 të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe manualit të MFK miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, ku mungesa e gjurmëve të auditimit, e cila informon mbi:

Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit;

- Gjurmimin e operacionit prej fillimit në fund;
- Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesit; etj nuk i jep mundësinë audituesit të përcaktojë radhën e ngjarjeve, që ndodhin brenda çdo procesi (çdo procedure prokurimi).

- Në regjistrin e vitit 2022 dhe 2023 mungon element, tipi i kontratës: mall/shërbim punë/marrëveshje kuadër, i cili është kërkuar sipas udhëzimit Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021.

- Nga AK nuk janë pasqyruar në regjistrin e realizimit të gjitha kategoritë e mallrave e shërbimeve.

-Procedura, të cilat janë realizuar nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara janë lidhur kontratat e realizimit të mallrave/shërbimeve nuk janë pasqyruar në regjistrin e realizimit veprime në kundërshtim kreut II Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021, pika 2.

Nga grupi i auditimit u konstatua se këto vlera të realizuar dhe të pa pasqyruara në regjistrin e prokurimeve nga analiza e shpenzimeve në ditarin e bankës, për periudhën objekt auditimi.

Kriteri: Udhëzimi nr. 4, datë 18.06.2021 ”Për hartimin e parashikimit të regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit publik”, pika 1; 2 dhe 3;

Udhëzimin nr. 7, datë 30.07.2021 “Për Mënyrën e zhvillimit të procedurave të procedurave të prokurimit me mjete elektronike” pika 3.11.

VKM-ja nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 78, pika 4.

- Për vitin 2022 me urdhrin nr, 02 datë 05.01.2022 “Krijimi i komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël për vitin 2022” i ndryshuar miratuar nga Rektori, komisioni përbehet nga Sh. B. Kryetar, F. K. dhe B.L., anëtare.

- Për vitin 2023 me urdhrin nr.31 datë 25.01.2023 “Krijimi i komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël për vitin 2023” miratuar nga Rektori, komisioni përbehet nga Sh. B. Kryetar, H. K.dhe R. D., anëtare.

Nga auditimi i procedurave te prokurimit me vlerë të vogël u konstatua mangësi si me poshtë.

1. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël (Kpvv) ka marrë kërkesë për blerje malli shërbimi elektrike ”Blerje materialë izoluese”.

Vlera e përlllogaritur për fondin limit është **200,000** lekë pa TVSh.

Me urdhër nr. 38 prot., date 15.09.2022 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël i cili do të prokuroje disa nga mallrat si me poshtë vijon:

1. Automat Schneider 10A.
2. Automat Schneider 16A.
3. Automat Schneider 20A.
4. Automat Schneider 25A.

Kpvv ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e parë.

Me procesverbal datë 22.09.2022 komisioni ka mare në dorëzim aktivet dhe po në të njëjtën datë është bërë hyrje në magazine.

Pagesa është kryer me USH nr. 174 datë 21.10.2022 me vlere **172,800** me TVSh kundrejt Oe fituese “T.” Shpk.

Nga auditimi i procedurës konstatohet se në urdhrin e prokurimit dhe ftesën për ofertë në disa zëra është përdorur emri i markës "Schneider" përmendja e markës është një kriter diskriminues, për arsye së nuk janë përdorur fjalët "ose ekuivalent". Veprime në kundërshtim me LPP nr. 162 datë 23.12.2020, Neni 36 *Specifikimet teknike, pika 4, Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente"*.

2. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për blerje barna mjekësore.

Vlera e përlllogaritur për fondin limit është 316,043 lekë pa TVSh.

Me urdhër nr. 10 prot., date 05.04.2022 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël.

Kpvv ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e 2 pasi OE e renditur në vendin e parë është tërhequr nga procedura.

Me procesverbal datë 15.04.2022 komisioni ka mare në dorëzim barnat mjekësore dhe po në të njëjtën datë është bërë hyrje në magazine.

Pagesa është kryer me USH nr. 73 datë 27.04.2022 me vlere 249,416 me TVSh kundrejt OE fituese "F. F."

2.1 Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për blerje barna mjekësore.

Vlera e përlllogaritur për fondin limit është 333,333 lekë pa TVSh.

Me urdhër nr. 965 prot., date 24.04.2023 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël.

Kpvv ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e 3 pasi OE e tjerë janë tërhequr nga procedura.

Me procesverbal datë 03.05.2023 komisioni ka mare në dorëzim barnat mjekësore dhe po në të njëjtën datë është bërë hyrje në magazine.

Pagesa është kryer me USH nr. 84 datë 11.05.2023 me vlere 356,936 me TVSh kundrejt OE fituese "C."

Nga auditimi i 2 procedurës te sipërcituara konstatohet se në urdhrin e prokurimit dhe në ftesën për ofertë AK ka kërkuar 61 barna(medikamente), nga të cilat 43 barna në procedurën e vitit 2022 dhe 33 barna në procedura e vitit 2023 është kërkuar medikamenti me ermin tregtar dhe jo me principin aktiv të medikamentit. *Veprime në kundërshtim me LPP nr. 162 dt. 23.12.2020, Neni 36 Specifikimet teknike, pika 4, Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.*

3. Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për shërbime rimbushje fikësi zjarri.

Vlera e përlllogaritur për fondin limit është 100,000 lekë pa TVSh.

Me urdhër nr. 57 prot., date 21.11.2022 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël.

Në ftesën për oferte tek specifikimet teknike AK ka kërkuar që malli duhet të jetë i shoqëruar me certifikatë garancie dhe certifikatë prodhuesi/origjine.

Kpvv ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e parë.

Me procesverbal datë 08.12.2022 komisioni konstaton se shërbimi është kryer komfor

specifikimeve teknike.

Pagesa është kryer me USH nr. 242 datë 15.12.2022 me vlerë 75,600 lek me TVSh kundrejt OE fituese “G.”.

3.1 Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka marrë kërkesë për shërbime rimbushje fikasë zjarri.

Vlera e përlogaritur për fondin limit është 118,000 lekë pa TVSh.

Me urdhër prokurimi nr. 2760 prot., datë 12.12.2023 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël.

Kpvv ka shpallur fitues OE i renditur në vendin e dytë pasi OE i renditur në vendin e parë është tërhequr nga procedura e prokurimit.

Me procesverbal datë 21.12.2023 komisioni konstaton se shërbimi është kryer konform specifikimeve teknike.

Pagesa është kryer me USH nr. 289 datë 27.12.2022 me vlerë 81,360 lek me TVSh kundrejt OE fituese “G.”.

Nga auditimi i procedurës së vitit 2022 konstatohet se OE fitues “G.” sipas QKR nuk ka fushën e veprimtarisë së tij rimbushjen e fikseve të zjarrit e cila është objekti i procedurës së prokurimit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 25.06.2021 *“Mbi Përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 15 shkronja a citon: Anëtarët e komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël pas hapjes së oferta në datën dhe orën e caktuar, fillimisht do të verifikoj fushën e veprimtarisë së të gjithë ofertuesve pjesë marres në faqen zyrtarë të QKB”.*

Gjithashtu për të dyja procedurat konstatohet se OE nuk ka dorëzuar certifikatat e garancisë dhe certifikatën e prodhuesi/origjine. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2 citon: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

Zbatimi i Kontratës

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: **“Izolim tarrace në godinat e AS”** rezultoi se:

- Objekti i kontratës është *“Izolim tarrace në godinat e AS”* në Akademinë e Sigurisë Tiranë. Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës së shërbimit me nr. 2667 prot., datë 30.11.2023, lidhur midis AK Akademia e Sigurisë Tiranë dhe Operatorit Ekonomik OE “U.” ShPK. Vlera e kontratës është 544,608 lekë me TVSh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 20 ditë kalendarike. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.2700 prot., datë 05.12.2023, midis AK Akademia e Sigurisë Tiranë dhe Mbikëqyrësit “G. C.” ShPK, me licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2928/10. Njoftimi i fillimit të punimeve dhe procesverbali i piketimit të objektit është mbajtur në datë 04.12.2023. Përfundimi i punimeve dhe procesverbali i përfundimit është mbajtur më datë 07.12.2023; pra punimet kanë përfunduar më herët sesa parashikimi.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr. 271 prot., datë 14.12.2023, midis AK Akademia e Sigurisë Tiranë dhe Kolaudatorit “H. C.” ShPK me përfaqësues Administrator z. G. Ç., me licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.

Vlera e kontratës së shërbimit 1,020 lekë me TVSh.

Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin *“Izolim tarrace në godinat e AS”* u konstatuan disa pasaktësi si më poshtë:

Nga ana e dokumentacionit teknik në dosjen e zbatimit, u vu re se mungojnë disa dokumente teknik, ku ndër më kryesorët mund të përmendim: certifikatat dhe skeda teknike për materialet e përdorura, miratimi i tyre, prova teknike me ujë për rrjedhje të tarracës, skica dhe vizatime teknike për librezat e masave, ditari teknik, relacioni përfundimtar i mbikëqyrësit, korrespondenca etj.

Në dosjen tekniko-ligjore mungonte projekti i zbatuar. Në dosjen teknike administrohet vetëm librezat e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar.

Kriteri: Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të objektit “*Izolim tarrace në godinat e AS*” u vu re se dosja tekniko-ligjore ishte e paplotë jo në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar. Kreu III, neni 7.

Si pasojë e neglizhencës në plotësimin e dokumentacionit; dosja tekniko-ligjore është e paplotë dhe me mangësi.

Mos menaxhim i mirë dhe në kohë i procedurave për plotësimin e dokumentacionit të objektit. Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin dhe plotësimin e dosjes tekniko-ligjore me gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë zbatimit të punimeve.

2.6 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Statuti i Akademisë miratuar me Urdhër të përbashkët nr.490, datë 21.9.2015 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit si dhe Ministrisë të Brendshme
2. Statuti i Akademisë miratuar me Urdhër të përbashkët nr.130, datë 10.3.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit si dhe Ministrisë të Brendshme.
3. Rregullore e Akademisë së Sigurisë, miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.25, datë 18.12.2016.
4. Rregullore e Akademisë së Sigurisë, miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.77, datë 02.5.2023.
5. Rregullore e Kolegjit Profesional të Formimit Policor, miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.81, datë 05.6.2023.
6. Rregullore e Fakultetit të Sigurisë, miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.83, datë 05.6.2023.
7. Akte ligjore për zbatimin e etikës;
8. Struktura organike e institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe reflektimi i ndryshimeve në rregulloren e brendshme;
9. Raportet vjetore për vitet objekt auditimi, miratuar nga Senati Akademik.

I. Mbi veprimtarinë e Akademisë së Sigurisë.

Akademia e Sigurisë (në vijim AS) është krijuar me Vendim nr.184, datë 20.12.1971 të Këshillit të Ministrave në vijim të Shkollës së Ministrisë së Brendshme. Akademia organizon programe studimi të arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike në të gjitha ciklet, kurse profesionale të formimit bazë dhe të kualifikimit të vazhduar për çdo gradë, kurse specializimi për çdo shërbim e profil dhe trajnim praktik për punonjësit e strukturave si:

Policia e Shtetit, Garda e Republikës, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Shërbimi i Provës, Shërbimi i çështjeve të brendshme në Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Policia Bashkiake,

Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Persona fizikë e juridikë që ofrojnë shërbimin e sigurisë fizike, subjekt të së drejtës private apo publike si dhe Institucione të tjera, pavarësisht emërimit, të krijuara me akte të tjera që operojnë në fushën e rendit dhe të sigurisë publike.

Njësitë kryesore përbërëse të Akademisë së Sigurisë janë: Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit si dhe Kolegji Profesional i Formimit Policor.

AS-ja gëzon status të veçantë, dhënë me Vendimin nr. 881, datë 28.10.2020 të Këshillit të Ministrave *“Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike, si dhe organizimin dhe funksionimin e saj”*.

Statusi i veçantë i Akademisë konsiston në harmonizimin e ligjit për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë me ligjet përkatëse të Policisë së shtetit dhe të institucioneve të tjera ligj zbatuese pjesëmarrëse në arsimim, si dhe në çështje që lidhen me organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, trajtimin specifik të organizimit akademik dhe administrativ, të personelit akademik, të personelit ndihmës akademik, trajnues dhe administrativ, të programeve të studimit, të kualifikimit, të trajnimit e të stërvitjes, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të organeve kolegjiale dhe e autoriteteve drejtuese, përbërja e bordit të administrimit, si dhe kompetencat e administratorit të Akademisë parashikohen në statutin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë.

Në pikën 5 të nenit 17 të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”* përcaktohet se: *“Institucionet e arsimit të lartë, që ofrojnë programe studimi në fusha me veprimtari akademike specifike, lidhur me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, gëzojnë status të veçantë. Ky status i jepet institucionit të arsimit të lartë me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.*

Akademia e Sigurisë si institucion i arsimit të lartë është akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit nr.07, datë 27.01.2023 të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në Republikën e Shqipërisë. Bordi i Akreditimit ka dhënë vlerësimin përfundimtar pozitiv për Akademinë duke e akredituar për pesë vite. Gjithashtu, me vendim nr.97, dt 23.9.2023 të Bordit të Akreditimit u akreditua programi i studimit të ciklit të parë *“Bachelor”* në *‘Siguria dhe hetimi’* me kohëzgjatje 4 (katër) vite.

Organizimi i Akademisë në aspektin e varësisë institucionale ka pësuar ndryshime të shpeshta përmes Vendimeve të Këshillit të Ministrave. Në vitin 2015 Akademia e Sigurisë ishte parashikuar si institucion në përbërje të Policisë së Shtetit. Pas shfuqizimit të VKM-së nr.185, datë 25.2.2015 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Akademisë së Sigurisë”* përmes Vendimit nr.881, datë 28.10.2020 të Këshillit të Ministrave, Akademia kaloi në varësi të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe ministrit përgjegjës për arsimin. Gjatë vitit 2021 me VKM nr.320, datë 02.6.2021 *“Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimin e saj”*, Akademia kaloi si njësi shpenzuese brenda programit buxhetor të Policisë së Shtetit.

Nisur nga domosdoshmëria për t’u përshtatur me ndryshimet ligjore si dhe fakti që organizimi i Akademisë, funksionimi i organeve dhe autoriteteve drejtuese të saj bazohet në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe legjislacionin për Policinë e Shtetit, strukturat e saj kanë hasur vështirësi në zbatimin e duhur të legjislacionit.

Kjo reflektohet në mungesën e pajtueshmërisë së akteve të brendshme që kanë normuar veprimtarinë e institucionit lidhur me kompetencat e Rektorit dhe Administratorit të Akademisë. Konkretisht, **Statuti** i miratuar me Urdhër të përbashkët nr.490, datë 21.9.2015 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit si dhe Ministrit të Brendshëm, me fuqi ligjore deri në datë 10.3.2023, në nenin 26 të tij përcaktonte se: *Autoriteti Drejtues i AS është Drejtor i Përgjithshëm i cili vepron në emër dhe për llogari të Akademisë ka si detyrë kryesore drejtimin e veprimtarisë së AS-së nga ana shkencore, administrative dhe financiare.*

Në nenin 15 përcaktohen detyrat e Kancelarit si drejtues i administratës, emërimi i të cilit kryhet nga Drejtori i Policisë së Shtetit me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm. **Kancelari përgjigjet për aktivitetin administrativ të institucionit.**

Ndërsa në **Rregulloren** e Akademisë së Sigurisë, miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.25, datë 18.12.2016, me fuqi ligjore deri në datë 02.5.2023, në neni 17, përcaktohet funksioni i **administratorit si autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të AS-së.**

Statuti dhe Rregullorja e mësipërme kenë qenë në fuqi gjatë vitit 2022, dhe përmbajtja e tyre nuk është rishikuar në përputhje me VKM-në nr.881, datë 28.10.2020 i ndryshuar me VKM-në nr.320, datë 02.6.2021. *“Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit e saj”.*

Sipas VKM-së së lartpërmendur, nr.881, datë 28.10.2020, në pikën 5 përcaktohej forma e organizimit të Akademisë, si më poshtë vijon:

- a) Senati Akademik;
- b) **Rektori;**
- c) Rektorati;
- ç) Dekani;
- d) Dekanati;
- dh) Asambleja e personelit akademik;
- e) Drejtuesit e njësive bazë;
- ë) Komisionet e përhershme;
- f) Bordi këshillues;
- g) Bordi i administrimit;
- gj) **Administratori i institucionit.**

Pika 6 : Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të organeve kolegjiale dhe e autoriteteve drejtuese, përbërja e bordit të administrimit, si dhe kompetencat e administratorit të AS-së parashikohen në statutin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë.

Gjatë periudhës Janar – Maj të vitit 2022 u konstatua se, funksionet administrative janë ushtruar nga Drejtori/Rektori. Konkretisht nga ish-Drejtuksi i Akademisë, Drejtori/Rektori z. B. M., në cilësinë e përfaqësuesit të Akademisë është nënshkruar kontrata e shërbimit nr.13/6, datë 29.4.2022 *“Për shërbim riparimi të chillerave, kondicionerëve, etj”*, lidhur midis Akademisë së Sigurisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik. Gjithashtu Drejtori/Rektori ka nxjerr urdhrat e prokurimit si dhe urdhrat për ngritjen e komisionit për blerje të vogla. Referuar dokumentit të vënë në dispozicion nga subjekti, me emërtim *“Raport i vendeve të lira”*, datë 02.02.2022 pozicioni i Drejtorit/Administratorit rezultonte vakant përgjatë 5-pesë mujorit të parë të vitit 2022.

Me Urdhër të Ministrit të Brendshëm nr.71, dt.18.5.2022 është emëruar në detyrë si Drejtor/Rektor i Akademisë së Sigurisë z. I. M., të drejtat administrative të së cilit kanë filluar në datë 23.5.2022. Me vendim nr.12, datë 26.5.2022 të Bordit të Administrimit është emëruar Administratori i Akademisë së Sigurisë z. M. N.. Efektet administrative dhe financiare të vendimit të Bordit kanë filluar në datë **01.6.2022**. Në datë 29.7.2023, u zhvilluan zgjedhjet e para akademike për postin e Rektorit. Kandidati i shpallur fitues prof. I. M. u dekretua nga Presidenti i Republikës në datë 04.10.2023.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se, edhe gjatë periudhës kur në detyrë ka qenë Administratori, funksionet e menaxhimit financiar janë ushtruar nga Rektori i Akademisë z.I. M. në cilësinë e nëpunësit autorizues, deri në datë 05.4.2023, datë në të cilën Akademia e Sigurisë ka dërguar në Degën e Thesarit të dhënat e Administratorit z. M. N. si nëpunës autorizues⁴.

Konkretisht: Rektori i AS-së ka nxjerr Urdhërat e Prokurimit⁵ deri në datë 01.7.2022 në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, si dhe janë nënshkruar urdhër shpenzimet deri në datë 05.4.2023. Bazuar në nenin 21, pika 5 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: *“Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike”*. Gjithashtu konstatohet se, për periudhën 2022-2023 Rektori i Akademisë ka nënshkruar urdhër shërbimet në cilësinë e urdhëruesit të shërbimit.

➤ **Gjatë vitit 2023** janë miratuar Statuti dhe Rregullorja e re e Akademisë, në të cilat kompetencat e Administratorit dhe Rektorit janë parashikuar sipas Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”.

• Bazuar në VKM-së nr.881, datë 28.10.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj” përcaktohet se: **mënyra e organizimit dhe e funksionimit të organeve kolegjiale dhe e autoriteteve drejtuese, përbërja e bordit të administrimit, si dhe kompetencat e administratorit të AS-së parashikohen në statutin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë.**

Referuar Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, parashikohet ekzistenca e dy titullarëve si, Rektori dhe Administratori, të cilët ushtrojnë kompetencat e tyre në fusha të ndryshme dhe pa varësi administrative nga njeri tjetri. Konkretisht, në nenin 39 e vijues, të ligjit në fjalë, përcaktohet qartë se **“Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare** (pritje, përcjellje të delegacioneve, autoriteteve të larta shtetërore, ceremonitë zyrtare etj). Gjithashtu në nenin 5, të ligjit, përcaktohet qartë se **“Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëkuptimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të këtij ligji”**.

Në vijim, Udhëzimi nr.27, datë 29.12.2017 i Ministrit të Arsimit “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë” në pikën 16 përcakton se struktura administrative është në varësi të administratorit të institucionit publik të arsimit të lartë. Për më tepër, referuar Ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe

⁴ Shkresë nr.836 prot, datë.05.4.2023.

⁵ Urdhër Prokurimi nr.31,datë 25.01.2023 “Për ngritjen e Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël”

kontrollin” (i ndryshuar) neni 4, pika 22, “Nëpunës autorizues” është nëpunësi i nivelit më të lartë të menaxhimit në njësinë publike, përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tyre.

Nëpunës autorizues i nivelit të dytë” është nëpunësi i administratës publike në secilën nga njësitë vartëse të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues.

Autoritetet drejtuese të subjektit kanë pasur paqartësi lidhur me kompetencat e Administratorit dhe Rektorit të Akademisë. Më poshtë paraqitet dokumentacioni i vënë në dispozicion:

- Me shkresat nr.468 prot, datë 21.02.2023, dhe shkresë nr.453, datë 20.02.2023, Akademia e Sigurisë i është drejtuar respektivisht Ministrisë së Brendshme si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për interpretim juridik mbi funksionin dhe kompetencat financiare të Administratorit në Akademinë e Sigurisë. Në përgjigje të shkresave të mësipërme, Ministria e Brendshme me shkresë nr.2105/3 datë 15.3.2023, ka sqaruar se Administratori i Akademisë është nëpunës autorizues i nivelit të dytë ndërsa DPPSH me shkresë nr.288/1, dt.24.02.2023, ka sqaruar se referuar Ligjit për Arsimin e Lartë kompetencat financiare ushtrohen nga Administratori i Akademisë, si përfaqësues ligjor i institucionit për çështjet financiare.
- Me shkresë nr.1382/1 prot, datë 01.12.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit i është përgjigjur shkresës nr. 2498 prot, datë 06.11.2023, të Akademisë së Sigurisë për interpretim juridik sa i përket faktit nëse urdhër shërbimet për pjesën e pagesës së shpenzimeve për punonjësit e Akademisë do të firmosen nga titullari apo administratori. Në përgjigje të kësaj shkrese ndër të tjera DPPSH shpjegon se:“.....Akademia e sigurisë është një strukturë hibride e cila i nënshtrohet Ligjit “Për Policinë e Shtetit” si dhe Ligjit “Për Arsimin e Lartë” si ligj i posaçëm , i cili në mënyrë të qartë ka përcaktuar se kompetencat financiare ushtrohen nga Administratori si përfaqësues ligjor i institucionit në çështjet financiare, për rrjedhojë personi përgjegjës për firmosjen e urdhër shërbimeve duhet të jetë administratori.

Konkluzion: Për sa më sipër, nisur nga ndarja e kompetencave, edhe pse të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi si dhe korrespondencat shkresore që Akademia ka pasur me institucionet e lartpërmendura, gjatë periudhës objekt auditimi rezultoi mbivendosje kompetencash midis Rektorit dhe Administratorit të Akademisë, pasi nga Rektori janë ushtruar funksione që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin. Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH nenin 39, pika 1 dhe neni 51 pika 1, Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”(i ndryshuar), Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenin 21 pika 5, Statutin e Akademisë miratuar me Urdhër të përbashkët nr.130, datë 10.3.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit si dhe Ministrit të Brendshëm neni 12 si dhe Rregulloren e Akademisë së Sigurisë, miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.77, datë 02.5.2023.

Për sa është trajtuar në projekt raportin, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1448/6, datë.03.09.2024 administruar në KLSH me nr. 646/5 prot., datë 04.09.2024, nga Akademia e Sigurisë ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në vëmendjen tuaj do të doja të evidentoja dy momente:

-Në material flitet për “Drejtuesit e institucionit”, të përcaktohej konkretisht, detyrimi dhe roli i Rektorit apo Administratorit për mangësitë e evidentuara në fushat përkatëse si në financë , logjistikë etj.

-Në faqen 82 keni evidentuar ‘konkluzionet e nxjerra për mbivendosjen e kompetencave midis rektorit dhe administratorit.

Doja t’ju sqaroja se këto anomali fillestare kanë ndodhur për paqartësi kompetencash në momentin e parë të emërimit të rektorit dhe administratorit të cilat në vijimësi janë sqaruar.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me kërkesën tuaj për përcaktimin e detyrimeve dhe rolit të Rektorit dhe Administratorit të Akademisë në kuadër të mangësive të konstatuara gjatë auditimit, sqarojmë se: Në projekt raportin e auditimit si dhe në akt-konstatimin e mbajtur për këtë çështje është kryer analiza faktike dhe ligjore bazuar në dokumentacionin provues për periudhën objekt auditimi. Vlerësojmë se kuadri ligjor mbi kompetencat e Rektorit dhe Administratorit në rolin e nëpunësit autorizues është i plotë dhe i qartë për t’u zbatuar dhe mbi bazën e të cilit janë hartuar gjetjet dhe rekomandimet.

- Referuar ndryshimeve ligjore të VKM-së nr.881, datë 28.10.2020 “*Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj*” përmes VKM-së nr.320, datë 02.6.2021, “*Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj*” pika 15 është ndryshuar si më poshtë:

- “**Personeli akademik me gradë policore** përzgjidhet nga radhët e punonjësve të policisë së shtetit, sipas kriterëve të përcaktuara në statutin e Akademisë së Sigurisë dhe **emërohet nga Rektori me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit**. Gjithashtu, **personeli akademik me gradë sipas statutit të strukturave përfituese emërohet nga Rektori** me propozim të titullarëve të strukturave përfituese sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit midis titullarit të AS dhe titullarit të strukturave përfituese. Personeli akademik sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen karakterizohet në profesorë, lektorë dhe asistent lektorë. Për personelin akademik me gradë policore ose gradë sipas statutit të strukturave përfituese bëhet ekuivalentimi i këtyre gradave me gradat shkencore dhe titujt akademikë të personelit akademik.”

Konstatim: Në përmbajtje të Statutit dhe Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Akademisë, konkretisht në nenin 24 të Statutit dhe nenin 70, pika 5 të Rregullores së Akademisë përcaktohet se: *Personeli me gradë policore emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me propozim të Rektorit*. Për sa më sipër, ndryshimet e kryera me VKM-në nr.320, datë 02.6.2021, “*Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj*” lidhur me të drejtën e emërimit të personelit akademik nga ana e Rektorit nuk janë reflektuar në Statutin dhe Rregulloren e brendshme të Akademisë.

Gjithashtu nga dokumentacioni⁶ i vënë në dispozicion rezultoi se, gjatë vitit 2022 emërimi dhe transferimi i personelit Akademik në Departamentin e Përgjithshëm dhe Juridik në Fakultetin e

⁶ Urdhër nr.2672, datë 09.12.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë “Për emërimin në detyrë të një personeli akademik”.

Urdhër nr.2670, datë 09.12.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë “Për emërimin në detyrë të një personeli akademik”.

Urdhër nr.2675, datë 09.12.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë “Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një personeli akademik”.

Sigurisë dhe Hetimit është kryer me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit bazuar në Ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” nenin 9 pika 2, shkronjat “b” dhe “ç”) si dhe nenin 43, pika 4, ku përcaktohet se: *Transferimi i punonjësit të policisë me gradën “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë”, si dhe të gjitha transferimet e punonjësve nga një strukturë në një strukturë tjetër, pavarësisht nga grada, bëhen me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.*

Por referuar strukturës së miratuar me Urdhër të brendshëm nr.5449/6, datë 26.10.2022 të Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Akademisë së Sigurisë” rezulton se, stafi i Departamentit të Përgjithshëm dhe Juridik në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit ka statusin e personelit akademik me grada akademike ose tituj akademik si: “Doktor” Profesor” dhe “Profesor i asociuar”.

Për sa më sipër, emërimi dhe transferimi i stafit akademik që nuk kanë grada policore nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë nuk parashikohet në Ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” si dhe vjen në kundërshtim me VKM-në nr.320, datë 02.6.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj”.

-Për sa i përket personelit akademik me grada policore dispozitat e parashikuara në VKM-në nr.320, datë 02.6.2021, mbi të drejtën e Rektorit për emërimin e personelit akademik vijnë në kundërshtim me nenin 43, pika 4, të Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” ku përcaktohet se: *Transferimi i punonjësit të policisë me gradën “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë”, si dhe të gjitha transferimet e punonjësve nga një strukturë në një strukturë tjetër, pavarësisht nga grada, bëhen me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.*

➤ **Mbi autonominë financiare të Akademisë së Sigurisë si institucion i arsimit të lartë.**

Referuar Ligjit për arsimin e lartë, institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autonomia financiare shprehet ndër të tjera në të drejtën e Institucionit të Arsimit të Lartë:

- Për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit;
- Për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Për të përcaktuar tarifën e studimit, në përputhje me këtë ligj;
- Për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që institucionet zotërojnë ligjërisht, në përputhje me misionin e tyre.

-Bazuar në nenin 17 pika 2 të Ligjit për arsimin e lartë përcaktohet se: **“Institucionet publike të arsimit të lartë janë persona juridik publik që vetëfinancohen, financohen nga Buxheti i Shtetit ose nga burime të tjera të ligjshme.**

Urdhër nr.2630/2, datë 09.12.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë “Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një personeli akademik.

Urdhër nr.2671, datë 09.12.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë “Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një personeli akademik”.

-Referuar nenit 84 të ligjit të lartpërmendur përcaktohet se: *“Forma e organizimit të studimeve, pranimit i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me këtë ligj dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin”*.

Akademia e Sigurisë financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme. Me VKM-së nr.320, datë 02.6.2021, *“Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj”* Akademia është njësi shpenzuese më vete brenda programit buxhetor të Policisë së Shtetit.

Në nenin 63 të Statutit të Akademisë përcaktohet se: *“Të gjitha të ardhurat e krijuara nga AS-ja si institucion publik i arsimit të lartë përdoren prej saj dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës.*

Nga administrimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua si më poshtë:

-Akademia e Sigurisë nuk aplikon tarifa për shkollimin bazë policor në Kolegjin Profesional të Formimit Policor dhe programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit. Kursantët dhe studentët, për kohën e frekuentimit të shkollimit bazë policor dhe programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor”, përveç akomodimit dhe ushqimit falas, përfitojnë edhe trajtim financiar. Referuar nenit 46 të Statutit të Akademisë, përcaktohet e drejta e Bordit të Administrimit për të miratuar tarifat e shkollimit me përjashtim të Policisë së Shtetit si dhe e drejta e miratimit të tarifave të shërbimeve ndaj të tretëve. Gjithashtu, Bordi përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit.

-Me Urdhër të Rektorit të Akademisë nr.256, datë 02.6.2023 është ngritur grupi i punës, për caktimin e kostove të shërbimeve që ofron Akademia e Sigurisë. Me shkresë nr.656 prot, datë 28.2.2024 Akademia ka përcjell nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit listën e kostove të përlloraritura nga grupi i punës për t’u miratuar nga Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme. Nga institucionet përgjegjëse nuk është kthyer një përgjigje zyrtare lidhur me këtë shkresë. Për periudhën objekt auditimi nga ana e Akademisë nuk janë caktuar tarifa studimi për studentët e për rrjedhojë nuk janë përfituar të ardhura.

-Lidhur me të drejtën për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që zotëron Akademia, nga praktika e vënë në dispozicion u konstatua se: Bazuar në VKM nr.54, datë 05.02.2014, *“Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enftëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”* Akademia i është drejtuar me shkresë nr.4324/1 prot, datë 05.10.2023 Degës së Thesarit për dhënie autorizimi për përdorim të fondeve të krijuara nga dhënia e ambienteve të saj me qira. Dega e Thesarit me shkresë nr.4324/1, datë 05.10.2023 nuk e ka aprovuar kërkesën e Akademisë me arsyetimin se AS nuk është e përfshirë në Udhëzimin e përhershëm të Buxhetit si dhe nuk ka një Udhëzim plotësues të konfirmuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi përdorimin e të ardhurave.

Bazuar në Kreun VII, *“ Shpërndarja e të ardhurave”* të VKM-së së lartpërmendur përcaktohet se: Pika 1: *“Të ardhurat, që krijohen nga kontrata e qirave të lidhura për pasuri me sipërfaqe deri me 200 m², ndahen si më poshtë vijon: -30 për qind, buxheti i shtetit dhe 70 për qind, ndërmarrja ose shoqëria shtetërore që ka në administrim objektin e dhënë me qira.*

Pika 5: *“Të ardhurat, që krijohen nga dhënia me qira e pasurive të universiteteve dhe shkollave të larta, në mbështetje të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e*

Shqipërisë”, të ndryshuar, ndahen si më poshtë vijon: - 10 për qind, buxheti i shtetit; - 90 për qind, institucioni”.

Konkluzion: Për sa më sipër, Akademia e Sigurisë si institucion i arsimit të lartë nuk ka gëzuar praktikisht autonomi financiare edhe pse e drejta e përdorimit të të ardhurave garantohet në Ligjin për arsimin e lartë, VKM-së nr.320, datë 02.6.2021, “*Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj*”, në VKM nr.54, datë 05.02.2014, “*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*”, si dhe Statutin e Akademisë. Akademia nuk ka menaxhuar të ardhura nga shërbimet që ofron. Bordi i Administrimit si organi kryesor për menaxhimin financiar dhe administrativ ka qenë në pamundësi të ushtrimit të kompetencave e tij lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore sipas nevojave të Akademisë si dhe në përcaktimin e mënyrës së përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat.

❖ Lidhur me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi si më poshtë:

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit pranë Akademisë së Sigurisë u realizua bazuar në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr.108, datë 17.11.2016, si dhe aktet e tjera nënligjore.

Sipas përcaktimeve të këtij Ligji, menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektivitet të shërbimeve publike. *Kontrolli i brendshëm* përbëhet nga pesë komponentë të ndërlidhur, të cilët ndërveprojnë me njëri-tjetrin, si më poshtë:

- Mjedisi i kontrollit;
- Menaxhimi i riskut;
- Aktivitetet e kontrollit;
- Informimi dhe komunikimi;
- Monitorimi.

I. Mjedisi i Kontrollit

Ky komponent i kontrollit të brendshëm përshkruan kushtet bazë të nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli në një njësi të caktuar. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë, filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës, mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta, organizon e zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep niveli drejtues. Ky mjedis ndikohet më tej nga struktura organizative e njësisë dhe marrëdhëniet e llogaridhënies.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Në referencë të Ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 “*Për rregullat e etikës në administratën publike*”, si dhe Ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, nevojitet që punonjësit të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjelltë, mbështetur në krijimin e një Kodi të Brendshëm Etik.

Akademia e Sigurisë bazohet në normat dhe rregullat e sjelljes së etikës të përcaktuara në Ligjin për arsimin e lartë e kërkimin shkencor në IAL, Ligjin për “*Për Policinë e Shtetit, Kodin e etikës*

së Akademisë, Rregulloren e Brendshme të Akademisë, Statutin e Akademisë dhe Rregulloren e Policisë.

Me anë të Vendimit nr.67, datë 24.11.2022 të Senatit Akademik të AS është miratuar Kodi i Etikës së Akademisë së Sigurisë, i cili është i detyrueshëm për zbatim në Akademinë e Sigurisë, në Rektorat, në fakultetet(departamentet) bazë, në QKSH, në strukturat mbështetëse e ndihmëse që janë pjesë e Akademisë së Sigurisë. Ndërsa për Kolegjin Profesional të Formimit Policor është miratuar kodi i etikës me vendim nr.04, datë 20.9.2022 të Kolegjit profesional, me qëllim caktimin e rregullave të sjelljes së personelit të Kolegjit me grada e tituj shkencor, të personelit pedagogë e punonjës shkencor, të kursantëve dhe personelit ndihmës.

Me Vendim nr.67/1, datë 24.11.2022 të Senatit është miratuar Rregullorja e Këshillit të Etikës me nr.2096 prot, datë 04.10.2022 si dhe me vendim nr.67, datë28.6.2022 është miratuar përbërja e Këshillit të Etikës në Akademinë e Sigurisë.

Në Akademinë e Sigurisë funksionojnë tre Këshilla të Etikës: Këshilli i Etikës i AS-së, Këshilli i Etikës së Fakultetit të Sigurisë dhe të Hetimit dhe Këshilli i Etikës në Kolegjin Profesional të Formimit Policor detyrat e të cilëve përcaktohen në Rregulloren dhe në Kodin e etikës së AS.

Institucioni i Akademisë ka të përcaktuar misionin e tij në Strategjinë e Zhvillimit të Akademisë. Me vendim të Senatit Akademik nr.57, datë 17.5.2022 është miratuar Strategjia e zhvillimit të Akademisë për periudhën 2022-2025 dhe plani i veprimit, si një detyrim ligjor institucional në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të veprimtarisë së tij vendimmarrëse, rritjes së efijencës, efikasitetit si dhe rritjes së besueshmërisë së publikut tek ky institucion. Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë përmban aktivitetet e planifikuara, afatet e realizimit të tyre dhe strukturat përgjegjëse.

Misioni kryesor i Akademisë është zhvillimi i veprimtarisë mësimore dhe shkencore në të gjitha ciklet e studimit nga njësitë kryesore në arsimin e lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike dhe përgatit specialistë për këto fusha. AS ofron programe formimi, trajnimi të vazhduar për ecurinë në karrierë dhe specializime për të gjitha nivelet enë Policinë e Shtetit dhe për institucionet kërkuese e përfituese të sigurisë publike dhe i certifikon ato. Ajo zhvillon trajnime në fushën e rendit dhe të Sigurisë Publike si dhe jep rekomandime e ofron botime të kësaj fushe.

Për vitin 2022, institucioni ka funksionuar sipas rregullores së brendshme të miratuar me Vendim nr.25, datë 18.12.2016 të Senatit Akademik, me fuqi ligjore deri në miratimin e rregullores së re datë 02.5.2023.

Parimi 2 - Titullari / Nëpunësi Autorizues demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Administratori i Akademisë në cilësinë e nëpunësit autorizues të Akademisë nuk ka garantuar mbikëqyrje të plotë lidhur me projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë, pasi nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm. Veprime në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.28, datë 15.12.2011, i Ministrisë të Financave “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.

Nëpërmjet deklaratës, nëpunësi autorizues merr përsipër përgjegjësinë për menaxhimin me efijencë, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jo financiarë të njësisë, si dhe pohon se sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të njësisë së tij. Ndërsa Raporti Vjetor mbi gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm hartohet në kuadrin e aktiviteteve monitoruese të njësisë së qeverisjes së përgjithshme. Ky dokument përmban një vlerësim të përgjithshëm të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësinë e qeverisjes së përgjithshme, si dhe informacione mbi gjetjet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm

dhe masat që janë marrë ose do të ndërmerren për përmirësimin e këtij sistemi. Për organizimin e brendshëm të procesit të hartimit të raportit vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike që ka detyrimin për raportim ndërmerr veprime për mbledhjen e informacionit për hartimin e raportit dhe të deklaratës.

Deklarata, së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti i paraqitet nëpunësit të parë autorizues në Ministrinë e Financave.

Dobësitë e kontrollit të brendshëm janë analizuar dhe adresuar përmes audtitimit të brendshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Nëpunësit Autorizues ka marrë masa për hartimin e planit të menaxhimit për veprime përmirësuese.⁷

Lidhur me detyrimet ligjore që burojnë nga Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” si dhe VKM-së nr.816, datë.16.11.2016“*Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike*”, konstatohet se: Në strukturën e Akademisë nuk ka njësi të auditit të brendshëm dhe në këto raste njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve është drejtuesi i strukturës së burimeve njerëzore dhe një nëpunës/punonjës i saj. Në mungesë të tyre, kjo njësi përbëhet nga dy nëpunës/punonjës të strukturës së burimeve njerëzore. Akademia e Sigurisë zbaton procedurën standarte sipas Rregullores mbi sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nr.964, datë 25.10.2021.Nga struktura përgjegjëse nuk ka evidenca të sinjalizimeve.

Për vitin 2023, nga Rektori i Akademisë është nxjerr Urdhri nr.487, datë 14.12.2023 dhe Urdhri nr.490, datë 18.12.2023 për zhvillimin e trajnimit me temë “*Për sinjalizimin, hetimin administrativ dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, etikën dhe rregullat e sjelljes së punonjësve të Policisë së Shtetit dhe strukturat e Akademisë së Sigurisë*”. Trajnimi është zhvilluar në datat 19.12.2023 dhe 20.12.2023 me të gjithë punonjësit, me status civil dhe status policor në Akademinë e Sigurisë.

Nga auditimi rezulton se, në fund të çdo viti për të gjithë punonjësit e AS-së sipas varësisë, plotësohet dhe dorëzohet në Sektorin e Burimeve Njerëzore formulari i performancës, në të cilët kryhet edhe vlerësimi i sjelljeve sipas kodit të etikës.

Sipas të dhënave të Sektorit të Burimeve Njerëzore për periudhën 2022-2023 rezultojnë vetëm 2(dy) raste të marrjes së masave disiplinore.

Parimi 3 - *Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.*

Struktura organizative e Akademisë së Sigurisë është e ndërtuar bazuar në Ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Akademia përbëhet nga njësitë kryesore akademike dhe njësitë mbështetëse. Njësitë kryesore përbërëse janë: a) Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit dhe b) Kolegji Profesional i Formimit Policor. Personeli i Akademisë së Sigurisë përbëhet nga personel akademik, personel ndihmës akademik, personel trajnues dhe personel administrativ.

Organika e re e institucionit e përshtatur sipas Ligjit të arsimit të lartë përmban struktura të veçanta që mbulojnë fusha të tilla si: kurrikula, sigurimi i cilësisë, këshillimi i karrierës, shërbimet studentore, rrjeti ALUMNI, projektet dhe inovacioni marrëdhëniet me publikun, psikologu, sekretaritë mësimore etj.

Ministri i Brendshëm miraton strukturën dhe organikën e Akademisë bazuar në propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Për vitin 2022 dhe 2023 Akademia ka funksionuar konform kufirit organik të miratuar me Urdhrat e Ministrit të Brendshëm si më poshtë:

⁷ Plan veprimi nr.1493, date 30.06.2023.

- Urdhër nr.5449/6 prot, datë 26.10.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Akademisë së Sigurisë”.
- Urdhër nr.688, datë 10.05.2023 Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Akademisë së Sigurisë”
- Urdhër nr.47, datë 14.4.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Akademisë së Sigurisë
- Urdhër nr.136, datë 22.09.2023 “Për disa ndryshime në Urdhër nr.47, datë 14.4.2023 Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Akademisë së Sigurisë.

Pas miratimit të strukturës dhe organikës së Akademisë me Urdhër nr.5449/6 prot, datë 26.10.2022 të Ministrit të Brendshëm, në rregulloren e brendshme në fuqi gjatë këtij viti, miratuar nga Senati Akademik me nr.25, datë 18.12.2016, nuk u reflektuan ndryshimet e kryera në përputhje me organikën e re.

Rregullorja aktuale në fuqi e Akademisë me nr.77, datë 02.5.2023 bazohet në strukturën organizative të miratuar me Urdhër nr.5449/6 prot, datë 26.10.2022 të Ministrit të Brendshëm. Referuar ndryshimeve strukturore konstatohet se, në përmbajtje të Rregullores së brendshme nuk janë përcaktuar detyrat funksionale të disa sektorëve si: Sektori i Financës, Sektori Ekonomik, Sektori i Burimeve Njerëzore, Seksioni i Sigurisë si dhe Qendra e Edukimit fizik dhe Sporteve Elitare. Bashkëlidhur Rregullores janë përshkrimet e punës së punonjësve, të cilat janë miratuar me Vendim nr.77/1 prot, dt.02.5.2023 të Senatit Akademik.

Përmes Urdhrit nr.688, datë 10.05.2023 të Ministrit të Brendshëm, është miratuar implementimi i strukturës organike në Policinë e Shtetit sipas së cilës lidhur me strukturën e Akademisë përcaktohet se, në varësi të Administratorit mbetet vetëm 2(dy) Sektor (Financë dhe Ekonomik), pasi Seksioni i Sigurisë ka kaluar në varësi të Sektorit të Burimeve Njerëzore.

Gjithashtu në rregulloren e brendshme të Akademisë nuk janë parashikuar rregulla për hartimin dhe qarkullimin e akteve administrative gjatë përmbushjes së funksioneve të strukturave të brendshme të saj. ***Konkretisht mungon procedura që ndiqet për aktet administrative përpara dërgimit për firmë te Rektori/Administratori/Bordi i Administrimit si dhe procedura për dokumentet administrative hyrëse në institucion.***

Lidhur me procedurat e rekrutimit të punonjësve administrativ në Akademi, në rregulloren e brendshme përcaktohet se, me krijimin e një funksioni të lirë për punonjës administrativ, struktura e burimeve njerëzore shpall vendin e lirë në faqen e internetit të Policisë së Shtetit. Verifikimi i plotësisimit të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të pranimit kryhet sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Policisë së Shtetit. Kriteret e përgjithshme e të veçanta të pranimit të punonjësve administrativ në Akademi përcaktohen në Rregulloren e saj të brendshme.

Konkluzion: Për sa më sipër, Rregullorja e Brendshme nuk është rishikuar në përputhje me ndryshimet strukturore të kryera gjatë vitit 2023. Në përmbajtje të saj nuk ka detyra të përcaktuara qartë për çdo sektor e seksion, konkretisht në përmbajtje të saj nuk janë përcaktuar detyrat funksionale të disa sektorëve si: Sektori i Financës, Sektori Ekonomik, Sektori i Burimeve Njerëzore, Seksioni i Sigurisë si dhe Qendra e Edukimit fizik dhe Sporteve Elitare. Gjithashtu nuk janë parashikuar rregulla për hartimin dhe qarkullimin e akteve administrative gjatë përmbushjes së funksioneve të strukturave të brendshme të Akademisë. Konkretisht mungon procedura që ndiqet për aktet administrative përpara dërgimit për firmë te Rektori/Administratori/Bordi i Administrimit si dhe procedura për dokumentet administrative hyrëse në institucion.

Në bazë të nenit 20, shkronja c, të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, “ Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit lidhur me strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit”.

Parimi 4 -Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.

Për AS, Administratori është Nëpunësi Autorizues, dhe është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të MFK, në të gjitha njësitë, strukturat, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndosh financiar dhe transparencës. Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizimin, të përshtatur me pozicionin si Përgjegjës i Sektorit të Financës. Rekrutimi i punonjësve kryhet nga strukturat e burimeve njerëzore në zbatim të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", Rregulloren e Policisë së Shtetit, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr.750, datë 16.09.2015, i ndryshuar, Statutin, Rregulloren e Akademisë së Sigurisë në të cilën përcaktohen edhe kriteret e punësimit të personelit administrativ si dhe Kodin e Punës. Lidhur me hartimin e planit vjetor të trajnimit të punonjësve, nga Rektori i Akademisë së Sigurisë janë zbatuar programet e mëposhtme:

-Plani vjetor “Për zbatimin e Trajnimit të Detyruar në Shërbim i Akademisë së Sigurisë për vitin 2023 (Grada Drejtues-Drejtues i parë), miratuar me shkresë nr.352 prot, datë 09.02.2023.

-Plani vjetor “Për zbatimin e Trajnimit të Detyruar në Shërbim i Akademisë së Sigurisë për vitin 2023 (N/Komisar-K/Komisar), miratuar me shkresë nr. 351 prot, datë 09.02.2023.

-Plani vjetor “Për zbatimin e Trajnimit të Detyruar në Shërbim i Akademisë së Sigurisë për vitin 2023 (Inspektor), miratuar me shkresë nr. 350 prot, datë 09.02.2023.

Lidhur me trajnimin e nëpunësve mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin gjatë periudhës objekt auditimi rezultoi se nuk ka pasur një plan trajnimi.

Bazuar në Ligjin nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” në AS nuk ka Komitetin të Auditimit të Brendshëm.

II. Menaxhimi i Riskut

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen për arritjen e objektivave të vendosura. Titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollin që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrihen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave.

Në planet vjetore dhe raportet periodike të Akademisë janë përcaktuar objektivat/prioritetet strategjike. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, për periudhën **2022-2023** u konstatua se:

-Institucioni nuk ka krijuar mekanizmat e vlerësimit të riskut pasi, nga ana e titullarit nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik⁸, organ i cili luan një rol të rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit financiar, sistemin e saj të kontrollit të brendshëm si dhe kujdeset për performancën e njësisë publike; GMS duhet të sigurojë që komponentët e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimi efektiv i risqeve janë të pranishëm dhe funksionojnë siç duhet në njësinë.

-Mungon Strategjia e Menaxhimit të Riskut, dokumenti cili përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut;

-Nëpunësi autorizues i Akademisë, në rolin e Koordinatorit të MFK-së nuk ka përmbushur detyrimin e përgatitjes dhe nënshkrimit të deklaratës dhe të raportit vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2022 dhe 2023 bazuar në nenin 18 të Ligjit të MFK.

Në lidhje me parimin 7: *“Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.*

- Nga strukturat përgjegjëse nuk kryhet identifikimi dhe vlerësimi i risqeve në të gjitha nivelet e saj me qëllim arritjen e objektivave si dhe nuk është krijuar regjistri i riskut që mbulon të gjitha aktivitetet e institucionit, por vetëm regjistër risku për sektorin e financës duke sjellë si pasojë pamundësi të monitorimit dhe kontrolleve të të gjitha risqeve në nivelin e duhur. Nga ana e njësisë duhet të kryhet identifikimi, analizimi dhe vlerësimi i risqeve lidhur me kërcënimet e jashtme ndaj institucionit, aseteve e personelit të tij, si dhe dokumentimi i plotë i tyre për të gjitha strukturat e brendshme dhe vartëse të saj.

Në lidhje me parimin 8: *“Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.*

- Nuk ka evidenca të vlerësimit dhe monitorimit të riskut të mashtrimit nga niveli i lartë si dhe planit të veprimit. Mos vlerësimi në mënyrë periodike të ekspozimit të Akademisë ndaj veprimtarisë mashtruese, përbën risk për veprimtarinë e institucionit në arritjen e objektivave. Gjithashtu mungesa e sinjalizimeve sjell si domosdoshmëri ndërmarrjen e nismës nga njësia përgjegjëse për sinjalizim të brendshëm, për realizimin e aktiviteteve dhe takimeve informuese me synim sensibilizimin e punonjësve për sinjalizimin. Titullarët e njësive kanë përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi. Akademia e Sigurisë në lidhje me raportimet për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues, korrupsion, humbja e pasurive, bazohet në “Rregulloren mbi sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, miratuar me Urdhër nr.964, datë 25.10.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

Konkluzion: Për periudhën objekt auditimi, Akademia e Sigurisë nuk ka përcaktuar strukturat dhe mekanizmat për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin efektiv të risqeve. Mos veprimet e mësipërme mbi komponentin e menaxhimit të riskut, bien në kundërshtim me nenin 8, pika 8 shkronja b), nenin 9, nenin 11, pikat 2 dhe 3, neni 21 pika 2 si dhe nenin 27 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”(i ndryshuar), si dhe Udhëzimin nr.16, dt.20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Në lidhje me parimin 9: *“Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.*

⁸ GMS është ngritur me Urdhër të brendshëm nr.142, datë 07.3.2024

Nga subjekti nuk janë analizuar apo marrë në konsideratë ndikimet e mundshme të riorganizimit, shtimit të njërive të reja organizative dhe/ose ndryshimet e menjëhershme të strukturave ekzistuese në sistemin e kontrollit të brendshëm.

III “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli*”.

Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, janë përcaktuar përgjegjësitë dhe ekzistojnë pjesërisht procedura të brendshme për proceset e punës (*si manuale procedurash*), procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative.

Planifikimi buxhetor për funksionimin normal të institucionit hartohet nga AS dhe dërgohet për miratim në Ministrinë e Brendshme nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimit i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga përgjegjësi i sektorit të financës, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit, ndërsa autorizimi i pagesës nga NA.

- Për prokurimet⁹ nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit të komisionit të përlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimeve/shërbimeve.

-Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planifikimit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh. Lidhur me dosjet e procedurave të prokurimeve, konstatohen mungesa e inventarizimit dhe arkivimit të dokumentacionit të procedurave të prokurimit. Mosveprime në kundërshtim me nenin 24 i Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat” nenin 21 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, si dhe nenin 16, pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili ka pasur ndryshime. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për të cilat janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit. Kjo praktikë ligjore ndiqet me qëllim ruajtjen nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

- Në përgjithësi për procedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AS, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës. Për vitet 2022 dhe 2023 ka dokumentacion për inventarizimin si: urdhrat për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe aktet e mbajtura prej tyre, si dhe urdhrat për ngritje të komisionit të vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit,

Në lidhje me parimin 11: “*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshëm të kontrollit të teknologjisë*”.

Akademia e Sigurisë zbaton rregullat e sigurisë së të dhënave të përcaktuara në Manualin e Sigurisë së Informacionit miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me nr.1237

⁹ Trajtuar hollësisht në pikën 3 të programit të auditimit “*Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik si dhe zbatimin e kontratave të lidhura për kryerjen e punimeve, blerjen e mallrave dhe shërbimeve për periudhën 2022-2023*”

prot, datë 31.8.2023 si dhe procedurat standarte të Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit, miratuar me Urdhër nr.1087, datë 15.11.2021 nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Çdo përdoruesi që fillon punë i sigurohet aksesi ne domain e email si dhe mbyllet kur largohen nga detyra. IT e Akademisë ka nje akses te limituar, vetëm për kalimet në domain, instalim programesh, të cilat shkarkohen nga faqja e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, të cilat janë të miratuara dhe të licensuara. Për cdo përdorues dërgohet shkresë ose email Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, për nivelet e aksesit të tij. Sistemi rezervë (backup) për rikuperimin e të dhënave ndodhet në serverat e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit.

IV. “Informimi dhe Komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

Në bazë të nenit 135 të Statutit të Akademisë përcaktohet se, AS-ja dhe njësiti kryesore të saj ndërtojnë dhe mirëmbajnë faqen zyrtare të internetit si mjet i informimit të publikut. Nga auditimi rezultoi se, faqen zyrtare në Web e Akademisë është në ndërtim e sipër.

Bazuar në nenin 7 të Ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, Autoriteti Publik duhet të publikojë programin e transparencës sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit si dhe kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik. Autoriteti duhet të rishikoj e përditësoj PT në çdo rast të ndryshimit të aktivitetit të tij institucional, kuadrit ligjor apo çdo element tjetër që ka lidhje me transparencën pro aktivë në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Lidhur me komunikimin e brendshëm në Akademi, me qëllim transmetimin e informacionit sipas hierarkisë, midis organeve drejtuese të çdo niveli, personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ me studentët, AS-ja ka krijuar postën elektronike si mjet komunikimi zyrtar të informacionit.

Bazuar në Statutin e Akademisë së Sigurisë kreun VII, " neni 42 "*Faqja zyrtare e internetit*", neni 43 "*Posta elektronike*", si dhe Rregullores së Akademisë së Sigurisë "*Njoftimet*", nenet 8 dhe 9 "*Njoftimet individuale*", Akademia e Sigurisë krijon dhe mirëmban postën elektronike. Nëpërmjet saj informohen dhe njihen rregullisht personeli dhe studentët/kursantët me ligjet apo aktet ligjore dhe nënligjore, nëpërmjet formatit të shtypur dhe/ose elektronikisht në faqen zyrtare të Akademisë së Sigurisë apo të njësive kryesore, apo njësive të tjera, përveç kur është i detyrueshëm njoftimi individual. Aktet ligjore, nënligjore dhe ndryshimet e tyre, konsiderohen të njohura pas afishimit në vende të posaçme dhe publikimit në faqen zyrtare të Akademisë së Sigurisë, "*Postës elektronike*", përveç kur ka detyrim për njoftim personal.

Nga subjekti nuk garantohet aksesi për informacion nëpërmjet publikimit në faqen e internetit të informacioneve që lidhen me Buxhetin e miratuar; Raportet periodike të zbatimit të buxhetit, Pasqyrat vjetore financiare; statistika mbi prokurimet; kontratat e lidhura; Raporte të Auditimit të jashtëm për njësinë mbi pasqyrat financiare dhe aktivitetin e vitit paraardhës, etj.,.

V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”

Monitorimi i punës në Akademinë e Sigurisë kryhet nëpërmjet takimeve të drejtuesve të njësive me strukturat vartëse. Raportimi realizohet sipas shkallëve të hierarkisë. Raportimet periodike për zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës si dhe analizat vjetore për aktivitetin e Akademisë. Nga subjekti u vendos në dispozicion dokumentacioni si më poshtë:

-Raport vjetor për vitin akademik 2022-2023 të miratuar me Vendimi nr.24, datë 18.01.2024 të Bordit të Administrimit, dërguar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me shkresë nr.176 prot, datë 19.01.2024.

- Analiza vjetore e Akademisë së Sigurisë për vitin 2023, dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me shkresë nr.604 prot, datë 26.02.2024 .

- Analiza vjetore e Akademisë së Sigurisë për vitin 2022, dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me shkresë nr.15 prot, datë 13.01.2023.

- Raport për veprimtarinë financiare të Akademisë së Sigurisë për vitin akademik 2022-2023, datë 29.9.2023, nga Administratori drejtuar Bordit të Administrimit.

-Program pune për veprimtarinë kërkimore –shkencore të Akademisë së Sigurisë për vitin akademik 2022-2023;

-Program pune për veprimtarinë kërkimore –shkencore të Akademisë së Sigurisë për vitin akademik 2023-2024;

-Program vjetor i punë së Akademisë së Sigurisë nr.45 prot, datë 02.02.2022, miratuar nga Drejtori/Rektori i Akademisë B. M., ku janë përcaktuar prioritetet dhe objektivat që do të arrihen gjatë vitit 2022, aktivitetet që do të ndërmerren sipas afateve të përcaktuara si dhe strukturat përgjegjëse.

-Plane mujore të Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit , miratuar nga Rektori i Akademisë.

-Plane mujore të Kolegjit të Formimit profesional të Formimit Policor të miratuara nga Rektori i Akademisë.

- Plane mujore të Qendrës së Kërkimeve Shkencore dhe Projekteve të miratuara nga Rektori i Akademisë.

Monitorimi i sistemeve të MFK realizohet gjithashtu nëpërmjet Pyetësorëve të Vetëvlerësimit për funksionimin e Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të plotësuara nga drejtuesit e strukturave të saj, Raporteve të Auditimit të Brendshëm me qëllim përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Akademi. Konstatohet se, pyetësori i vetëvlerësimit është hartuar vetëm për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, dhe mungonte plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Komunikimi dhe vlerësimi i mangësive të sistemit të kontrollit të brendshëm kryhet përmes raportimeve nga Struktura e Auditit të Brendshëm. Monitorimi i respektimit të legjislacionit apo procedurave standarte në fuqi, që rregullojnë aktivitetet buxhetore, financiare dhe ekonomike të AS-së, realizohet nëpërmjet raportimit direkt te nëpunësi autorizues nga auditimi i brendshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me qëllim marrjen e masave të duhura për përmirësimin e gjendjes dhe veprimtarisë.

Për periudhën 01.8.2021-31.12.2022 Auditimi i Brendshëm në DPPSH ka ndërmarr misionin auditimi dhe ka dërguar Raportin përfundimtar me shkresën nr.08/4 prot, datë 18.5.2023.

Gjithashtu nga Sektori i Auditit të Brendshëm është kryer auditim sipas programit me nr.102, datë 08/4.2024 për periudhën 01.01.2023 -31.3.2024 dhe hartimi i raportit përfundimtar është në proces.

Lidhur me procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe rishikimit të tij me qëllim analizimin e ecurisë së realizimit të produkteve të programit buxhetor të sistemit të Akademisë, konstatohet se, raportet 4 mujore për procesin e buxhetit përgatiten nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.

Nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, tregon se disa aspekte të tij nuk janë në nivelin e duhur dhe kërkojnë ndërmarrjen e veprimeve shtesë nga strukturat përgjegjëse me qëllim përmbushjen e objektivave institucional.

Sistemi i raportimit duhet të garantojë informacion më të plotë mbi monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj.

Sa më sipër arrihet në konkluzion:

➤ Nga auditimi i veprimtarisë së institucionit për periudhën 2022-2023 rezultoi mbivendosje e kompetencave midis Rektorit dhe Administratorit të Akademisë, pasi nga e Rektorit janë ushtruar funksione që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin. Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH nenin 39, pika 1 dhe neni 51 pika 1, Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”(i ndryshuar), Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenin 21 pika 5, Statutin e Akademisë miratuar me Urdhër të përbashkët nr.130, datë 10.3.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit si dhe Ministrit të Brendshëm neni 12 si dhe Rregulloren e Akademisë së Sigurisë, miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.77, datë 02.5.2023.

➤ Me ndryshimet e kryera përmes VKM-së nr.320, datë 02.6.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj” përcaktohet e drejta e emërimit të personelit akademik nga ana e Rektorit. Në Statutin dhe Rregulloren e brendshme të Akademisë, konkretisht në nenin 24 të Statutit dhe nenin 70, pika 5 të Rregullores së Akademisë nuk janë reflektuar ndryshimet e parashikuara sipas VKM-së së lartpërmendur. Gjithashtu nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se, gjatë vitit 2022 emërimi i personelit Akademik në Departamentin e Përgjithshëm dhe Juridik në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit është kryer me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit bazuar në Ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” nenin 9 pika 2, shkronjat “b” dhe “ç”) si dhe nenin 43, pika 4 , ku përcaktohet se: *Transferimi i punonjësit të policisë me gradën “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë”, si dhe të gjitha transferimet e punonjësve nga një strukturë në një strukturë tjetër, pavarësisht nga grada, bëhen me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.*

Por referuar strukturës së miratuar me Urdhër të brendshëm nr.5449/6, datë 26.10.2022 të Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Akademisë së Sigurisë” rezultoi se, stafi i Departamentit të Përgjithshëm dhe Juridik në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit ka statusin e personelit akademik me grada akademike ose tituj akademik si: “Doktor” Profesor” dhe “Profesor i asociuar”.

Për sa më sipër, emërimi dhe transferimi i stafit akademik që nuk kanë grada policore nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë nuk parashikohet në Ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” si dhe vjen në kundërshtim me VKM-në nr.320, datë 02.6.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj”.

-Për sa i përket personelit akademik me grada policore dispozitat e parashikuara në VKM-në nr.320, datë 02.6.2021, mbi të drejtën e Rektorit për emërimin e personelit akademik vijnë në kundërshtim me nenin 43, pika 4 , të Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” ku përcaktohet se: *Transferimi i punonjësit të policisë me gradën “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë”, si dhe të gjitha transferimet e punonjësve nga një strukturë në një strukturë tjetër, pavarësisht nga grada, bëhen me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.*

➤ Rregullorja e Brendshme e Akademisë nuk është rishikuar në përputhje me ndryshimet strukturore të kryera gjatë vitit 2023. Në përmbajtje të saj nuk ka detyra të përcaktuara qartë për

çdo sektor e seksion, konkretisht në përmbajtje të saj nuk janë përcaktuar detyrat funksionale të disa sektorëve si: Sektori i Financës, Sektori Ekonomik, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Seksioni i Sigurisë si dhe Qendra e Edukimit Fizik dhe Sporteve Elitare. Gjithashtu nuk janë parashikuar rregulla për hartimin dhe qarkullimin e akteve administrative gjatë përmbushjes së funksioneve të strukturave të brendshme të Akademisë. Mungon procedura që ndiqet për aktet administrative përpara dërgimit për firmë te Rektori/Administratori/Bordi i Administrimit si dhe procedura për dokumentet administrative hyrëse në institucion.

Në bazë të nenit 20, shkronja c, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, “ *titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit lidhur me strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit*”;

➤ Akademia e Sigurisë si institucion i arsimit të lartë nuk ka gëzuar praktikisht autonomi financiare edhe pse e drejta e përdorimit të të ardhurave garantohet në Ligjin për Arsimin e Lartë, VKM-së nr.320, datë 02.6.2021, “*Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit e saj*”, në VKM nr.54, datë 05.02.2014, “*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*”, si dhe Statutin e Akademisë. Akademia nuk ka menaxhuar të ardhura nga shërbimet që ofron. Bordi i Administrimit si organi kryesor për menaxhimin financiar dhe administrativ ka qenë në pamundësi të ushtrimit të kompetencave e tij lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore sipas nevojave të Akademisë si dhe në përcaktimin e mënyrës së përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat.

➤ Lidhur me komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit ka mangësi në disa drejtime si më poshtë:

“Mjedisi i kontrollit”

- Lidhur me projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë nuk garantohet mbikëqyrje e plotë pasi, nga nëpunësi autorizues nuk është hartuar deklarata dhe raporti i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm. Pyetësi i vetëvlerësimit është hartuar vetëm për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, dhe mungonte plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Mosveprime në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011, “*Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike*”.

Menaxhimi i Riskut

-Institucioni nuk ka krijuar mekanizmat e vlerësimit të riskut pasi, nga ana e titullarit nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, organ i cili luan një rol të rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit financiar, sistemin e saj të kontrollit të brendshëm si dhe kujdeset për performancën e njësive publike; GMS duhet të sigurojë që komponentët e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimi efektiv i risqeve janë të pranishëm dhe funksionojnë siç duhet në njësinë.

-Mungon Strategjia e Menaxhimit të Riskut, dokumenti cili përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut;

- Nga strukturat përgjegjëse nuk kryhet identifikimi dhe vlerësimi i risqeve në të gjitha nivelet e saj me qëllim arritjen e objektivave si dhe nuk është krijuar regjistri i riskut që mbulon të gjitha aktivitetet e institucionit, por vetëm regjistër risku për sektorin e financës duke sjellë si pasojë

pamundësi të monitorimit dhe kontroleve të të gjitha risqeve në nivelin e duhur. Nga ana e njësisë duhet të kryhet identifikimi, analizimi dhe vlerësimi i risqeve lidhur me kërcënimet e jashtme ndaj institucionit, aseteve e personelit të tij, si dhe dokumentimi i plotë i tyre për të gjitha strukturat e brendshme dhe vartëse të saj.

- Nuk ka evidenca të vlerësimit dhe monitorimit të riskut të mashtrimit nga niveli i lartë si dhe planit të veprimit. Mos vlerësimi në mënyrë periodike të ekspozimit të Akademisë ndaj veprimtarisë mashtruese, përbën risk për veprimtarinë e institucionit në arritjen e objektivave. Gjithashtu mungesa e sinjalizimeve sjell si domosdoshmëri ndërmarrjen e nismës nga njësia përgjegjëse për sinjalizim të brendshëm, për realizimin e aktiviteteve dhe takimeve informuese me synim sensibilizimin e punonjësve për sinjalizimin.

Mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenin 8, pika 8 shkronja b), nenin 9, nenin 11, pikat 2 dhe 3, neni 21 pika 2 si dhe nenin 27 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”(i ndryshuar), si dhe Udhëzimin nr.16, dt.20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

“Informimi dhe Komunikimi”

Nga auditimi rezultoi se, faqja zyrtare në Web e Akademisë është në ndërtim e sipër dhe për pasojë nuk përmban informacionet e detyrueshme për t’u bërë publike.

Për sa më sipër, institucioni nuk ka përmbushur detyrimet e parashikuara në nenin 7 të Ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar si dhe nenit 135 të Statutit të Akademisë.

IV. REKOMANDIME

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer është konstatuar mungesë koherence dhe harmonizimi midis kuadrit ligjor dhe atij nënligjor në fuqi. Konkretisht me ndryshimet e kryera përmes VKM-së nr.320, datë 02.6.2021, “*Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit e saj*” pika 15 ndryshohet si vijon: “*Personeli akademik me gradë policore* përzgjidhet nga radhët e punonjësve të policisë së shtetit, sipas kritereve të përcaktuara në statutin e Akademisë së Sigurisë dhe *emërohet nga Rektori me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.* Gjithashtu, *personeli akademik me gradë sipas statutit të strukturave përfituese emërohet nga Rektori* me propozim të titullarëve të strukturave përfituese sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit midis titullarit të AS dhe titullarit të strukturave përfituese. Në Statutin e Akademisë, miratuar me Urdhër të përbashkët nr.130, datë 10.3.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit si dhe Ministrit të Brendshëm si dhe në Rregulloren e brendshme të Akademisë, miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.77, datë 02.5.2023, respektivisht në nenin 24 të Statutit dhe nenin 70, pika 5 të Rregullores së Akademisë nuk janë reflektuar ndryshimet e parashikuara sipas VKM-së së lartpërmendur.

Nga administrimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se emërimi dhe transferimi i personelit akademik me grada policore në Akademinë e Sigurisë kryhet me Urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit bazuar në nenin 43, pika 4 , të Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” ku përcaktohet se: *Transferimi i punonjësit të policisë me gradën “Nënkomisar” deri*

në “Drejtues i parë”, si dhe të gjitha transferimet e punonjësve nga një strukturë në një strukturë tjetër, pavarësisht nga grada, bëhen me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

Për sa më sipër dispozitat e parashikuara në VKM-në e lartpërmendur, mbi të drejtën e Rektorit për emërimin e personelit akademik me grada policore vijnë në kundërshtim me nenin 43, pika 4 të Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” si dhe nuk gjejnë zbatim në aktet e brendshme ligjore të Akademisë si dhe në praktikën e emërimeve dhe transferimeve të personelit akademik. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 77-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Akademia e Sigurisë në bashkëveprim me Ministrinë e Brendshme të marrin masa për propozimin e ndryshimeve të VKM-së nr.320, datë 02.6.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj”, në kuadër të harmonizimit të tij me përcaktimet e Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” si dhe të sigurohet pajtueshmëria e akteve ligjore të brendshme të Akademisë me kuadrin ligjor në fuqi.

Menjëherë e në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se, gjatë vitit 2022 emërimi dhe transferimi i personelit Akademik në Departamentin e Përgjithshëm dhe Juridik në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit është kryer me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit bazuar në Ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” nenin 9 pika 2, shkronjat “b” dhe “ç”) si dhe nenin 43, pika 4, ku përcaktohet se: *Transferimi i punonjësit të policisë me gradën “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë”, si dhe të gjitha transferimet e punonjësve nga një strukturë në një strukturë tjetër, pavarësisht nga grada, bëhen me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.* Ndërkohë referuar strukturës së miratuar me Urdhër të brendshëm nr.5449/6, datë 26.10.2022 të Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Akademisë së Sigurisë” rezulton se, stafi i Departamentit të Përgjithshëm dhe Juridik në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit ka statusin e personelit akademik me grada akademike ose tituj akademik si: “Doktor” Profesor” dhe “Profesor i asociuar”.

Për sa më sipër, emërimi dhe transferimi i stafit akademik që nuk kanë grada policore nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë nuk parashikohet në Ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” si dhe vjen në kundërshtim me VKM-në nr.320, datë 02.6.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj” pasi në pikën 15 përcaktohet se: “..., **personeli akademik me gradë sipas statutit të strukturave përfituese emërohet nga Rektori** me propozim të titullarëve të strukturave përfituese sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit midis titullarit të AS dhe titullarit të strukturave përfituese”. Në Statutin e Akademisë, miratuar me Urdhër të përbashkët nr.130, datë 10.3.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit si dhe Ministrit të Brendshëm si dhe në Rregulloren e brendshme të Akademisë, miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.77, datë 02.5.2023 nuk është reflektuar ndryshimi që ka pësuar VKM-ja sa më sipër, mbi të drejtën e Rektorit për emërimin e personelit akademik. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 77-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandim: Strukturat përgjegjëse të Akademisë së Sigurisë të marrin masa për të kryer ndryshimet e nevojshme në Statutin e Akademisë me qëllim reflektimin dhe zbatimin e ndryshimeve të parashikuara në VKM-në nr.320, datë 02.6.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë

akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit e saj” lidhur me të drejtën e Rektorit për emërimin e personelit akademik me tituj/grada akademike.

Në vijimësi

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të planifikimit të buxhetit në Akademinë e Sigurisë për vitin 2022 dhe vitin 2023 u konstatuan, mangësi në planifikimin e nevojave buxhetore të institucionit. Akademia e Sigurisë plotësonte vetëm Shtojcën 1/A të PBA-së, në përputhje me shkresat dhe tavanet buxhetore të dërguara nga DPPSH, e cila nuk luan një rol proaktiv në procesin e planifikimit të buxhetit. Nisur nga praktika e ndjekur nga institucioni gjatë periudhës së auditimit rezultoi fenomeni i përsëritur nga ana e Akademisë së Sigurisë *i kërkesës për fonde shitesë për arsye të pamundësisë së mbulimit të plotë të shpenzimeve operative*. Në kushtet që AS është njësi shpenzuese më vete brenda programit buxhetor të Policisë së Shtetit, procedurat e parashikuara në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, për planifikimin dhe monitorimin e zbatimit të buxhetit ndiqen nga DPPSH, ndërsa AS kryen vetëm procedura të cilat i kërkojnë në mënyrë zyrtare nga DPPSH. Sa më sipër AS nuk ka mundësinë për të hartuar kërkesat e saj buxhetore sipas nevojave dhe nuk gëzon autonomi financiare sikurse parashikohet në ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 63 të Statutit të Akademisë së Sigurisë, miratuar me urdhër të përbashkët nr. 130 datë 10.03.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit si dhe Ministrit të Brendshëm.

Veprime në kundërshtim ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutit të Akademisë së Sigurisë, miratuar me urdhër të përbashkët nr. 130 datë 10.03.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit si dhe Ministrit të Brendshëm, neni 63. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 19-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Nga ana e Akademisë së Sigurisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit të merren masa për të kryer një proces të studiuar e të argumentuar të programimit buxhetor në të gjitha fazat e tij, në koherencë me kuadrin ligjor në fuqi për rregullimin e aktivitetit të AS.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pozicioneve vakante u konstatua se “Qendra e Edukimit Fizik dhe Sporteve Elitare” e cila përbëhet nga Shef Sektori, Seksioni i Sporteve Individuale, që ka 6 pozicione të parashikuara në strukturë dhe Seksioni i Rekreacionit, që ka gjithashtu 6 vende të parashikuara në strukturë vijon të ketë të gjitha pozicionet të paplotësuara që nga viti 2022, vit në të cilin është krijuar si strukturë e Akademisë së Sigurisë. Mosplotësimi i strukturës është në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm datë 26.10.2022, nr.5449/6 prot “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Akademisë së Sigurisë”.

2.1 Nga auditimi i strukturës së AS u konstatua se, për strukturën “Qendrën e Edukimit Fizik dhe Sporteve Elitare” nuk ka një përshkrim të mirëfilltë në rregulloren e institucionit. Shkak është mungesa e iniciativës nga ana e Akademisë së Sigurisë dhe strukturave përgjegjëse për shpalljen e vendeve vakante të institucionit dhe krijimit të një Rregulloreje të mirëstrukturuar. Veprime në kundërshtim me Rregullores së Akademisë së Sigurisë, miratuar me Vendim të Senatit të

Akademisë së Sigurisë nr.77 datë 02.05.2023, neni 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore pranë Akademisë së Sigurisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë të marrin masat e duhura procedurale për shpalljen e vendeve vakante. Gjithashtu të plotësohet Rregullorja e Brendshme e Institucionit me përshkrimet e punës për “Qendrën e Edukimit Fizik dhe Sporteve Elitare”, me qëllim që në mbledhjen pasardhëse të Senatit Akademik të miratohen ndryshimet.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit pjesë e dosjeve të personelit, u konstatua se:

- Në nëntëmbëdhjetë dosjet e personelit mungonte Librezat e Punës;
- Në tre dosje personeli mungonte raporti mjeko-ligjor;
- Në katër dosje fleta prezantuese ishte e paplotësuar dhe në 2 dosje “Lista Regjistruese e Dokumenteve” ishte e paplotësuar.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishtme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” lidhja nr. 1, pika g, pika gj, lidhja nr.2.

3.1 Në Akademinë e Sigurisë gjenden të administruara dosjet e punonjësve mbështetës të Administratës, ndërsa dosjet e punonjësve të tjerë nuk administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore të AS, por ndodheshin në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë DPPSH.

Veprime në kundërshtim me Rregulloren e Akademisë së Sigurisë miratuar me Vendim të Senatit të Akademisë së Sigurisë nr.77, datë 02.05.2023 “Të dhënat e Pozicionit të Punës të Shefit të Sektorit të Burimeve Njerëzore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore pranë Akademisë së Sigurisë të marrë masat e nevojshme për plotësimin e të gjitha dosjeve të personelit me librezat e punës, raportin mjeko-ligjor, fletën prezantuese dhe listën regjistruese të dokumenteve.

- Gjithashtu të inicohet procedurat për të pasur nën administrimin dosjet e personelit për të gjithë punonjësit e Akademisë së Sigurisë, me qëllim përditësimin e të dhënave të stafit që janë në organikën e strukturës së Akademisë së Sigurisë, për arsye transferimi, rikthimi apo lëvizje brenda strukturave, si dhe vlerësimin periodik të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listë-pagesave ndaj pedagogëve të jashtëm u konstatua se; Pagesat ndaj tyre janë trajtuar si honorare dhe jo si paga, ku është mbajtur tatim në burim në vlerën 15% dhe nuk është trajtuar dhe bashkuar bashkë me pagën e përfituesit.

Mes pedagogëve dhe AS janë lidhur kontrata pune për çdo vit akademik, si rrjedhojë ata janë të punësuar, ku nga AS duhet të ishte bërë deklarimin e tyre si të punësua për efekt të llogaritjes dhe pagesës së sigurimeve, si dhe të tatimit mbi të ardhurave tatueshme. Mosdeklarimi i tyre nga AS si të punësua, ka ndikuar dhe në mosdeklarimin/pagimin e tatimit nga dy ose më shumë punësime nga pedagogët e jashtëm.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8438 “Për Tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nenit 8, pika 1 dhe neni 13 pika 4, Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, VKM nr. 568, datë 6.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” II, pika 4, Ligjin nr. 7703, datë

11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 79 dhe neni 13 pika 1, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 119, Vendimin nr. 77, datë 28.1.2015 “Për Kontributet e Detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i Sigurimeve Shoqërore dhe Sigurimi i Kujdesit Shëndetësor”, Udhëzimit të përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Akademia e Sigurisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të policisë të marrin masat për të propozuar në Ministrinë e Brendshme përfshirjen e personelit akademik të jashtëm në strukturën e akademisë si punonjës me kontratë të përkohshme, për faktin se Akademia e Sigurisë nuk administron të ardhura të veta për deklarimin dhe pagesat e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga Akademia e Sigurisë, në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, e cila përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve nuk është kontabilizuar asnjë detyrim gjatë vitit, vlerë e cila në fund të periudhës ushtrimore duhet të ishte debituar në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasqyrën e pozicionit financiar.

Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet rezultoi se: Akademisë së Sigurisë i ka lindur detyrimi për zbatimin e Vendimit me nr. 254, datë 14.05.2019 të Gjykatës së Shkallës Pare Gjyrokastër, ti njohë paditësit S. R gradën policore Drejtues i 1 nga data 27.12.2007 e në vazhdim. Nga databaza e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, e cila ka deleguar shlyerjen e këtij detyrimit sipas vendimit të gjykatës, shuma e përlllogaritur si detyrim deri në momentin e daljes së vendimit të gjykatës ka qenë në vlerën 14,407,030 lekë. Deri me datën 31.12.2023 nga AS është paguar vlera e pagës neto prej 8,990,951 lekë.

Nga AS vlera prej 5,416,079 lekë e kreditorit nuk është njohur si shpenzim i periudhave të ardhshme në pasqyrën financiare për vitin 2023, si dhe nuk është raportuar si detyrim i prapambetur, si dhe mungon plani i shlyerjes së tij sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme” dhe Udhëzimit plotësues nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, pika 126.1 germa b.

Sa më sipër konstatohet se vendimet e proceseve gjyqësore nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42 i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022 pika 15. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Sektori i Financiar të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë të titullit ekzekutiv, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Në vijimësi

5.2 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të Akademisë së Sigurisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të marrin masa për zbatimin e përcaktimeve të vendimit gjyqësor për rikthimin kreditorit të gradës policore “Drejtues i 1”, të fituar sipas vendimit gjyqësorë.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Llogaria 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 972,560 lekë, e cila ka të bëjë me vlerën e debitorëve të trashëguar nga vitet 1996-2010 dhe për vlerën 13,155 lekë të krijuara në vitin 2016. Nga AS është bërë identifikimi i të gjithë debitorëve (si për persona fizikë dhe ish punonjës edhe subjekte juridike) sipas vjetërsisë dhe u janë dërguar disa herë shkresa zyrtare personave fizike si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Nga ana Institucionit për debitorët ish-punonjës nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e detyrimit, si rrjedhojë ky detyrim është i paarkëtueshëm, pasi ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në nenin 203 pika 1, të Kodit të Punës “Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet”, si dhe neni 115 të Kodit Civil “Parashkruhen brenda afateve prej dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë”.

- Në lidhje me detyrimet ndaj personave fizike dhe subjekteve juridike, të krijuar para vitit 2010 bazuar në Kodin Civil, neni 114 “Afatet e parashkrimit” ku përcaktohet se “Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë” dhe neni 121 “Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës” ky detyrim është i parashkruar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1 Rekomandimi: Sektori i Financës, pranë Akademisë së Sigurisë të marrë masat për sistemimin e këtyre vlerave, të cilat janë të parashkuara dhe të paarkëtueshme, me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi:

7.1 Nga auditimi i llogarisë 203 “Koncesione, Patenta, Licenca e te ngjashme” u konstatua se është kontabilizuar vlera bruto prej 150,000 lekë të programit “Financa 5” të instaluar në këtë institucion që nga viti 2006. Kjo vlerë ka të bëjë me aktive afatgjata, ku amortizimi në vite nga institucioni edhe pse është klasifikuar në llogarinë 203 është llogaritur me normën 25 % dhe jo 15%, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Klasa 2 “Aktive afatgjata” dhe pika 36, me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit.

7.2 Nga auditimi i llogarisë 213 “Ruge, rrjete, vepra ujore” u konstatua se: Nga Akademia e Sigurisë është regjistruar vlera e “truallit/tokës” së shesheve dhe rrugëve, e cila është rivlerësuar sipas VKM-së me nr. 514, datë 30.7.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin Qark të Republikës së Shqipërisë” në vlerën 52,898,979 lekë. Keq klasifikimi i regjistrimit kontabël ka bërë të mundur mbivlerësimin e llogarisë 213 “Ruge, rrjete, vepra ujore”, si dhe nënvlerësimin e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në shumën bruto prej 52,898,979 lekë, ku në vite është llogaritur amortizimi me normën 20% mbi këtë vlerë, me ndikim negativ në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit, pasi për zërin truall/tokë nuk llogaritet amortizim.

Sa më sipër, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

7.3 Nga auditimi i llogarisë 214 “Instalime, Teknike makineri, pajisje” u konstatua se:

Referuar Urdhrit të Ministrit të Brendshëm me nr. 1484, datë 23.10.2023 “Për menaxhimin me çmime të aktiveve të shërbimit të armatimeve dhe pajisjeve speciale nga njësia shpenzuese të policisë së shtetit dhe administrimi i dokumentacionit”, nga Akademia e Sigurisë është bërë vlerësimi “Poligoni Stazz”, sipas çmimeve të dërguar nga MB në vlerën totale 11,354,304 lekë, por nuk është pasqyruar në kontabilitet si rritje e aktiveve të institucionit.

Mospasqyrimi i tyre në kontabilitet është veprim në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm me nr. 1484, datë 23.10.2023, ku qëllimi i urdhrin është menaxhimi me çmimet të aktiveve të shërbimit të armatimeve dhe pajisjeve speciale, si dhe përfshirjes së vlerës së tyre në bilancin kontabël të Policisë së Shtetit, si dhe me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Klasa 2 ‘Aktive afatgjata’, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrave financiare, si dhe me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për kreditimin e llogarisë 203 “Koncesione, Patenta, Licenca e te ngjashme” në vlerën bruto 150,000 lekë dhe debitimin e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune” për të njëjtën vlerë.

Menjëherë

7.2 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve, duke debituar llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” për shumën 52,898,979 lekë dhe kredituar Llogarinë 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore” për të njëjtën vlerë.

Menjëherë

7.3 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për regjistrimin dhe pasqyrimin në kontabilitet të aktiveve të vlerësuara “Poligoni Stazz”, sipas çmimeve të dërguar nga MB në vlerën totale 11,354,304 lekë.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të kalimit të aktiveve pa pagesë, në të gjitha praktikat u konstatua se, procedura e kalimit nuk ka të bashkëlidhura urdhrin e miratimit për kalim kapitali, autorizimin e tërheqjes së aktivitetit, procesverbalin e marrjes në dorëzim (urdhri i dorëzimit të mallit mes palëve), kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga institucioni që ka bërë kalim kapitali, deri në momentin e daljes nga pronësia, ku vlera e këtyre aktiveve të transferuara janë regjistruar me vlerën historike nga institucionet përfituese, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës reale të aktiveve neto. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”. Mungesa e dokumentacioneve shoqëruese le të hapur ciklin e transferimit të kapitalit nga një institucion në tjetrin. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Akademisë së Sigurisë të marrë masa, që përpara se të bëjë reflektimin e pakësimit ose të shtesës së aktive në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të disponojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve hyrëse ose dalëse, me qëllim mbylljen e ciklit të transferimit si dhe verifikimin e reflektimit në kontabilitet të tyre.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive analitike të klasës së 2-të, përkatësisht i llogarisë 214 “Instalime, Teknike makineri, pajisje” dhe 218 “Inventar ekonomik”, u konstatua se: Në vitin 2021 është bërë vlerësimi i aktiveve për jashtë përdorimi për llogarinë 214 në vlerën 264,028 dhe për llogarinë 218 në vlerën 1,879,808. Në vitin 2022 dhe në vitin 2023 janë vlerësuar po të njëjtat aktive për dalje jashtë përdorimi, ku nga institucioni këto aktive janë mbajtur në kontabilitet si aktive në përdorim duke përlllogaritur amortizimin për vitet 2022 dhe 2023.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 103-109. Aktivët kalojnë në llogarinë 24 pasi ato janë vlerësuar për jashtë përdorimi dhe deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre mbahen nga institucioni duke bërë daljen nga Inventari i institucionit dhe mbajtjen e tyre në magazinë me një flete hyrje rikupero. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marri masa për kreditimin e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën e vlerësuar për jashtë përdorimi dhe debitimin përkatësisht të llogarisë 219 “Amortizimi i akumuluar i aktiveve afatgjata” dhe të llogarisë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi:

10.1 Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit për vitet 2022-2023 u konstatua se, një pjesë e “pajisjeve elektronike” janë klasifikuar në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe jo në llogarinë 218600 “pajisje elektronike”, ku amortizimi në vite është llogaritur me normën 20 % dhe jo 25%, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Klasa 2 “Aktive afatgjata” dhe pika 36, me ndikim në vlerën neto të aktiveve.

10.2 Nga auditimi i llogaritjes së amortizimit dhe vlerës neto të aktiveve të pasqyruara në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” u konstatua se:

Për vitin 2023, për llogarinë 218 “inventar ekonomik” nga institucioni është përlllogaritur amortizim vjetor më i lartë se vlera e aktiveve, ku si rrjedhojë vlera e amortizimit të akumuluar është më e lartë se vetë kostoja historike e aktiveve. Në kontabilitet është përlllogaritur vlera negative për njëzet e katër në shumë prej (257,867) lekë, vlerë e cila është zbritur nga gjendja e aktiveve, duke ndikuar në pasqyrimin jo real të gjendjes së tyre në kontabilitet dhe pasqyrim jo të drejtë të ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto. Ky veprim kontabël është bërë dhe për vitin 2022, ku për njëzet e katër aktiveve në kontabilitet janë pasqyruar në vlerë negative në shumë prej (323,176) lekë.

- Gjithashtu u konstatua se për të gjithë pajisjet të cilat janë bërë hyrje në vitin 2022 dhe 2023 nuk është përlllogaritur amortizimi vjetor përkatësisht për vitin në të cilën është bërë marrja në dorëzim e aktivitetit (duke e përlllogaritur atë për ditët që është bërë hyrje në atë vit), por janë pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar me koston historike.

Veprimi mësipërm është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi 2.3, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”, me ndikim material në fondet neto të institucionit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marri masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe evidentimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve, për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Menjëherë

10.2 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme të vlerave negative të pasqyruara në llogarinë 218 “inventar ekonomik”, me qëllim pasqyrimin e drejtë të gjendjes së tyre në kontabilitet dhe pasqyrim e drejtë të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Menjëherë

10.3 Rekomandimi: Sektori i Financës të marri masat për përlllogaritjen e amortizimit të aktiveve që nga momenti i bërës hyrje dhe vënies në përdorim të tyre nga institucioni, me qëllim që llogaria e aktiveve afatgjata materiale të paraqitet në vlerë të drejtë dhe e rakorduar sipas kërkesave të teknikave kontabël.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së formatit nr. 3 “cash-flow” u konstatua se pasqyra nuk është plotësuar në përputhje me shpenzimet dhe të ardhurat e realizuara gjatë vitit, por pa ndikim material në rezultatin e institucionit.

Në zërin “Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime korente (+)” është pasqyruar vlera prej 306,640,170 lekë, ndërsa sipas rakordimit me thesarin kjo shumë është në vlerën 372,784,845 lekë. Gjatë vitit nga institucioni është bërë blerje aktivesh në vlerën 928,800 lekë nga të ardhurat e trashëguara, ku në pasqyrën e “cash flow” është regjistruar si shpenzim korrent dhe jo në zërin “Për detyrime e Investime të viti ushtrimor(-)”.

Gjithashtu zëri “Rritja /Rënia neto e Mjeteve monetare” në pasqyrën e “cash flow” është paraqitur në vlerën 695,243,083 lekë, ku kjo vlerë duhet të ishte pasqyruar në vlerën (928,800) lekë, vlerë e cila reflekton ndryshimin e llogarisë 520 “Disponibilitete ne Thesar” të pasqyrës së pozicionit financiar.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, paragrafi 3.5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat që të gjitha transaksionet dhe ngjarjet të trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të inventarizimit u konstatua se, Anëtar/kryetar i komisionit i ngritur sipas urdhrin të Rektorit “Mbi inventarizimin e aktiveve fizike”, me nr. 496, datë 08.11.2022 dhe me nr. 408, datë 06.10.2023 ishte Shefi i Sektorit të Financës dhe në rolin e kryetarit të komisionit të inventarizimit qendror të inventarizimit ishte Administratori i Akademisë së Sigurisë. Përfshirja e shefit të sektorit të financës dhe Administratorit të Akademisë së Sigurisë në komisionin e inventarizimit të aktiveve dhe materialeve të institucionit është veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 82, si dhe Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 22, pika 3 germa b. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit të Akademisë së Sigurisë të marrë masa në vijimësi

për shmangien e përfshirjes së punonjësve në proceset e punës, të cilat e vendosin atë në konflikt interesi, me qëllim funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm sa më të qëndrueshëm dhe më efektiv.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga komisioni i inventarizimit për vitin 2023 është hartuar relacioni përfundimtar i inventarizimit me nr. 397, datë 07.02.2024 “Për realizimin e procesit të inventarizimit”, ku është relatuar se:

- S’ka diferenca materiale, por ka stoqe në magazinë;
- Instrumentet dhe pajisjet dentare nuk janë në funksion që nga viti 2014;
- Në lidhje me aktivet afatgjata materiale të hotelit pesë katesh. i cili është jashtë funksioni komisioni citon se aktivet si krevate janë jashtë funksioni dhe nuk riparohen;

Nga auditimi u konstatua se në procesverbal nuk ka të bashkëlidhur një listë të këtyre aktiveve të relatuara si stoqe, si jashtë funksioni apo si të dëmtuara, me vlerën përkatëse të regjistruara në kontabilitet. si dhe nuk është shprehur në lidhje me vlerësimin paraprak për cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, të cilin së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Titullarit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" paragrafi 85/c. Gjithashtu, Titullari nuk ka marrë masa për ngritjen e komisionin të vlerësimit, për vlerësimin e aktiveve, të cilat relatohen nga komisioni i inventarizimit si jo funksionale, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" paragrafi 96-99 dhe 102. Mos realizimi i vlerësimit të aktiveve nga institucioni ndikon në mos planifikimi efektiv financiar afatmesëm të nevojave të institucionit për zëvendësimin e këtyre aktiveve, qe janë në përfundim të ciklit të tyre të funksionimi.

13.2 Nga komisioni është konstatuar dhe është relatuar se në Fakultetin e Hetimit dhe Sigurisë kanë rezultuar materiale pa inventar në vlerën prej 909,500 lekë, ku është mbajtur një procesverbal me datën 06.12.2023 dhe është evidentuar lista e aktiveve dhe është bërë vlerësimi i tyre në bazë të çmimeve aktuale në inventarin faktik të institucionit dhe atij në publikimin online.

Në relacion komisioni është shprehur se këto aktive në kabinetin e Fakultetit të hetimit dhe sigurisë janë përdorur për trajnime për nevoja të Drejtorisë së emergjencave civile.

Në lidhje me krijimin e këtyre aktiveve nuk ka asnjë gjurmë auditimi, nëse janë blerë nga institucioni nëse kanë qenë donacione apo janë në pronësi të Agjencisë së Emergjencave Civile.

Nga Akademia e Sigurisë është bërë hyrje provizore/ruajtje me datën 07.12.2023 të këtyre aktiveve të vlerësuara në vlerën 909,500 lekë., por nuk janë kontabilizuar dhe pasqyruar në pasqyrën financiare të institucionit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Komisioni i Inventarizimit, i ngritura nga titullari i Akademisë së Sigurisë të marra masa në vijimësi, që në raportet e hartuara nga procesi i inventarizimit për aktivet të cilat shprehet se janë të dëmtuara të shoqërohen me listën e zërave të aktiveve dhe me vlerën e tyre në regjistruar në kontabilitet.

Në vijimësi

13.2 Rekomandimi: Akademi e Sigurisë të marra masa në vijimësi që procesi i vlerësimit dhe më pas i tjetërsimit/nxjerrjes jashtë përdorimit, të realizohen menjëherë pas procesit të inventarizimit, me qëllim identifikimin e aktiveve gjendje/funksionale që disponon institucioni, rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit që gjenerohet nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike, si dhe planifikimin sa më efektiv të fondeve të nevojshme në PBA, për blerjen e tyre në të

ardhmen.

Në vijimësi

13.3 Rekomandimi: Akademi e Sigurisë të marra masa për evidentimin e burimit të krijimit të aktiveve të vlerësuara në vlerën prej 909,500 lekë, dhe më pas nëse këto aktive do jenë në pronësi të saj të regjistruj vlerën e këtyre aktiveve sipas klasifikimeve kontabël ose nëse këto aktive janë në përdorim të merren masat për të debituar llogarinë 21 "Aktive afatgjata materiale" dhe të kreditohet llogaria 107 "Aktive të caktuara për përdorim".

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave të "Pasqyrës së Performancës" u konstatua se, në Llogarinë 602 "Blerje mallra e shërbime" janë regjistruar dhe paguar:

14.1 Për vitin 2023, rikonstruksioni i tarracës së një nga godinave në pronësi të Akademisë së Sigurisë në vlerën 490,147 lekë. Nga AS është mbajtur vlera prej 54,461 lekë si fond garancie në vlerën prej 10 %, për të cilën nuk është bërë regjistrimi në kontabilitet në llogarinë 466 "Kreditore për mjete në ruajtje" dhe nuk është deklaruar as në thesar si fond garancie, vlerë e cila do të zhbllokohet në favor të kontraktuesit pas përfundimit të periudhës së Garancisë së Defekteve. Nga AS është planifikuar/realizuar si shpenzim "Izolim tarracë në godinën e AS"; Mbikëqyrja dhe Kolaudimi i punimeve të saj, vlera e të cilave duhet të ishte planifikuar në zërin e investime kapitale dhe të kontabilizohet në rritje e vlerës së aktivitetit, referuar Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin punimeve të ndërtimit" pika 1; pika 2, si dhe Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë së qeverisjes së përgjithshme" Klasa 2 "Aktivet Afatgjata".

14.2 Për vitin 2022, nga AS është bërë blerje e tre bolierëve në shumën 46,776 lekë; 20 copë tastiera me USB në vlerën 13,440 lekë dhe një copë USB DVD në vlerën 2,560 lekë, për të cilat janë bërë regjistrimi i tyre si mall konsumi dhe jo si aktive afatgjata aktive në llogarinë 214 "Instalime, Teknike makineri, pajisje",

Sa më sipër, veprime në kundërshtim me Udhëzimit e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Klasa 2 "Aktive afatgjata", me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës së "Izolim tarracë në godinën e AS" dhe "Mbikëqyrja dhe Kolaudimi i punimeve" duke debituar llogarinë 212 "Ndërtesa e Konstruksione", si dhe kreditimin e vlerës së prej 54,461 lekë si fond garancie të mbajtur në llogarinë 466 "Kreditore për mjete në ruajtje".

Menjëherë

14.2 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke debituar llogarinë 214 "Instalime, Teknike makineri, pajisje" përkatësisht për vlerat 46,776 lekë dhe 16,000 lekë.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për vitin 2022 u konstatua se nga AS janë realizuar pagesa në lidhje me projektin "Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përbalimin e emergjencave civile" në shumën prej 709,796 lekë, financuar nga AKKSHI, sipas Kontratës së lidhur nr. 800 prot., datë 22.09.2021 mes AS dhe AKKSHI në vlerën prej 2,000,000 lekë.

Raporti përfundimtar i projektit tek AKKSHI "Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve

nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përbalimin e emergjencave civile” është dërguar me shkresë nr. 623/2 datë 25.05.2023, pas rekomandimeve të lëna nga auditi i brendshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dërguar me shkresë nr.08/4, datë 18.05.2023. Në pasqyrën financiare rezultoi se në Llogarinë 475 "Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhëse" është mbajtur vlera prej 1,290,233 lekë, e cila përfaqëson vlerën e pa shpenzuar të projektit “*Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përbalimin e emergjencave civile*”, financuar nga AKKSHI. Nga drejtuesit e projektit është kërkuar për tu rimbursuar dhe shuma prej 772,554 lekë, ku nga Akademia Sigurisë nuk është marrë asnjë masë për analizimin e shpenzimeve të papaguara, me qëllim përfundimin dhe finalizimin e projektit sipas kushteve të kontratës.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Kontratën e lidhur nr. 800 prot., datë 22.09.2021, si dhe konkluzioneve dhe rekomandimeve të AKKSHI, në seksionin C, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandimi: Akademia e Sigurisë të marrë masë për analizimin e shpenzimeve të papaguara bazuar në dokumentacionet vërtetuese, si dhe më pas të marrë masa për likuidimin e shumë ndaj anëtarëve të projektit ose kthimin e vlerës së mbetur nga projekti në buxhetin e shtetit.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi:

16.1 Nga auditimi i rimbursimit të shpenzimeve dieta për vitin 2022 dhe vitin 2023 u konstatua se:

- Tek urdhër shërbimi dieta janë përlllogaritur edhe shpenzimet bazuar në biletat e udhëtimit të transportit, vlerë e cila nuk është përlllogaritur bazuar në VKM-në me nr. 146, datë 26.2.1998 “Për tarifat e transportit të udhëtarëve”, i ndryshuar, por është marrë vlera e përcaktuar në biletat e dorëzuar nga personi udhëtues, ku kilometrat e përcaktuar në biletë nuk përputhen me itinerarin e autorizuar.

- Në dy raste tek urdhër shërbimi dieta janë përlllogaritur shpenzimet e transporti bazuar në bileta taksi veture.

- Në tetë raste tek urdhër shërbimi dieta janë përlllogaritur shpenzimet e transportit, ku biletat e dorëzuara mbi të cilën është rimbursuar vlera e transportit nuk kanë të përcaktuar itinerarin dhe datën e lëvizjes.

Sa më sipër vlera e rimbursuar është në kundërshtim me VKM-në nr. 146, datë 26.2.1998, “Për tarifat e transportit të udhëtarëve”, i ndryshuar; VKM-në nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” pika 4; Urdhrin e Ministrit të MIE nr. 48, datë 7.4.2023 “Për miratimin e distancave kilometrike ndërmjet qyteteve të Republikës së Shqipërisë dhe hartës së përditësuar të rrjetit rrugor kombëtar”; Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nenin 4, pika 26; Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 35, germa b.

16.2 Nga auditimi i urdhër shërbimeve për vitin 2022 dhe vitin 2023 u konstatua se:

Për 20 raste për vitin 2022 dhe 5 raste për vitin 2023, përlllogaritje të gabuar të dietave ditore, si dhe mosrespektim të kufirit prej 500 lekë për dietë ditore për udhëtimet brenda ditës mbi 50 km. Veprime në kundërshtim me VKM-në nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” pike 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandimi: Sektori i financës të marrë masa në vijimësi që të zbatojë me rigorozitet rregullat, procedurat dhe dokumentimin e shpenzimeve dieta brenda vendi, në lidhje me rimbursimin e transporti bazuar në itinerarin e përcaktuar në autorizim, si dhe kryerjen e pagesave

për dieta ditore brenda vendit sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi:

17.1 Nga auditimi i pasqyrës së lëvizjes së mjetit për periudhën e vitit 2022 dhe vitit 2023 u konstatua se:

- Në pasqyrën e lëvizjes në muajin Mars 2022, për një mjeti është përshkruar destinacioni i lëvizjes së tij, i cili ka lëvizur jashtë Tirane, por për asnjë nga lëvizjet nuk janë vënë KM e përshkruara.

- Në pasqyrën e lëvizjes së mjeteve për vitin 2023, për dy mjete në muajin Tetor 2023, katër mjete në muajin Nëntor 2023 dhe tre mjete në muajin Dhjetor 2023, nuk janë përshkruar destinacionin e lëvizjes së mjetit, nuk janë vënë KM e përshkruara, por vetëm është shënuar AS-lëvizje-AS.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Nenin 4, pika 19; Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 35, germa b dhe pika 36; si dhe rregulloren “Për Menaxhimin e mjeteve të Policisë së Shtetit” neni 13 “Administrimi dhe mirëmbajtja e automjeteve në përdorim të Aparatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit” pika 10.

17.2 Nga auditimi i konsumimit të karburantit për kaldajat dhe gjeneratorët u konstatua se: nga Akademia e Sigurisë nuk është verifikuar gjendja e lëndës djegëse në cisternat e karburantit në fund të çdo sezoni të ngrohjes për secilën nga kaldajat dhe gjenerator në përdorim dhe nuk është pasqyruar niveli i lëndës djegëse në depozitat e tyre. Mungesa e gjurmë auditimi se sa ka qenë gjendja në cisternat e karburant te tyre në çdo fillim viti ose në përfundim të sezonit, ndikon në pamundësinë e verifikimit të rregullshmërisë së kryerjes së shpenzimit për përdorimin karburant në kaldajat dhe gjeneratorët. Veprimet në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36, 74 dhe pika 122. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Sektori Ekonomik të marrë masa në vijimësi, që përpara se të hartohet pasqyrat përmbledhëse të konsumit mujor të karburantit dhe mbylljes së muajit për çdo targë të verifikohet që pasqyra e lëvizjes së mjetit të jetë i plotësuar me të gjithë elementet e saj.

Në vijimësi

17.2 Rekomandimi: Akademia e Sigurisë të marrë masa në vijimësi, që gjatë procesit të inventarizimit të verifikohet gjendja e lëndës djegëse në cisternat e karburantit për secilën nga kaldajat dhe gjeneratorët në përdorim të saj.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi:

18.1 Nga auditimi i procedurës me objekt “Blerje materialë izoluese” të realizuar në vitin 2022 u konstatua se në urdhrin e prokurimit dhe ftesën për ofertë, për disa zëra të prokuruar është përdorur emri i markës “Schneider”.

- Në procedurën me objekt “Blerje Barna Mjekësore” të realizuar në vitin 2022 dhe në vitin 2023 u konstatua se, në urdhrin e prokurimit dhe në ftesën për ofertë AK për 43 barna të prokuruar në procedurën e vitit 2022 dhe për 33 barna në procedura e vitit 2023 është kërkuar medikamenti me emrin tregtar dhe jo me principin aktiv të medikamentit.

Sa më sipër, veprime në kundërshtim me LPP nr. 162, datë 23.12.2020, neni 36, pika 4.

18.2 Nga auditimi i procedurës me objekt “Rimbushje fikësi zjarri” të realizuar në vitin 2022 dhe në vitin 2023 u konstatohet se: OE nuk ka dorëzuar certifikatat e garancisë dhe certifikatën e prodhuesi/origjine, siç janë kërkuar në specifikimet teknike në ftesën për ofertë.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 82, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 73-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël të marrë masa në vijimësi, që çdo kriter i veçantë të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, si dhe kriteret e kërkuara të hartohen në mënyre jo diskriminuese apo orientuese, me qëllim të sigurojë trajtim të barabartë të OE, si dhe të nxitë pjesëmarrjen dhe konkurrencën ndërmjet tyre.

Në vijimësi

18.2 Rekomandimi: Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël gjatë vlerësimit të ofertave të procedurave prokuruese, të merren masa për eliminimin e praktikave të prokurimit me shkelje ligjore, dhe të shpallura fituese në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara në ftesën për ofertë, me qëllim përdorimin me efience dhe efektivitet e fondeve publike.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrit të parashikimit dhe të realizimit të procedurave të prokurimit dhe arkivimit të tyre në SPE, u konstatua se:

Regjistrat e parashikimit nuk janë përgatitur, sipas afatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021 të APP-së, pika 3 ku citohet se “Regjistri i parashikimit të procedurave të prokurimit duhet të përgatitet nga AK jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës” përkatësisht me “Ligjimin e buxhetit nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” botuar në fletoren zyrtare nr.197 datë 21.12.2021 dhe “Ligjin e buxhetit nr. 84, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023” botuar në fletoren zyrtare nr.171 datë 21.12.2022.

- Regjistrat e realizimit nuk janë të plotësuara me të gjithë procedurat e realizuara gjatë vitit 2022 dhe vitit 2023, kjo si rezultat i mos arkivimit të procedurave në SPE, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 30.07.2021 “Për Mënyrën e zhvillimit të procedurave të procedurave të prokurimit me mjete elektronike” pika 3.11; Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021 Kreu II, pika 1, si dhe me pikën 3 të nenit 16 të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

- Në regjistrin e vitit 2022 dhe 2023 mungojnë elementët, tipi i kontratës: mall/shërbim punë/marrëveshje kuadër, minikontrata, i cili është kërkesë sipas Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021 të APP-së.

--Procedura, të cilat janë realizuar nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara nga Akademia e Sigurisë janë lidhur kontratat e realizimit të mallrave/shërbimeve nuk janë pasqyruar në regjistrin e realizimit, pasi nga AS nuk janë lidhur minikontrata, veprime në kundërshtim të Kreut II, të Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021, pika 2. Grupi i auditimit i konstaton këto vlera të realizuar, por të pa pasqyruara në regjistrin e prokurimeve, nga analiza e shpenzimeve në ditarin e bankës, për periudhën objekt auditimi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 73-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1 Rekomandimi: Nga personat përgjegjës për prokurimet në Akademinë e Sigurisë të merren masat e arkivimit të procedurave të prokurimit në SPE, si dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit sipas afateve ligjore në fuqi dhe përditësimin e regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit me të gjithë elementet e parashikuara.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së institucionit për periudhën 2022-2023 rezultoi mbivendosje e kompetencave midis Rektorit dhe Administratorit të Akademisë, pasi nga Rektori janë ushtruar funksione që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin. Konkretisht:

Rektori i AS-së ka nxjerr Urdhrat e Prokurimit deri në datë 01.7.2022 në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, si dhe ka nënshkruar urdhër shpenzimet deri në datë 05.4.2023. Gjithashtu, për periudhën objekt auditimi Rektori i Akademisë ka nënshkruar urdhër shërbimet në cilësinë e urdhëruesit të shërbimit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH nenin 39, pika 1 dhe neni 51 pika 1, Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”(i ndryshuar), Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenin 21 pika 5, Statutin e Akademisë miratuar me Urdhër të përbashkët nr.130, datë 10.3.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit si dhe Ministrisë të Brendshme neni 12 si dhe Rregulloren e Akademisë së Sigurisë, miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.77, datë 02.5.2023. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 77-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1 Rekomandim: Nga ana e Titullarit Akademik (*Rektori*) dhe Titullarit të Autoritetit Kontraktor (*Administratorit*), të vazhdohet koordinimi dhe bashkëpunimi pa mbivendosje kompetencash, në zbatim të dispozitave ligjore mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Statutin e Akademisë si dhe Rregulloren e Akademisë së Sigurisë.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Akademia e Sigurisë si institucion i arsimit të lartë nuk gëzon praktikisht autonomi financiare. Të gjithë të ardhurat e arkëtuara nga AS i derdh në buxhet, edhe pse e drejta e përdorimit të të ardhurave garantohej në Ligjin për arsimin e lartë, VKM-në nr.320, datë 02.6.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj”, në VKM nr.54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si dhe Statutin e Akademisë. Akademia nuk ka menaxhuar të ardhura nga shërbimet që ofron. Bordi i Administrimit si organi kryesor për menaxhimin financiar dhe administrativ ka qenë në pamundësi të ushtrimit të kompetencave e tij lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore sipas nevojave të Akademisë si dhe në përcaktimin e mënyrës së përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 77-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1 Rekomandim: Akademia e Sigurisë si njësi shpenzuese më vete, të bashkërendojë punën me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë për propozimin në Ministrinë e Financave të miratimit të një akti nënligjor për lejimin e përdorimit të të ardhurave të krijuara nga AS-ja si institucion publik i arsimit të lartë, me qëllim përdorimin e tyre për realizimin e shërbimeve të cilat nuk planifikohen në planin vjetor të buxhetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Rregullorja e Brendshme e Akademisë nuk është rishikuar në përputhje me ndryshimet strukturore të kryera gjatë vitit 2023. Në përmbajtje të saj nuk ka detyra të përcaktuara qartë për çdo sektor e seksion. Konkretisht nuk janë përcaktuar detyrat funksionale të të Sektorit të Financës, Sektorit Ekonomik, Sektorit të Burimeve Njerëzore, Seksionit të Sigurisë si dhe të Qendrës së Edukimit fizik dhe Sporteve Elitare. Gjithashtu nuk janë parashikuar rregulla për hartimin dhe qarkullimin e akteve administrative gjatë përmbushjes së funksioneve të strukturave të brendshme të Akademisë. Mungon procedura që ndiqet për aktet administrative

përpara dërgimit për firmë te Rektori/Administratori/Bordi i Administrimit si dhe procedura për dokumentet administrative hyrëse në institucion.

Veprime në kundërshtim të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, nenin 20, shkronja c. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 76-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1 Rekomandim: Nga strukturat përgjegjëse të Akademisë së Sigurisë të merren masa për rishikimin e rregullores së brendshme të saj me qëllim përcaktimin e detyrave funksionale të të gjithë sektorëve dhe strukturave që nuk janë përfshirë.

-Përcaktimin e rregullave të brendshme mbi procedurën që ndiqet për aktet administrative përpara dërgimit për miratim/aprovim te Rektori/Administratori/Bordi i Administrimit si dhe procedurën për dokumentet administrative hyrëse në institucion.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2022-2023, nga Akademia e Sigurisë nuk janë përcaktuar strukturat dhe mekanizmat për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin efektiv të risqeve pasi nuk ishte ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik. Mungonte Strategjia e Menaxhimit të Riskut, dokumenti që përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Nga strukturat përgjegjëse nuk kryhet identifikimi dhe vlerësimi i risqeve në të gjitha nivelet e saj me qëllim arritjen e objektivave si dhe nuk është krijuar regjistri i riskut që mbulon të gjitha aktivitetet e institucionit, por vetëm regjistër risku për sektorin e financës duke sjellë si pasojë pamundësi të monitorimit dhe kontroleve të të gjitha risqeve në nivelin e duhur. Nëpunësi autorizues i Akademisë, në rolin e Koordinatorit të MFK-së nuk ka përmbushur detyrimin e përgatitjes dhe nënshkrimit të deklaratës dhe të raportit vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2022 dhe 2023 bazuar në nenin 18 të Ligjit të MFK.

- Nuk ka evidenca të vlerësimit dhe monitorimit të riskut të mashtrimit nga niveli i lartë si dhe planit të veprimit. Mos vlerësimi në mënyrë periodike të ekspozimit të Akademisë ndaj veprimtarisë mashtruese, përbën risk për veprimtarinë e institucionit në arritjen e objektivave. Gjithashtu mungesa e sinjalizimeve sjell si domosdoshmëri ndërmarrjen e nismës nga njësia përgjegjëse për sinjalizim të brendshëm, për realizimin e aktiviteteve dhe takimeve informuese me synim sensibilizimin e punonjësve për sinjalizimin.

Mos veprimet e mësipërme mbi komponentin e menaxhimit të riskut, bien në kundërshtim me nenin 8, pika 8 shkronja b), nenin 9, nenin 11, pikat 2 dhe 3, neni 21 pika 2 si dhe nenin 27 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”(i ndryshuar), si dhe Udhëzimin nr.16, dt.20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

-Gjithashtu nga auditimi rezultoi se, faqja zyrtare në Web e Akademisë është në ndërtim e sipër dhe për pasojë nuk përmban informacionet e detyrueshme për t’u bërë publike. Institucioni nuk ka përmbushur detyrimet e parashikuara në nenin 7 të Ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”i ndryshuar si dhe nenit 135 të Statutit të Akademisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 76-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1 Rekomandim: Menaxherët e të gjitha strukturave të AK-së, të kryejnë identifikimin dhe plotësimin e regjistrit institucional të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave. - Institucioni i AS-së të rishikojë çdo vit Regjistrin e Risqeve kryesore dhe kontroleve përkatëse si dhe të miratojë planin e veprimit për minimizimin e tyre.

Në vijimësi

23.2 Rekomandim: NA/KR të marrë masa për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut dhe miratimin e saj nga GMS, në përputhje me prioritetet dhe qëllimet afatmesme e afatgjata bazë që ka ky institucion.

Në vijimësi

23.3 Rekomandim: Nëpunësi Autorizues të marrë masë që çdo vit të realizojë vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe të hartojë deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Akademisë.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të kontratës së shërbimit me nr. 2667 prot., datë 30.11.2023, lidhur midis AK/Akademia e Sigurisë dhe Operatorit Ekonomik OE “...” ShPK për objektin “*Izolim tarrace në godinat e AS*” u konstatuan disa pasaktësi si: Mungesë të certifikatave dhe skeda teknike për materialet e përdorura; Mungesë të miratimi të materialeve të përdorura në objekt; Mosrealizimi i provës teknike me ujë për rrjedhje të tarracës; Mungesa e skicave dhe vizatime teknike për librezat e masave, Mungesa e ditarit teknik, Mungesa e relacionit përfundimtar i mbikëqyrësit dhe korrespondenca të ndryshme etj. Sa më sipër veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar. Kreu III, neni 7. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 73-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

24.1. Rekomandimi: Akademia e Sigurisë të marrë masa të menjëhershme, që me specialistët e fushës, të cilët në bashkëpunim me Mbikëqyrësin dhe Kolaudatorin e objektit të analizojnë mangësitë e konstatuara në objektin “*Izolim tarrace në godinat e AS*”, si dhe të marrë masa që në të ardhmen objektet të merren në dorëzim të shoqëruara me dokumentacion të plotë tekniko-ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” neni 15, germa b) dhe c) “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*” dhe mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*”, pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, nga ana e Titullarit të njësisë publike Akademia e Sigurisë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësish, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,704,864 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:

1.1 Nga auditimi i zbatimit të kontratës me nr. 1752, datë 26.08.2022 me objekt “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering) për Akademinë e Sigurisë*” në vlerë totale 247,967,144 lekë, për 36 muaj, u konstatua se:

Marrëveshja kuadër nr.150/6 prot, datë 19.8.2022 lidhur ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara si organ qendror blerës dhe operatorit ekonomik “S.” ShPK përcakton kushtet dhe rregullat për kryerjen e shërbimit me objekt: “*Shërbim gatimi dhe*

shpërndarje ushqimi për Akademinë e Sigurisë”, ku AK në emër dhe për llogari të të cilit është lidhur marrëveshja kuadër është Akademia e Sigurisë. Si rrjedhojë nuk mund të bëhen pjesë e një marrëveshje kuadër autoritetet/entet kontraktore, të cilat nuk janë palë e marrëveshjes kuadër që në publikimin e saj.”

Referuar dokumentacionit të administruar në lidhje me realizimin e kontratës, Akademia e Sigurisë ka ofruar “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering)” për Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë së Shtetit, e cila është njësi shpenzuese me vetë në varësinë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. Për Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë deri me datën 31.12.2023 është paguar vlera e shërbimit të kateringut në shumën prej 1,704,864 lekë pa TVSh, vlerë e cila është pakontraktuar, është jashtë parashikimeve të kushteve të kontratës dhe vlerave të parashikuara në marrëveshjen kuadër.

Veprim në kundërshtim me LPP 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Kreu XV nga neni 122 e vijues si dhe me VKM-në me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 60 pika 2; neni 64, pika 2; neni 107, pika 7.

1.2 Nga auditimi i marrjes në dorëzim të ushqimit nga IPQP, u konstatuan parregullsi dhe mangësi në procedurat e menaxhimit dhe kontrollit të ushqimit të dorëzuar dhe të marrë në dorëzim pasi:

- Ushqimi në IPQPSH shërbehet nga OE në basketa, i cili bëhet gati në ambientet e Akademisë së Sigurisë. Bashkëlidhur praktikës së shpenzimit të realizuar kishte vetëm Akt rakordimin e bërë nga IPQPSH, kundër firmosur nga OE, ku mungonte fletë dalje ditore provizore, regjistrimi i racioneve në “Libër procesverbal ushqimi”, si dhe procesverbalet e marrjes në dorëzim të ushqimit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Bazuar në kontratën, pritja dhe marrja në dorëzim e mallit është detyrë funksionale e Akademisë së Sigurisë.

Veprime në kundërshtim me Kontratën me nr. 1752, datë 26.08.2022 neni 32, me urdhrin e Rektorit të AS me nr. 405, prot., 2130, datë 05.10.2022 “Për mënyrën e funksionimit, pranimit, administrimit kontrollit dhe zbatimit të kontratës së “Shërbim gatimi dhe Shpërndarjes së ushqimit” pika 4 dhe 5; Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Titullari i Akademisë së Sigurisë në bashkëveprim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë të marrin masa të menjëhershme për nxjerrjen e përgjegjësive të nëpunësve, të cilët kanë kryer veprime në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore, duke përfshirë dhe paguar një shpenzim në vlerën prej **1,704,864 lekë** për interes të një njësie tjetër shpenzuese, të pakontraktuar, të paparashikuar në kushtet të kontratës dhe e papërfshirë si palë në marrëveshjen kuadër që në publikimin e shërbimit.

Menjëherë

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 24/1 datë 12.12.2022 me objekt “Për blerje uniformash dhe elementesh të tjerë përbërës të tyre” në vlerën totale 1,820,100 lekë, OE fitues ka deklaruar në ofertën e paraqitur në tender se mallrat do të jenë të prodhuara nga subjekti “P.” Ltd me vend origjinë në Irlandë me distributor për shitjen e tyre nga OE “E.” SHPK. Zbatimi i kësaj kontrate është realizuar nëpërmjet dy furnizimeve, të datës 28.12.2022 dhe datës

30.10.2023, respektivisht për furnizimin me 250 kostume dimërore dhe 250 kostume verore në vlerën prej 988,500 lekë dhe të 330 kostumeve dimërore në vlerën prej 831,600 lekë.

Nga shqyrtimi i marrjes në dorëzim të mallrave dhe ekzaminimi i mallrave gjendje në magazinë është evidentuar se nuk janë në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret e vlerësimit, ndërkohë që nga Komisioni i marrjes në dorëzim të tyre është cilësuar se: “Mallrat e dorëzuara nga OE janë konform specifikimeve të kërkuara”. Mospërputhja e specifikimeve teknike ka konsistuar në: përbërjen e materialit; dizajnin dhe mënyrën e paketimit, si dhe mallrat furnizuara nuk janë të prodhuara nga “P.” Ltd me vend origjinë në Irlandë, kjo e vërtetuar edhe nga mungesa e certifikatës së origjinës së mallit.

Veprime në kundërshtim me Kontratën nr. 24/1 datë 12.12.2022, neni 2; Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” nenin 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”; VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës” pika 7; Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Titullari i Akademisë së sigurisë të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive ndaj Komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave, të cilët duke i pranuar ato në kundërshtim me specifikimet e përcaktuara në kontratë kanë çenuar cilësinë e mallrave, si dhe kanë shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën **1,820,100 lekë**.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 04/2 datë 08.04.2022 me objekt “Për blerje këpucë, atlete sportive” në vlerë totale 1,969,408 lekë, OE fitues ka deklaruar në ofertën e paraqitur ne tender se mallrat do të jenë të prodhuara nga subjekti “P.” Ltd me vend origjinë në Irlandë. Zbatimi i kësaj kontrate është realizuar nëpërmjet tre furnizimeve, përkatësisht:

Me datën 15.04.2022 për furnizimin me 172 këpucë atlete në vlerën 445,824 lekë; me datën 09.12.2022 për furnizimin me 217 këpucë atlete në vlerën prej 554,176 lekë dhe me datën 24.10.2023 për furnizimin me 374 këpucë atlete në vlerën prej 831,600 lekë.

Nga shqyrtimi i marrjes në dorëzim të mallrave dhe ekzaminimi i mallrave gjendje në magazinë është evidentuar se nuk janë në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret e vlerësimit, ndërkohë që nga Komisioni i marrjes në dorëzim të tyre është cilësuar se: “Mallrat e dorëzuara nga OE janë konform specifikimeve të kërkuara”.

Nga OE për të dy furnizimet është vënë në dispozicion raporti i testimit i lëshuar me datën 27.01.2022 ku është përcaktuar se “*këpucë atlete faqet kombinuar lëkurë natyrale dhe tekstile rrjetë 30%, gomë e bute tabani i atleteve poroz dhe i trashë*”. Raport testimi i realizuar nga Laboratori fiziko mekanik dhe kimik i tekstit dhe lëkurës, është realizuar mbi kampione përpara se: të realizohej procedura e prokurimit dhe të shpallej fitues OE, si dhe fletë-analiza e dorëzuar nga OE nuk është e vërtetuar se mbi çfarë produktesh është kryer dhe nëse përputhet me produktet e dorëzuar nga OE për realizimin e kontratës.

Mospërputhja e specifikimeve teknike ka konsistuar në: dizajnin, mënyrën e paketimit, si dhe mallrat furnizuara nuk janë të prodhuara nga “P.” Ltd me vend origjinë në Irlandë, pasi atletet kishin të shënuar prodhimin made in Vietnam, si dhe nuk kishte asnjë certifikatë të konformitetit CE.

Veprime në kundërshtim me Kontratën 04/2 datë 08.04.2022, neni 2; Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” nenin 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”; VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës” pika 7; Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit

Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Titullari i Akademisë së Sigurisë të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive ndaj Komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave të cilët duke i pranuar ato në kundërshtim me specifikimet e përcaktuara në kontratë kanë çenuar cilësinë e mallrave, si dhe kanë shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën **1,969,408 lekë**.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me nr. 1752, datë 26.08.2022 me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering) për Akademinë e Sigurisë” në vlerë totale 247,967,144 lekë, për 36 muaj, nga kryqëzimi i procesverbaleve të mbajtura nga komisioni pranimit të mallit për çdo ditë /vakt në “Libër procesverbal ushqimi” me fletë daljet ditore të ushqimit u konstatua se:

a) Për 24 (njëzet e katër) raste, në vitin 2022 në vlerën 2,498,669 lekë dhe 74 (shtatëdhjetë e katër) raste në vitin 2023 në vlerën 6,700,125 lekë në procesverbalet e mbajtura nuk janë shënuar numri i vakteve të marrë në dorëzim.

b) Për 6 (gjashtë) raste, në vitin 2022 në vlerën 8,521 lekë dhe 38 (tridhjetë e tetë) raste në vitin 2023 në vlerën 133,110 lekë nuk janë mbajtur procesverbalet e marrjes së vakteve në dorëzim, si dhe nuk janë të raportuara në librin e dorëzimit të ushqimit, por praktika ka të bashkëlidhur vetëm fletë daljen.

c) Për dy raste, në vitin 2022 në vlerën 15,520 lekë dhe 7 (shtatë) raste në vitin 2023 në vlerën 94,856 lekë rezultuan diferenca midis procesverbaleve të mbajtura dhe fletë daljeve, ku në fletë dalje ka më shumë racione, sesa racione të marrë në dorëzim sipas procesverbalit ditor të mbajtur. Sa më sipër, u konstatua parregullsi dhe mangësi në procedurat e menaxhimit dhe kontrollit të ushqimit të dorëzuar dhe të marrë në dorëzim nga Akademia e Sigurisë, veprime të cilat janë në kundërshtim me Kontratën me nr. 1752, datë 26.08.2022 neni 32, me urdhrin e Rektorit të AS me nr. 405, prot., 2130, datë 05.10.2022 “Për mënyrën e funksionimit, pranimit, administrimit kontrollit dhe zbatimin e kontratës së "Shërbim gatimi dhe Shpërndarjes së ushqimit" pika 4 dhe 5; Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 36.

- Nga auditimi u konstatua se bashkëlidhur praktikave nuk ka asnjë gjurmë të shpërndarjes së bonove të ushqimit, siç është përcaktuar në nenin 12 “Forca e përditshme e ushqimit” pika 12.5 si dhe me urdhrin e Rektorit të AS me nr. 405, prot., 2130, datë 05.10.2022 “Për mënyrën e funksionimit, pranimit, administrimit kontrollit dhe zbatimin e kontratës së "Shërbim gatimi dhe Shpërndarjes së ushqimit" pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Titullari i Akademisë së Sigurisë të marrë masa të menjëhershme për nxjerrjen e përgjegjësive të Komisionit të pritjes dhe kolaudimit në shërbimin e ushqimit, i cili nuk ka zbatuar një sërë kushtesh të kontratës, procedurat e përcaktuara për ndjekjen e zbatimit të kësaj kontrate, si dhe nuk ka lënë gjurmë auditimi mbi procedurat e kryera duke krijuar premisa për abuzim me fondet publike, ku për rastet e mësipërme, për të cilat është bërë e mundur përlllogaritja e tyre rezultojnë në shumën **9,450 mijë lekë**.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të studentëve të realizuar gjatë vitit 2022 dhe vitit 2023 u konstatua se: Në kuadër të projektit të nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë me Akademinë e Policisë në Turqi, nga Akademia e Sigurisë janë dërguar pesë studentë të kryejnë

trajnim pranë kësaj akademie bazuar në Urdhrin nr.1016 datë 05.11.2021 nr.6383/4 prot., “Për ndjekjen e studimeve në Akademinë e Policisë në Turqi”. Përgjatë 8 muajve të praktikës, 5 studentët janë paguar 8,000 lekë/muaj secili, me vlerën e kursantëve që pranohen në “Kolegjin e Policisë”, duke e çuar shumën në 320,000 lekë gjithsej, nga buxheti i *Akademia e Sigurisë*.

Veprime në kundërshtim me VKM nr.200 datë 15.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Policisë së Shtetit” i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë Akademisë së Sigurisë në bashkëpunim me organet përgjegjëse të DPPSH të marrin masat e nevojshme për analizimin dhe justifikimin e pagesave të kursantëve të trajtuar me pagesë në Akademinë e Policisë në Turqi, me qëllim shmangien e pagesave nga fondet buxhetore të pajustificuara ligjërisht.

Menjëherë dhe në vijimësi

E. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara në zbatimin e kontratës me nr. 24/1, datë 12.12.2022 me objekt “Për blerje uniformash dhe elementesh të tjerë përbërës të tyre” në vlerën totale 1,820,100 lekë dhe me nr. 04/2, datë 08.04.2022 me objekt “Për blerje këpucë, atlete sportive” në vlerë totale 1,969,408 lekë, OE fitues “G. S.”, të pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenin 23 dhe 132 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizim in dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljen e konstatuar, me qëllim marrjen e masave ndaj OE, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 129, “Procedura e hetimit administrativ” pika 1, gërma “ç”.

F. MASA DISIPLINORE:

a. Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 gërmat (b,c,ç); Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu IV, neni 11, shkronja “c” dhe “e” dhe neni 37; “Rregulloren e Policisë së Shtetit”, miratuar me VKM-në nr.750, datë 16.09.2015, i ndryshuar, Pjesa e V, Rregulla për Disiplinën, Kreu I “Shkeljet disiplinore dhe klasifikimi i tyre” si dhe të kontratën individuale të punës , i rekomandojmë Titullarit të Akademisë së Sigurisë, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

1. Znj. Sh. G., me detyrë Specialiste e Shërbimeve Ekonomike, në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim, për mangësitë e konstatuara në zbatimin e kontratës nr. 24/1 datë 12.12.2022 me objekt “Për blerje uniformash dhe elementesh të tjerë përbërës të tyre” në vlerën totale 1,820,100 lekë dhe zbatimit të kontratës nr. 04/2 datë 08.04.2022 me objekt “Për blerje këpucë, atlete sportive” në vlerë totale 1,969,408 lekë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2. Znj. L. D., me detyrë Specialiste e Shërbimeve Ekonomike, në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim, për mangësitë e konstatuara në zbatimin e kontratës nr. 24/1 datë 12.12.2022 me objekt “Për blerje uniformash dhe elementesh të tjerë përbërës të tyre” në vlerën totale 1,820,100 lekë; të zbatimit të kontratës nr. 04/2 datë 08.04.2022 me objekt “Për blerje këpucë, atlete sportive” në

vlerë totale 1,969,408 lekë dhe të zbatimit të kontratës me nr. 1752, datë 26.08.2022 me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering) për Akademinë e Sigurisë” në vlerë totale 247,967,144 lekë, për 36 muaj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. Z. A. B., me detyrë Specialist i Sektorit të IT, në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim, për mangësitë e konstatuara në zbatimin e kontratës nr. 24/1 datë 12.12.2022 me objekt “Për blerje uniformash dhe elementesh të tjerë përbërës të tyre” në vlerën totale 1,820,100 lekë dhe të zbatimit të kontratës nr. 04/2 datë 08.04.2022 me objekt “Për blerje këpucë, atlete sportive” në vlerë totale 1,969,408 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. Z. F. K., ish Shef i Sektorit Ekonomik, në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim për mangësitë e konstatuara të zbatimit të kontratës nr. 04/2 datë 08.04.2022 me objekt “Për blerje këpucë, atlete sportive” në vlerë totale 1,969,408 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. Z. A. Xh., me detyrë Mjek, në cilësinë e komisionit marrjes në dorëzim të zbatimit të kontratës me nr. 1752, datë 26.08.2022 me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering) për Akademinë e Sigurisë” në vlerë totale 247,967,144 lekë, për 36 muaj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6. Z. P. K., me detyrë Shef i Sektorit të Sigurisë, në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim për mangësitë e konstatuara të zbatimit të kontratës me nr. 1752, datë 26.08.2022 me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering) për Akademinë e Sigurisë” në vlerë totale 247,967,144 lekë, për 36 muaj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7. Z. Z. H., Drejtor i Departamentit për Shërbimet Mbështetëse në DPPSH, ka autorizuar Akademinë e Sigurisë: Të furnizojë me ushqim të gatuar me racion ditor (me 3-vakte dhe vaktin dreke) Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë së Shtetit, sipas kërkesës për numrin e kursanteve që do të trajnohen çdo ditë duke përfshirë në zbatimin të kontratës me nr. 1752, datë 26.08.2022 me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering) për Akademinë e Sigurisë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

b. Ministri i Brendshëm të marrë masa të menjëhershme, që në referencë të Statutit të Akademisë miratuar me Urdhër të përbashkët nr.130, datë 10.03.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit si dhe Ministrit të Brendshëm, nenit 11 pika 6, të propozojë shkarkimin nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë të Rektorit të Akademisë së Sigurisë **z. I. M.**, si rezultat i parregullsive të konstatuara, mbi përdorimin e fondeve publike, pa ekonomikitet, efektivitet dhe efijencë, si dhe mospërbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të Akademisë së Sigurisë, bazuar në nenin 8 pika 1 të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT